



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

**AGJENCIA PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT TË KOSOVËS**

GJENDJA E MJEDISIT NË KOSOVË

2008-2010

Raport

Prishtinë, 2011

I nderuari lexues



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, po sjell tek Ju një dokument shumë të rëndësishëm që ka për qëllim të ju informoi për gjendjen reale të mjedisit në Kosovë. Njëkohësisht përmes këtij Raporti prezantohet edhe angazhimi i institucioneve qeveritare për zbatimin e politikave adekuate mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Kosova tani më ka bërë përparim të dukshëm në ndërtimin e një shteti modern e të integruar në Bashkimin Evropian. Në këtë rrugë krahas sfidave tjera ne po përballemi edhe me plotësimin sfidave dhe kërkesave mjedisore, ku padyshim se vlerësimi i gjendjes së mjedisit është një ndër fushat me prioritet të lartë.

Përmbushja e këtyre obligimeve kërkon një angazhim më të madh, jo vetëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por edhe nga e gjithë shoqëria jonë. Andaj, përkushtimi ynë do të jetë që së bashku me institucionet dhe organizatat tjera relevante për mbrojtjen e mjedisit të angazhohemi për të hartuar politikat e duhura mjedisore dhe duke zbatuar këto politika të ndërtojmë mekanizma dhe instrumente efikase për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kualitetit të tij.

Jemi të vetëdijshëm që Republika e Kosovës edhe më tutje do ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik, i cili do të shoqërohet edhe me rritjen e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ngritjen e kapaciteteve të reja energjetike, që domosdo do të rrisin edhe ndikimin në mjedis. Padyshim se ndikimi në mjedis do të rritet edhe nga zhvillimi i sektorëve tjerë si transporti, industria, urbanizimi, bujqësia etj. Duke marrë për bazë këto rrethana, MMPH do të mundohet maksimalisht që të respektoj parimin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në relacion me zhvillimin ekonomik, parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, pra “të plotësojmë nevojat aktuale jetësore, pa i cenuar këtë të drejtë gjeneratave të ardhshme”.

Ne do të angazhohemi po ashtu edhe në parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, zgjerimin e rrejtës së zonave të mbrojtura, menaxhimin më efikas të resurseve ujore, planifikimin e qëndrueshëm urban, menaxhimin e avancuar të mbeturinave dhe forcimin e inspektimit mjedisore.

Dardan Gashi
Ministër i Ministrisë së Mjedisit
dhe Planifikimit Hapësinor

Falënderim



Të nderuar lexues dhe bashkëpunëtorë, në duart tuaja keni një Raport, që përmban informata themelore për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitet 2008, 2009 dhe 2010. Ky raport është përgatitur nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi që ka ky institucion në raportimin për gjendjen e mjedisit.

Përgatitja e këtij Raporti është ndihmua dhe mbështetur edhe nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë si dhe nga institucionet tjera që kanë përgjegjësi në sektorët e caktuar të mbrojtjes së mjedisit.

Ne vlerësojmë se raportimi real dhe i vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit është një mjet shumë i rëndësishëm jo vetëm për informimin e publikut por edhe për orientimin e politikave, strategjive dhe prioritetëve për të ardhmen e vendit në sektorin e mjedisit.

Nisur nga ky fakt AKMM ka grumbulluar të dhëna për gjendjen e mjedisit, për presionet që i bëhen mjedisit nga sektorët e ndryshëm, për të arriturat institucionale dhe programore në menaxhimin e mjedisit, për investimet në mjedis si dhe informata tjera relevante. Këto të dhëna janë përpunuar dhe tani prezantohen në këtë raport të gjendjes së mjedisit.

Ne jemi të vetëdijshëm që për të arritur rezultate në mbrojtjen e mjedisit, nevojitet bashkëpunim dhe angazhim i të gjithëve. Për këtë qëllim ne do të angazhohemi edhe më tutje të thellojmë bashkëpunimin me të gjitha institucionet dhe shpresojmë, që me rritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e sistemeve të integruara monitoruese do të rritet edhe cilësia e raportimit, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mjedisore.

Me këtë rast AKMM, shpreh falënderim të veçantë jo vetëm për stafit e AMMK-së, që ka punuar me përkushtim në këtë raport, por të gjithë individëve, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare që kanë dhënë kontributin e tyre përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme për hartimin e këtij raporti.

Ilir Morina

Kryeshf Ekzekutiv i AKMM

SHKURTESAT

AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
AKZHIE	Agjencioni për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritet Evropian
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BFN	Agjencia Federale Gjermane për Mbrojtjen e Natyrës
DANIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Danez për Zhvillim
DPSIR	D-Forcat Shtytëse, P-Presionet, S-Gjendja e mjedisit, I-Ndikimet dhe R-Reagimi
DU	Departamenti i Ujërave
EEA	Agjencioni Evropian i Mjedisit
EIONET	Rrjeti Evropian Mjedisor për Informim dhe Vëzhgim
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ETMM	Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore
FP	Fortësia e Përgjithshme
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Agrikulturë
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GTS	Grimca të Suspënuara
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
HEC	Hidrocentral
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat Paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë
KFOS	Fondacioni Soros për Kosovë
KFW	Banka Gjermane për Zhvillim
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KUR	Kompania e Ujësjellësve Rajonal
MAB	Rezervat i Biosferës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
NAG	Nitrati i Amonit Gëlqeror
NP	Ndërmarrje Publike
NPK	Azot Fosfor Kalium
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatorë Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PCB	Poli Klorur Bifenil
PE	Përçueshmëria Elektrike
PH	Përqendrimi i Jonit Hidrogjen
PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
PK	Parku Kombëtar

PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Planet Lokale të Veprimit në Mjedis
PMB	Produkte Kimike për Mbrojtjen e Bimëve
PN	Parku Nacional
PTD	Pluhuri Total i Depozituar
PZHK	Planet Zhvillimore Komunale
PZHU	Planet Zhvillimore Urbane
REC	Qendra Rregjionale për Mjedis
SHBO ₅	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit
SHUKOS	Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
SIDA	Agjencioni Suedez për Shkëmbimin e Informatave mbi Ndihmën Teknike i BE-së
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
TSP	Grimcat e Suspenduara Totale
UA	Udhëzim Administrativ
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO	Programi i Kombeve të Bashkuara për Trashëgimi Kulturor dhe Natyror
UREA	Plehrat Minerale Azotike
VML	Vlerat Maksimale të Lejuara
VMM	Vlerat Mesatare Mujore
VMV	Vlerat Mesatare Vjetore
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZRRUM	Zyra Rregullator për Ujë dhe Mbeturina

Përmbajtja

1. Hyrje	9
1.1. Parathënie	11
1.2. Përmbledhje e shkurtër e raportit	13
1.3. Profili i Kosovës	14
1.4. Presionet në mjedis	19
2. Gjendja e Mjedisit	21
2.1. Ajri	23
2.2. Uji	32
2.3. Toka (Dheu)	56
2.4. Biodiversiteti	65
2.5. Mbeturinat dhe kimikatet	71
3. Mjedi dhe Shëndeti Publik	79
3.1. Ndikimi i mjedisit në shëndetin publik	81
3.2. Kualiteti i ujit të pijes dhe shëndeti publik	83
4. Shfrytëzimi i Resurseve Natyrore	87
4.1. Shfrytëzimi i resurseve ujore	89
4.2. Shfrytëzimi i inerteve nga lumenjtë	97
4.3. Shfrytëzimi i resurseve pyjore	97
5. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit	99
5.1. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2006-2010	101
5.2. Hartimi i strategjive dhe planeve sektorial	102
5.3. Hartimi i planeve mjedisore në nivelin lokal	103
6. Masat e Ndërmarrja për Mbrojtjen e Mjedisit	105
6.1. Hartimi i legjislacionit dhe përafrimi me direktivat e BE-së	107
6.2. Inventarizimi i hot-spoteve mjedisore	108
6.3. Identifikimi hapësinor i ndotësve potencial	111
6.4. Përgatitja e kadastrës së ndotësve të ujërave	112
6.5. Rehabilitimi i deponive	115
6.6. Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe kanalizimit	116
6.7. Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe përtëritja e pyjeve	117
6.8. Zhvillimet dhe ngecjet në forcimin e institucioneve mjedisore	118
7. Investimet për Mbrojtjen e Mjedisit	119
8. Referencat	123
8.1. Literatura, raportet dhe publikimet	125
8.2. Institucionet dhe ndërmarrjet publike	126
9. Shtojcat	127
9.1. Indeksi i tabelave	129
9.2. Indeksi i figurave	131
9.3. Indeksi i hartave	133

1. Hyrje

1.1. Parathënie

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit¹. Sipas nenit 25 të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit Raport për Gjendjen e Mjedisit. Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: Gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, zbatimin e Strategjisë së Mjedisit, Planit të Veprimit, masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin e resurseve natyrore, zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit është institucioni që harton këtë dokument.

Ky Raport paraqet gjendjen e mjedisit për periudhën 2008/2010, por edhe të dhëna të mëhershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi. Ky është raporti i tretë zyrtar për gjendjen e mjedisit i cili procedohet zyrtarisht nga Ministri i MMPH-së.

Bazuar në modelet e pranueshme të raportimit dhe në rrethanat ekzistuese mjedisore në Kosovë, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Për t'i përmbushur kërkesat e raportit, të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport. Këto të dhëna janë në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.

Raporti ofron të dhëna për shtytësit dhe presionet në mjedis, përshkruan gjendjen aktuale të medimeve mjedisore dhe ndikimin e kësaj gjendjeje. Trajton në një masë politikat e ndjekura për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit si dhe angazhimin e institucioneve qeveritare, joqeveritare dhe të shoqërisë në përgjithësi për përmirësimin e gjendjes. Një formë e tillë e raportimit që njihet si Modeli DPSIR², paraqet shqetësime për të gjitha problemet mjedisore në vend dhe është një mënyrë shumë e përshtatshme për vlerësimin e gjendjes së mjedisit.

Modeli DPSIR është një model i adoptuar nga Agjencia Evropiane për Mjedisin (EEA), e që përdoret gjithashtu edhe nga EUROSTAT për prodhimin e statistikave mjedisore.

Ky model analitik mundëson organizimin e informacionit dhe integrimin e elementeve socio-ekonomike dhe mjedisore, duke adresuar marrëdhëniet ndërmjet pesë kategorive të treguesve: Forcat shtytëse (siç janë: prodhimtaria bujqësore, prodhimi industrial, teknologjia prodhuese etj.), Presionet në mjedis (si: emisionet në ujë, ajër dhe tokë), të cilat ndikojnë në keqësimin e gjendjes së mjedisit (p.sh., përqendrimin e metaleve të rënda në tokë, ngritjen e temperaturave mesatare globale), të cilat më pastaj ndikojnë duke imponuar kështu përgjigje ose reagim të institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura (masa legjislative, taksa, programe mjedisore për hulumtime e kërkime etj.). (Figura 1).

¹ Ligji Nr. 03/L-025

² D-Driving Forces, P-Pressures, S-State of the Environment, I-Impacts, R-Responses (D-Forcat shtytëse, P-Presionet, S-Gjendja e mjedisit, I-Ndikimet dhe R-Reagimi)




Figura 1: Korniza analitike DPSIR

Në masë të konsiderueshme hartimi i këtij raporti është orientuar edhe nga përzgjedhja e indikatorëve (treguesve) të cilët kanë qenë më të përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Jemi përpjekur që indikatorët e zgjedhur të kenë bazë shkencore dhe të jenë të kapshëm nga të gjithë ata që do të shërbejnë me këtë raport.

Përkundër angazhimit maksimal, ky raport ka edhe mangësi, që në radhë të parë janë pasojë e mungesës së të dhënave për shumë çështje të rëndësishme, mungesës së monitorimit të integruar të mjedisit, bazës ligjore dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.

Duhet pranuar faktin se cilësia e raportimit varet nga cilësia e monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Duke ditur se këto dy sisteme mjedisore tek ne nuk janë të organizuara në nivelin e duhur, mund të arrijmë në një konkluzion se edhe mungesa e të dhënave të plota dhe besueshmëria e tyre është një tregues i rëndësishëm i gjendjes së mjedisit në Kosovë. Qëllimi i këtij raporti në radhë të parë është informimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë, mirëpo, të dhënat e tij janë një bazë e mirë edhe për ndërtimin e politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

Përmes raportimit të të dhënave të grumbulluara në këtë dokument, AMMK synon që të plotësoj kushtet për të vënë bazën e bashkëpunimit dhe raportimit për Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe EIONET-in³, duke dërguar informata për gjendjen e mjedisit të Kosovës, në këto institucione mjedisore të Bashkimit Evropian.

Hartuesit e këtij publikimi u janë mirënjohës të gjithë atyre që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, qoftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ne i vlerësojmë, çmujmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë shumë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

3 European Environmental Information and Observation Network (Rrjeti Evropian Mjedisor për Informim dhe Vëzhgim)

1.2. Përmbledhje e Shkurtër e Raportit

Raporti Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010, përmban 8 kapituj. Në pjesën hyrëse të raportit përveç parathënies është prezantuar në pika të shkurtra edhe Profili i Kosovës, ku ka të dhëna për pozitën gjeografike, relievin, klimën, hidrografinë, lëvizjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë, dendësinë, shtimin natyror dhe të dhëna të tjera socio-demografike.

Në këtë kapitull janë përshkruar edhe presionet kryesore të sektorëve zhvillimorë në mjedis. Këtu janë prezantuar format dhe ndikimet në mjedis nga sektori i energjisë, industrisë, transportit, bujqësisë, pylltarisë dhe turizmit.

Kapitulli i dytë i raportit përshkruan gjendjen e mjedisit. Prezantimi i gjendjes së mjedisit është bërë sipas sektorëve përkatës. Për sektorin e ajrit janë prezantuar të dhëna për cilësinë e ajrit, monitorimin e cilësisë së ajrit, emisionet në ajër dhe ndikimin e sektorëve të ndryshëm në cilësinë e ajrit. Në sektorin e ujërave janë prezantuar të dhëna për resurset ujore të Kosovës, cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe monitorimin e ujërave sipërfaqësore sipas pellgjeve. Në kuadër të të dhënave për tokën, në raport janë prezantuar të dhëna për kategoritë e shfrytëzimit të tokave, format e humbjes së tokave bujqësore, ndotjen e tokave, sipërfaqet e ujitura të tokave, erozionin dhe përmbytjet e tokave. Gjendja e biodiversitetit është prezantuar përmes të dhënave për numrin e zonave të mbrojtura të natyrës, menaxhimin e zonave të mbrojtura, gjendjen e këtyre zonave, gjendjen e llojeve bimë dhe shtazore dhe aktivitetet e iniciativat e ndërmarra për mbrojtjen e natyrës. Në këtë sektor është prezantuar edhe një përmbledhje e problemeve dhe rekomandimeve për biodiversitetin. Në kuadër të prezantimit të gjendjes me menaxhimin e mbeturinave dhe kimikateve në këtë raport ka të dhëna për gjenerimin e mbeturinave komunale, deponimin e këtyre mbeturinave, mbeturinat industriale, mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat e automjeteve si dhe për importin dhe përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike.

Në kapitullin Mjedi dhe shëndeti publik, raporti ofron të dhëna për ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, cilësinë e ujërave të pijes dhe sëmundjet që vijnë nga mjedi i ndotur. Në këtë kapitull prezantohen edhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike për tejkalimin e gjendjes.

Përmes kapitullit Shfrytëzimi i resurseve natyrore, raporti prezanton të dhëna për shfrytëzimin e resurseve ujore nga sektorët e ndryshëm, degradimin e rrjedhave të lumenjve, shfrytëzimin e inerteve si dhe shfrytëzimin e resurseve pyjore.

Zbatimi i Strategjisë, Planit të Veprimit dhe planeve tjera për mjedis, është një kapitull tjetër i raportit, përmes së cilit synohet të prezantohet se sa është zbatuar Strategjia e Kosovës për Mjedis, numri i projekteve të realizuara nga Plani i Veprimit në Mjedis, progresin e arritur në hartimin e strategjive dhe planeve sektoriale të veprimit, si dhe hartimin e planeve dhe programeve mjedisore në nivelin lokal.

Në kapitullin Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, është bërë një përmbledhje e masave dhe veprimeve kryesore të ndërmarra nga institucionet e ndryshme për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Këtu janë përfshirë masat në hartimin e legjislacionit mjedisor dhe përafrimin e tij me legjislacionin evropian, inventarizimin e hot-spotëve mjedisore, identifikimin hapësinor të ndotësve potencial, përgatitjen e kadastrës së ndotësve të ujërave, rregullimin e shtretërve të lumenjve, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, rehabilitimin e deponive të egra, rehabilitimin dhe rikuperimin e zonave me ndotje të lartë, si dhe zhvillimet dhe ngecjet në forcimin e institucioneve mjedisore.

Kapitulli Investimet për mbrojtjen e mjedisit, ofron një pasqyrë më të detajuar për investimet në sektorin e mjedisit, burimet e financimit dhe mbështetjen nga donatorët. Gjithashtu, në këtë kapitull ka të dhëna edhe për koston e disa projekteve kryesore në fushën e mjedisit.

Në kapitullin e Referencave janë prezantuar të gjitha burimet të cilave ju referohet raporti, qofshin ato të dhëna nga monitorimi i gjendjes së mjedisit, raporte e publikime, si dhe të dhëna të tjera nga institucionet e ndryshme qeveritare, joqeveritare dhe ndërmarrjet publike, veprimtaria e të cilave ndërlidhet me mjedisin, ose, që ofrojnë të dhëna të caktuara për ndonjë tregues mjedisor.

Në kapitullin e fundit janë prezantuar tri shtojca të raportit, përkatësisht indeksi i tabelave, indeksi i figurave dhe indeksi i hartave. Të dhënat e prezantuara në raport ilustrohen përmes 68 tabelave, 65 figurave dhe 11 hartave.

1.3. Profili i Kosovës

Pozita Gjeografike- Kosova gjendet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik. Shtrihet në mes të 41°50'58" dhe 43°51'42" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01'30" dhe 21°48'02" të gjatësisë gjeografike lindore. Kosova ka sipërfaqe prej 10.908 km². Sipas rezultateve paraprake nga regjistrimi preliminar të realizuar nga ESK në vitin 2011, Kosova ka 1.73 milion banorë dhe dendësi mesatare prej 159 banor në km² (në regjistrim nuk janë përfshirë komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan)⁴. Kufizohet me Shqipërinë (në jugperëndim), me Maqedoninë (në juglindje), me Serbinë (në lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është rreth 700.7 km².

Relievi- Kosova është vend malor dhe me ultësira, i përbërë nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m). Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është 810m. Pika me e ulët është 270 m, ndërsa më e larta 2656 m (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km² (0.2 %) deri 1000 m shtrihen 8754 km² (80.7 %), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km² (17 %) dhe mbi 2000 m deri 250.6 km² (2.3 %). Format kryesore në relievin e Kosovës janë: malet me 63 % dhe fushëgropat 37%.

Klima - Klima është e mesme-kontinentale, me ndikim mbizotërues të klimës adriatiko-mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, përmes luginës së Drinit të Bardhë, si dhe me ndikim më të vogël të klimës së ndryshuar adriatiko-egjeniane në Fushën e Kosovës. Të reshurat mesatare vjetore **596 mm**. Temperaturat mesatare vjetore të Kosovës janë **10°C**, me temperaturën e arritur minimale **-27,2** dhe maksimale **39,2**⁵. Faktorët lokal kryesorë që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

Hidrografia- Vlerësohet se Kosova ka vetëm 1600 m³/ujë/vit për kokë banori. Ujërat e Kosovës ndahen në 4 Pellgje Lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci. Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10⁹ ujë, përkatësisht 121.2 m³/sec. Potenciali për energji ujore në Kosovë është shumë i vogël dhe deri më tani shfrytëzimi i saj është mjaft modest. Kushtet topografike për ndërtimin e rezervuarve artificial për mbledhjen e ujit nuk janë të përshtatshme.

Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha, në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore, ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha. Kosova ka numër të vogël të liqeneve natyrore. Liqene artificiale janë Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci, si dhe një numër i liqeneve të vogla për ujitje.

Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe parashikimet- Kosova për një periudhë të gjatë kohore (mbi 25 vjeçare) ballafaqohet me mungesë të dhënave statistikore për popullsinë, kështu që përcaktimi i numrit të popullsisë bëhet kryesisht në bazë të vlerësimeve dhe parashikimeve. Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës edhe përkundër shpërnguljeve dhe trysnive të shumta ndaj saj, vazhdimisht është rritur në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore me ritme të ndryshme. Gjatë periudhës 63 vjeçare (1948-2011) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 138.2%.

Tabela 1: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011⁶

Viti	Nr.i banorëve	Komentet
1948	727820	Regjistrimi
1961	963988	Regjistrimi
1971	1243693	Regjistrimi
1981	1584440	Regjistrimi
1991	1956196	Vlerësimi
2002	1985000	Vlerësimi
2011	1733872	Regjistrim preliminar

4 Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, Rezultatet paraprake ESK 2011

5 Instituti Hidrometrologjik i Kosovës, 2008

6 Statistikat e lindjeve në Kosovë 2008, ESK 2009




Figura 2: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2011

Në bazë të projeksioneve të popullsisë së Kosovës numri i përgjithshëm do të vazhdon të rritet edhe në 50 vitet e këtij shekulli, edhe pse me ritme dukshëm më të ngadalshme krahasuar me vitet e '60, '70 dhe '80 të shekullit të kaluar.

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ka ndikim në mjedis në shumë aspekte, prej të cilave më të rëndësishmet janë: ndikimi në shkallën e prodhimit, shfrytëzimin e resurseve, në mënyrën e shfrytëzimit të tokës si dhe krijimin e mbeturinave dhe ndotjen e mjedisit.

Lidhja në mes popullsisë dhe ndikimit në mjedis në shikim të parë është: më shumë njerëz harxhojnë më shumë produkte, potencial natyror, shkaktojnë më shumë dëme dhe prodhojnë më shumë mbeturina.

Shtimi natyror i popullsisë- Popullsia e Kosovës ritmin më të shpejtë të rritjes e ka pasur gjatë viteve '60-ta, kur shkalla e shtimit natyror ishte më e larta në periudhën e pas Luftës së dytë Botërore me 29.9‰ (lindshmëria 44.1‰ kurse vdekshmëria 14.2‰).

Tabela 2: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 1948-2010⁷

Viti	Lindshmëria	Vdekshmëria	Shtimi natyror
1948	27792	10324	17468
1961	40561	11759	28802
1971	47060	10312	36748
1981	48111	9677	38434
1991	52263	8526	43737
1996	46041	8392	37649
2002	36136	5654	30482
2003	31994	6417	25577
2004	35063	6399	28664
2005	37491	7207	30284
2006	34187	7479	26708
2007	33122	6681	26431
2008	34399	6852	27547
2009	34240	7030	27210
2010	33751	7234	26517

7 Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2010, ESK, Prishtinë 2011




Figura 3: Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 2002-2010

Në bazë të dhënave që ofron Enti i Statistikave të Kosovës, në vitin 2003 në Kosovë është regjistruar niveli më i ulët i lindjeve dhe i shtimit natyror të popullsisë në 1000 banorë, që nga përfundimi i Luftës së dytë Botërore deri me sot.

Dendësia e popullsisë- Me rritjen e popullsisë së Kosovës është rritur edhe niveli i popullimit mesatar për njësi të sipërfaqes nga 62.7 (1948) në 159 (2011) banorë për km². Kjo rritje paraqet njëherësh edhe rritjen e ndikimit të popullsisë në mjedis. Dendësia më e lartë e popullsisë është në zonat e ulëta fushore (mbi 600 b/km²- Fusha e Kosovës), në viset e ulëta kodrinore lëviz rreth mesatares së Kosovës, kurse viset e larta kodrinore-malore kanë dendësi më të ulët se mesatarja e Kosovës. Në viset e ulëta është koncentruar numri më i madh i popullsisë, objekteve industriale dhe urbanizimit, faktorë këta që kanë ndikimin më të madh në ndotjen e mjedisit.

Tabela 3: Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011⁸

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2002	2011
Nr.i ban. për km ²	62.7	74.8	88.4	114.1	145.3	179.7	182	159




Figura 4: Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2011

Ndryshimet në dendësi të popullsisë në mjedisin geografik lidhen me disa probleme mjedisore siç janë: braktisja e mjedisve agrare (emigrimet drejt qyteteve), rritja e trysisë mbi mjedis në disa zona (veçmas urbane) dhe pamundësia për të kënaqur kërkesat në banim, punësim, sigurim, infrastrukturë etj, si dhe ndërhyrjet tjera përmes zënies së sipërfaqeve bujqësore me ndërtime, ndërhyrje pa kriter në ujësjellës, rritja e sasisë së mbeturinave, ujërave të zeza që hedhen në mjedis të pa trajtuara etj.

Struktura e popullsisë sipas moshës- Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup moshë

⁸ Gjeografia e Kosovës, ETMM,Pr,1994 dhe Statistikat vitale të Kosovës 2002, Regjistrimi preliminar 2011, ESK.

0-19 vjeç përbën 38 %, grup moshë 20-64 përbën 56 %, kurse grup moshë e vjetër mbi 65 vjeç përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme.

Tabela 4: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006⁹

	1981	1991	2001	2006
0-19 vjeç	52	48	41	38
20-64 vjeç	43	47	54.1	56
Mbi 65 vjeç	5	5	5.9	6




Figura 5: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006

Struktura e popullsisë sipas moshës në mjedis ndikon përmes prodhimit dhe konsumit, sepse nga kjo strukturë formohet kontingjenti i punës dhe kontingjenti i popullsisë që paraqitet si konsumator.

Të ardhurat për kokë banori- Pas viteve '80-ta, përqësimi i situatës ekonomike në Kosovë është shprehur edhe me zvogëlimin e të ardhurave për kokë banori. Nga viti 2000 të ardhurat për kokë banori fillojnë të rriten, më shumë për shkak të ndihmave dhe donacioneve të ndryshme se sa të zhvillimit ekonomik të vendit.

Tabela 5: Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2009¹⁰

	1985	1990	1995	2000	2001	2004	2006	2008	2009
Të ardhurat për banorë në €	1125	689	340	730	823	1457	1487	1784	1710




Figura 6: Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2008

9 Për vitin 1881, Buletini 17, ESK, 1991-2001, Ecuria dhe shtrirja e pop. Shqiptare në Ish Jugosllavi, Instituti Ekonomik 1997, 2006, Kosova në shifra 2006, ESK, Prishtinë 2007.

10 Bruto prodhimi vendorë në Kosovë për vitet 2004-2008, ESK, Prishtinë, 2009

Kosova ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Evropë. Gjithashtu hynë në radhën e shteteve me të ardhura më të ulëta edhe në përmasa botërore.

Varfëria- Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe shkalla shumë e lartë e papunësisë janë shkaktarë të nivelit të lartë të varfërisë në Kosovë. Nëse bazohemi në definicionin se e varfër konsiderohet ekonomia familjare me më pak se 2\$ në ditë, atëherë del se në vitin 2004 në Kosovë në varfëri jetonin 60.6% e popullsisë (12.9% në varfëri ekstreme nën 1 \$ për banor 47.6% në varfëri të plotë me 2\$ për banorë në ditë). Në krahasim me vitin 2000 nuk vërehet ndonjë përmirësim sa i përket shkallës së varfërisë në Kosovë, por niveli i varfërisë ekstreme tregon rritje nga 11.9%(2000) në 12.9%(2004), kurse niveli i varfërisë së plotë është i njëjtë dhe përfshinë më tepër se gjysmën e popullsisë (50.3%).

Tabela 6: Varfëria e përgjithshme sipas nacionaliteteve dhe vendbanimeve në Kosovë

Treguesi	Kosovë	Shqiptarët	Serbët	Ashka-linjë	Të tjerë	Vend. rurale	Vend. urbane
Varfëria në nivel kombëtar	50.3	50.4	36.9	80.9	67.6	51.7	48.7
Varfëria e skajshme	12.7	12.6	5.9	37.5	19.6	10.8	14.9
Personat me 1 dollar në ditë	12.9	12.8	3.9	36.7	16.8	10.6	15.1
Personat me 2 dollarë në ditë	47.6	48.6	26.4	79.0	57.7	49.2	45.7

Duke u bazuar në strukturën etnike të popullsisë dhe të nivelit të varfërisë mund të konstatohet lidhje korrelative ndërmjet varfërisë dhe strukturës etnike të popullsisë. Komunitet me popullsi shqiptare karakterizohen me shkallë më të lartë të varfërisë, kurse komunitet me popullsi shumicë serbe karakterizohen me shkallë më të ulët të varfërisë. Shpërndarja e varfërisë sipas vendbanimeve tregon se varfëria kombëtare më e lartë është në vendbanimet rurale, kurse varfëria e skajshme (ekstreme) më e lartë është në vendbanimet urbane.

1.4. Presionet në Mjedis

Koncepti presionet sektoriale, pasqyron presionet në mjedis të sektorëve të caktuar ekonomik dhe sektorëve tjerë, përmes të cilëve njeriu duke kënaqur nevojat e veta socio-ekonomike shkakton ndikime të ndjeshme në mjedis. Shfrytëzimi i hapësirës, shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe llojet e ndryshme të shërbimeve të cilat kanë ndikim në mjedis, reflektohen edhe në ndryshimin e baraspeshës natyrore, shterjen e resurseve natyrore dhe në shëndetin e njeriut. Përmasat e këtyre ndikimeve, mekanizmi i veprimeve dhe pasojat në mjedis janë të varura nga shumë faktorë. Mosndërmarrja e masave adekuate në parandalimin dhe eliminimin e tyre në shumicën e rasteve shkaktojnë efekte të pariparueshme për mjedisin.

Me qëllim të vlerësimit më të lehtë të ndikimeve në mjedis, praktikohet që efektet sektoriale të grupohen sipas aktiviteteve ekonomike, që në realitet trajtohen si sektorë të veçantë.

Disa aktivitete ekonomike si: energjetika, industria, transporti, etj. padyshim janë burime me ndikim të theksuar në mjedis, ndërsa bujqësia, peshkimi, pylltaria etj. qëndrojnë në raporte të tjera me mjedisin dhe si të tilla varen mjaft nga gjendja e mjedisit. Shqyrtimi i ndikimeve të tyre në mjedis, assesi nuk duhet të anashkalohet. Ndërsa, turizmi është një sektor ekonomik, efektet e të cilit në mjedis janë identifikuar kohëve të fundit.

Shqyrtimi i ndikimeve të sektorëve në mjedis ka një përparësi sidomos gjatë planifikimeve zhvillimore dhe hartimit të strategjive përkatëse. Përveç shqyrtimit të efekteve sektoriale veç e veç, është me interes edhe shqyrtimi i zonave në të cilat vjen deri te ndikimi i veprimeve të përbashkëta të disa sektorëve të ndryshëm. Kimikatet i takojnë këtij grupi, prodhimi dhe përdorimi i të cilave sot është në rritje e sipër nga disa sektorë.

Energjetika-Energjetika luan rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në jetën e modernizuar të njeriut. Por edhe ndikimet e saj në mjedis janë mjaft të theksuara. Çfarëdo qoftë mënyre e prodhimit të energjisë ka ndikim të ndjeshëm në mjedis, për shkak të operacioneve të cilat e përcjellin, që nga sigurimi i lëndës së parë dhe transportit të saj e deri te procesi i prodhimit dhe vet shfrytëzimi i energjisë.

Në rend të parë analizohen emisionet e përgjithshme nga vargu energjetik duke përfshirë: ndotjen e ujit, ajrit, tokës, menaxhimin e mbetjeve, zhurma dhe radioaktiviteti. Është me interes që të vlerësohen edhe aksidentet e mundshme që ndodhin gjatë procesit të prodhimit, transportit dhe shfrytëzimit të energjisë. Arritja e një baraspeshë në mes kërkesës për energji dhe ruajtjes së gjendjes së mjedisit është një sfidë e madhe. Duke zgjedhur llojet e burimeve të energjisë dhe teknologjive të përshtatshme zvogëlohet ndikimi në mjedis. P.sh nëse në vend të thëngjillit përdoret gaz natyror, atëherë emetimi i CO₂ zvogëlohet për 40 %.

Megjithatë, secili objekt energjetik në përmasa dhe forma të ndryshme ka ndikim në mjedis. Me ndërtimin e një hidrocentrali vije deri te çrregullimi i regjimit të ujërave nëntokësore dhe mikroklimës, me ç'rast çrregullohet ekosistemi në hapësirën ku shtrihet objekti hidroenergjetik.

Industria- Industria është çelësi i zhvillimit ekonomik të një vendi, por njëkohësisht hynë në radhën e ndikuesve më të mëdhenj në mjedis. Përmes zhvillimit të industrisë harxhohen resurset si: burimet energjetike, uji dhe resurset tjera. Nga aktivitetet industriale lirohen emisione në ujë, ajër dhe tokë. Fatkeqësitë industriale paraqesin një tjetër kërcënim të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ndërsa, prodhimi i mbeturinave nga shumica e industrive është edhe një segment tjetër i ndikimit të këtij sektori në mjedis.

Bujqësia- Bujqësia në Kosovë në të kaluarën ka qenë njëri ndër sektorët kryesor të punësimit dhe sigurimit të të ardhurave. Krahasuar me vitet '90-ta, pas vitit 2000 ka qenë e theksuar tendenca e rritjes së prodhimitarisë bujqësore dhe po ashtu, edhe tendenca e ndryshimit të zhvillimit të bujqësisë. Është shtuar numri i fermave dhe prodhuesve bujqësorë. Është shtuar përdorimi i kimikateve dhe produkteve tjera me ndikim negativ në mjedis. Në Kosovë ende nuk ka ndonjë interesim të theksuar për prodhimin e produkteve ekologjike.

Edhe pse 53 % e sipërfaqes së Kosovës është cilësuar tokë bujqësore, vetëm 3.9 % e forcës punëtore janë të punësuar në bujqësi. Nga totali i tokës bujqësore rreth 73% është tokë e punuar, ndërsa pjesa tjetër është toka nën pyll si dhe oborre të shtëpive.

Kosova nuk i përmbush nevojat e popullsisë në prodhimtarinë e ushqimit andaj, importi i produkteve ushqimore është i domosdoshëm. Në mungesë të laboratorëve të certifikuar importohen ushqime me kualitet të dyshimtë dhe shpesh pa ndonjë kontroll të mirëfilltë në pikat hyrëse.

Pylltaria- Pyjet janë ekosistemet më të përparuara natyrore dhe kanë rendësi shumë të madhe, sepse janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Pyjet janë rregullatorë natyror të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit, ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpëlarja e shtresës produktive të tokës. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO₂ në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me oksigjen. Janë resurse natyrore

ripërtëritëse, produktet e të cilave mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Ato përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe mjedis çlodhës për njeriun.

Megjithëkëtë, ndikimi i njeriut në pyje është shumë i theksuar. Ato janë të ndjeshme sidomos në ndotje të ajrit. Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore si: erozioni, ndryshimet klimatike, vërshimet etj.

Transporti- Ky sektor ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit, posaçërisht në mjediset urbane. Shumica e automjeteve përdorin naftën, çka nënkupton lirim të emisioneve në ajër, ujë dhe tokë. Gjithashtu, gjatë ndërtimit të rrugëve bëhen ndryshime të peizazhit dhe të tokave, përfshirë këtu edhe degradimin e mundshëm të habitateve. Automjetet e papërdorshme paraqesin po ashtu një rrezik serioz për mjedisin. Nga transporti i materieve të rrezikshme mund të vijë edhe deri të aksidentet me pasoja fatale për mjedisin.

Turizmi- Paraqet njërën ndër fushat kryesore të zhvillimit të një vendi. Zhvillimi i tij ka ndikime në mjedis, sidomos nëse nuk merren parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Resurse turistike kanë pothuajse të gjitha trevat e Kosovës, “Malet e Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” janë zonat më të rëndësishme. Vlerat e paprekura të natyrës së Kosovës si dhe diversiteti i monumenteve kulturore-historike krijojnë mundësi të mira të zhvillimit turistik.

2.

Gjendja e mjedisit

2.1 Ajri

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi i mjedisit që na rrethon, i cili vazhdimisht është nën ndikim të ndotjes. Edhe pse ndotja e ajrit vjen nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur në ajër lirohen substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Disa ndotës të ajrit mund të kenë edhe ndikime globale - p.sh. rritja e efektit të gazeve serrë ose dëmtimi i shtresës së ozonit.

Gjendja

Të dhënat për cilësinë e ajrit në Kosovë janë të mangëta për shkak të mungesës së rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit. Po ashtu, ende nuk është bërë inventarizimi i ndotësve dhe nuk është përpiluar kadastra e ndotësve të ajrit. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje nuk mund të flitet me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes së ajrit dhe cilësinë e tij.

Si **burime kryesore të ndotjes** së ajrit në Kosovë konsiderohen sektori i energjetikës, komunikacioni dhe industria e rëndë. Aktualisht kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit janë:

- KEK-u që përfshinë termocentralet (Kosova A dhe Kosova B) dhe mihjet sipërfaqësore të linjitet në Obiliq ;
- Komunikacioni (trafiku rrugor, ajror dhe hekurudhor)
- Kompleksi industrial Ferronikeli në Glllogovc;
- Fabrika e çimentos-Sharcem në Han të Elezit ;
- Kompleksi industrial në Mitrovicë;
- Sistemet për ngrohje qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë) ;
- Industria e rëndë bazike (aktualisht nuk funksionon) në Gjakovë, Pejë dhe Gjilan;
- Deponitë e mbetjeve urbane dhe atyre industriale.

EMISIONET NË AJËR SIPAS SEKTORËVE

Energjetika

Termocentralet Kosova A dhe Kosova B- Emisionet e pluhurit maten vetëm në termocentralin “Kosova B”, p.sh. mesatarja vjetore për emisionet e matura të pluhurit gjatë vitit 2008 kanë qenë: për Bllokun - B1: 272.22 ton/muaj, kurse për Bllokun - B2: 254.49 t/muaj, ndërsa parametrat tjerë (SO_2 , NO_x dhe CO_2) kalkulohen nga ekipi për mjedis në Divizionin e Gjenerimit të Energjisë. Në tabelën vijuese janë paraqitur emisionet e termocentraleve të KEK-ut, dhe limitet sipas Direktivës 2001/80/EC.

Tabela 7: Emisionet aktuale dhe limitet sipas Memorandumit të Athinës

Ndotësi	TCA	TCB	Limiti	Të arrihet
Pluhur	902.32	156.35	50	31 Dhjetor 2017
SO_2	251.42	208.55	400	31 Dhjetor 2017
NO_x	705.75	835.08	500	31 Dhjetor 2017

Siç shihet nga tabela, emisionet e pluhurit, në krahasim me limitet sipas kërkesës së Memorandumit të Athinës janë shumë të larta, sidomos nga TCA. Po ashtu edhe emisioni i NO_x sipas kalkulimeve është mbi nivelet e kërkuara. Emisionet e SO_2 , edhe pse sipas kalkulimeve dalin më të ulëta se sa limiti i Direktivës, ato kërkohej të verifikohen përmes matjeve të vazhdueshme. Ndërsa emisionet e CO_2 të llogaritura nga totali i linjtit të përdorur, llogariten të jenë mbi 5 milion ton për vit (tabela 8).

Tabela 8: Emisionet e CO_2 nga TC Kosova A dhe TC Kosova B¹¹

Termocentrali	Blloqet	Emetimet e CO_2 (t/vit)
Kosova A	A1, A3, A5	1.532.930
Kosova B	B1, B2	3.608.876

Ngrohtoret publike- Në Kosovë një kohë të gjatë kanë qenë në funksion tri ngrohtore publike: në Prishtinë, në Gjakovë dhe në Mitrovicë. Ngrohtorja e qytetit të Prishtinës-Termokos funksionon gjatë periudhës gjashtëmujore (sezoni dimëror). Ky impiant për ngrohje si lëndë djegëse përdor mazutin. Ngrohtorja e qytetit-Termokos ka ofruar të dhëna të përgjithshme për emisionet.

Sa i përket shumës së përgjithshme të harxhimit të lëndës djegëse për sezonin ngrohës 2007/2008 ka qenë 9,320.16 t, ndërsa për sezonin ngrohës 2008/2009 ka qenë 9,438.82 t.

Ndërsa, sa i përket shumës së përgjithshme për prodhimin e ngrohjes në sezonin 2007/2008 ka qenë 86,561.532 MWh dhe në sezonin 2008/2009 ka qenë 92,259.645 MWh.

Duke ju referuar të dhënave të ofruara nga Ngrohtorja e Qytetit-Termokos për vitin 2010, shihet se dyoksidi i sulfurit SO_2 (3% O_2) është 491.0 mg/Nm³, pra emisioni i SO_2 është mbi vlerat e lejuara. Sasia e CO është 118.0 mg/m³ dhe është po ashtu në kufij të lejuar¹².

11 Raporti nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social për Termocentralin Kosova e Re, Patel & MEM 2008

12 Ngrohtorja e Qytetit Termokos, 2010

Industria

Fabrika e çimentos Sharrcem


Tabela 9: Paraqitja e vlerave mesatare të emisioneve në mg/Nm³ në zonën e fabrikës së çimentos Sharrcem¹³

VITET	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Emisioni mesatar i SO ₂	470	420	350	350	182	234	306	56.15
Emisioni mesatar i NOx	820	548	590	580	564	593	536	447.93
Emisioni mes. i pluhurit	250	108	120	100	60	77	61	67.60

Duke u bazuar nga të dhënat konstatohet se ka vlera të larta të pluhurit, por nuk ka tejkalim të vlerave të lejuara të SO₂ sidomos në vitin 2010 shihet vlerë mjaft e ulët në krahasim me vitet paraprake dhe poashtu për NOx në vitin e fundit ka ulje të vlerave.

Emisionet absolute të CO₂ në figurën 7 tregojnë se edhe pse vlerat e emisioneve absolute të CO₂ tregojnë rritje, ato janë më të vogla për 9% ndaj rritjes së prodhimit të çimentos në krahasim me vitet paraprake.

Figura 7: Emisionet absolute të CO₂ në zonën e fabrikës së çimentos Sharrcem¹⁴



Ferronikeli- Matjet për emision në Ferronikel janë bërë nga një laborator i licencuar Farmahem nga Shkupi (Mqedoni). Janë kryer matjet e emisionit të gazrave dhe pluhurit (TSP) në shkritoren e Ferronikelit në nëntor 2009. Qëllimi i matjeve ishte monitorimi i emisioneve në atmosferë nga shkritorja.

Gjatë matjeve janë zbatuar standardet e ISO, për: O₂ dhe CO, NOx, SO₂, pluhur (grimcave të suspenduara totale – TSP) Në vitin 2010 “Tehnolabi” si laborator i licencuar nga Maqedonia ka kryer matjet në emision të gazrave dhe pluhurit (TSP) në pika shkarkuese në shkritoren e Ferronikelit, në bazë mujore.

Ndotja e trashëguar nga Trepça- Qyteti i Mitrovicës si zonë me ndotje më të madhe që rrjedh nga veprimtaritë industriale ka qenë qyteti me shkallë të lartë të ndotjes së mjedisit. Pasojat e ndotjes janë prezentë edhe sot edhe pse Trepça nuk punon. Gjerë më tani është punuar për vlerësimin e ndotjes së mjedisit në Trepçë, nga një ekspert suedez, financiar nga organizata qeveritare suedeze-SIDA, dhe janë njëjtësuar të gjitha problemet mjedisore atje dhe është përpiluar lista e prioriteteve. Po ashtu, projekti Vlerësimi i rrezikshmërisë së shëndetit nga ndotja me metale të rënda, është financiar nga qeveria holandeze të cilin projekt po e menaxhon OBSH-ja.

Transporti

Transporti ajror- Gjatë vitit 2008 totali i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës ka qenë 1,185,064, ndërsa në vitin 2009 totali i udhëtarëve ka shënuar rritje dhe ka qenë 1,266,993¹⁵, ndërsa në vitin 2010 numri i udhëtarëve ka qenë 1305532.

Numri i fluturimeve në Aeroportin e Prishtinës gjatë vitin 2008 ka qenë 7484, gjatë vitit 2009 7473, ndërsa

¹³ Fabrika e çimentos Sharrcem 2010

¹⁴ Fabrika e çimentos Sharrcem 2009

¹⁵ Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës, 2009

në vitin 2010 ishte 6143. Sasia e përdorur e kerozinës për vitin 2010 ka qenë 15.818.825 litra, për vitin 2009 ka qenë 19,222.538 litra, kurse për vitin 2008, 23.036.800 litra¹⁶. Sasia e shpenzuar e karburantit për nevojat e aeroportit për vitin 2008 ishte 331034.6 litra, ndërsa në vitin 2009 janë shpenzuar 4636.43 litra benzinë dhe 277608.92 litra naftë dhe në vitin 2010 janë shpenzuar 287292 litra naftë dhe 115940 litra naftë. (Tabela 10).

Tabela 10: Disa tregues të ndikimit të ANP-së në cilësinë e ajrit¹⁷

Treguesi	2008	2009	2010
Numri i udhëtarëve	1,185,064	1,266,993	1,305,532
Numri i fluturimeve	7484	7473	6143
Sasia e kerozinës së përdorur	19,222.538 litra	23.036.800 litra	15.818.825 litra
Sasia e shpenzuar e karburanteve	331034.6 litra	4636.43 litra benzinë 277608.92 litra naftë	115940 litra naftë 287292 litra benzinë

Transporti hekurudhor-Shpenzimet e naftës në vitin 2007 kanë qenë 1352980 litra, në vitin 2008 1395863 litra, në vitin 2009 1297310 litra, dhe në vitin 2010 1,355.361 litra Në Kosovë ka 333.5 kilometra rrugë hekurudhore. Numri i udhëtarëve për vitin 2009 ka qenë 374504 dhe për vitin 2010 376770 .. Sasia e mallrave të bartura është 911830 për vitin 2010 ka qenë 1217612 neto ton. Numri i trenave është 2508. Në vitin 2009 shihet se transporti i mallrave ka pasur rritje në krahasim me vitet paraprake, ndërsa numri i udhëtarëve ka rënë.

Transporti Rrugor- Kontribuues i rëndësishëm i ndotjes së ajrit në Kosovë, është edhe transporti rrugor. Në Kosovë çdo vit regjistrohen afërsisht 350000 vetura, ndërsa në tërë territorin e Kosovës sipas të dhënave nga viti 2010 numri i përgjithshëm është 406.050 Në tabelën e më poshtme është paraqitur numri i automjeteve sipas llojeve.

Tabela 11: Të dhënat për numrin e automjeteve në Kosovës për vitin 2008¹⁸

Viti	Totali	Vetura	Xhip	Autobusë	Kombi	Kamioneta	Motocikleta	Rimorkio	Të tjera
2008	211301	159522	1242	15095	4234	10630	2817	3344	7071

Gazrat Serë- Ne bazë të kalkulimeve për gazrat CO₂, CH₄ dhe N₂O për vitet 2008 dhe 2009, sektori i Energjisë është burimi më i madh i gazrave serë. Pastaj vjen sektori i Industrisë dhe ai i Transportit, ndërkohe që nuk ka të dhëna të kalkuluara për sasinë e gazrave serë që vijnë nga sektori i Bujqësisë dhe nga gjenerimi i mbeturinave komunale.

Tabela 12: Burimet e gazrave serë sipas sektorëve për vitin 2008 dhe 2009¹⁹

Burimet e Gazrave Sere sipas sektorëve	Njësia Gg (Giga Gram)					
	2008			2009		
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O	CO ₂	CH ₄	N ₂ O
Energjia	6,221,976.11	5,388.79	252.56	7,040,831.31	5,578.54	269.94
Industria	11,054.45	1.32	0.18	11,474.52	1.37	0.18
Transporti	1,073.30	0.15	0.07	1,110.44	0.15	0.07

16 Air BP Kosova, 2009

17 APN dhe Air BP Kosova, 2009

18 Ministria e Punëve të Brendshme, 2009

19 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë bëhet nga institucionet qeveritare (IHMK dhe IKSH) dhe nga operatorët ekonomik që kanë ndikim në cilësinë e ajrit (KEK, Sharcem dhe NewCo Feronikeli).

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë ende është i mangët. Pjesa më e madhe e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit llogariten sipas metodave klasike. Një stacion automatik për monitorimin e cilësisë së ajrit është i vendosur në oborrin IHMK-së në Prishtinë. Me këtë aparaturë analizohen: SO_2 , PM_{10} , NO_2 , NO_x , CO dhe O_3 . Në fund të vitit 2009, IHMK ka marrë si donacion nga Qeveria Sllovene edhe një stacion me një analizer për matjen e PM_{10} , $\text{PM}_{2.5}$, PM_1 dhe senzore të parametrave meteorologjik (temperatura e ajrit, shtypja, lagështia, drejtimi dhe shpejtësia e erës), i cili është vënë në funksion gjatë muajit qershor. Pritet që gjatë vitit 2010 të instalohen edhe 3 stacione të monitorimit automatike, në Prishtinë, Mitrovicë dhe Drenas. Në IHMK ekziston edhe softveri për përpunimin e të dhënave dhe raporteve.

Edhe IKSH ka dy analizatorë automatik, përmes të cilëve përcjell kualitetin e ajrit në dy pika matëse në Prishtinë. Aktualisht këto stacione janë jashtë funksionit për shkak të problemeve teknike.

- Instituti Hidrometeorologjik bënë monitorimin e ajrit në: Mitrovicë, Prishtinë dhe Drenas. Ky institucion përcakton koncentrimin e SO_2 , blozën dhe aerosedimentin (Pluhuri total i depozituar, pH, përçueshmëria elektrike, jonet sulfate dhe jonet klorure).
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike bënë matjen e cilësisë së ajrit në dy lokacione në Prishtinë, duke ofruar të dhëna për SO_2 , NO_2 , GTS (grimca të suspenduara).
- Instituti INKOS po ashtu bënë matje në zonën e termocentraleve "Kosova A dhe B".
- Kompleksi NewCo Feronikeli bënë monitorim vetanë për cilësinë e mjedisit, konkretisht për aerosediment dhe prezencën e metaleve në ajër në 9 pika monitoruese.

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga IHMK - Nga figurat 8 dhe 9 shihet se ka tejkalim të blozës, kurse për vlerat e SO_2 në pikën monitoruese në IHMK na paraqitet një gjendje krejtësisht tjetër ku gjatë tërë vitit nuk na është paraqitë ndonjë tejkalim i vlerave të SO_2 .




Figura 8: Vlerat mesatare mujore të blozës ($\mu\text{g}/\text{m}^3$) në pikën monitoruese IHMK, Prishtinë, 2005-2009²⁰




Figura 9: Vlerat mesatare mujore të SO_2 ($\mu g/m^3$) në pikën monitoruese IHMK, Prishtinë, 2005-2009

Po ashtu janë bërë matjet edhe për aerosediment, ku rezultatet janë paraqitur në tabelën 13.

Tabela 13: Vlerat mesatare vjetor të (PTD) pluhurit total të depozituar (aerosedimenti) në $mg/m^2.d^{21}$

Vendmostrimi	2009	2008	2007	2006	2005
IHMK	197.816	195.871	155.587	207.932	205.601
Shkolla "Bedri Gjinaj"	177.626	249.755	1248.054	130.225	120.345
Shkolla "Migjeni"	111.013	134.812	127.907	103.712	125.542
Alba Park Shupkovc	222.723	328.78	213.197	273.773	301.23
Vëllezërit Kuqi			120.471	183.117	129.512
Shkolla "Elena Gjika"	162.808	210.489	119.914	137.65	159.18
Parku Industrial Trepça	187.515	1030.792	2898.926	125.336	142.021
OSBE	180.882	769.76	2263.313	107.422	106.238
Fabrika e duhanit	88.637	78.559	1336.365	102.135	121.012
Fabrika e ujit	66.468	104.272	79.21	97.682	132.279

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga IKSHIP - Përqëndrimi mesatar i GTS gjatë periudhës janar-mars 2009 llogaritet rreth $60 \mu g/m^3$. Bazuar në supozimin e mësipërm, mund të konkludohet se nivelet mesatare vjetore të PM_{10} janë afër $50 \mu g/m^3$, gjë që tejkalon kufirin e lejuar të BE-së, për PM_{10} .

Përqëndrimi mesatar i SO_2 nga fillimi i janarit deri në fund të marsit 2009 ka qenë $16 \mu g/m^3$, në lokacionin afër MEF-Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Niveli i përqindjes, prej 99.73 % i vlerave mesatare vjetore për atë periudhë kohore është $161 \mu g/m^3$ dhe mund të thuhet se SO_2 është nën vlerat e kufirit të BE-së që është $350 \mu g/m^3$. Niveli i përqindjes prej 99.18 % i kalkuluar nga përqëndrimet mesatare 24 orësh është rreth $102 \mu g/m^3$ dhe kështu që është nën vlerën e asociuar të kufirit prej $125 \mu g/m^3$. Lidhur me të dhënat e stacionit të IKSHIP në periferinë perëndimore të Prishtinës, mesatarja ndërmjet janarit dhe mesit të majit të vitit 2009 për NO_2 është rreth $30 \mu g/m^3$, e cila është gjithashtu nën vlerat kufitare. Nivelet mesatare në stacionin e IKSHIP-së, midis janarit dhe mesit të majit 2009 arrijnë sasinë deri në $40 \mu g/m^3$ të NO_x ²².

21 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2009

22 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, 2010

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga instituti INKOS- Instituti INKOS, në disa pika bënë përcaktimin e përqendrimit të ndotësve kryesorë në ajër. Këtu përfshihen imisionet e SO₂ dhe blozës (Kastriot dhe Bardh), sedimenteve (në 6 vendmarrje) dhe thërmijat ajrore (në oborrin e INKOS-it). Vlerat mesatare mujore të imisionit të SO₂ dhe blozës gjatë vitit 2008 janë prezantuar në dy figurat vijuese.




Figura 10: Krahësimi i imisionit të SO₂ në Kastriot dhe Bardh për vitin 2008²³




Figura 11: Krahësimi i imisionit të blozës në Kastriot dhe Bardh për vitin 2008

Sedimentet analizohen për pluhur total, materie të përgjithshme inorganike, materie të përgjithshme të tretshme, pH, etj. Standardi për pluhur total është 300 mg/(m^{2d}). Në bazë të kriterëve të lejuara për SO₂ dhe blozë: SO₂ – 110 µg/m³ dhe blozë – 50 µg/m³ nuk ka tejkalim as për blozën as për SO₂ për vitin 2008.

Për përcaktimin e thërmijave ajrore shfrytëzohet metoda gravimetrike. Matjet bëhen pesë ditë në muaj, prej nga edhe nxjerrët mesatarja mujore. Nga figura 12 dhe 13 mund të konstatohet se gjatë vitit 2009 dhe 2010, nuk ka pas tejkalim të vlerave të lejuara për këtë parametër.





Figura 12: Përqendrimi mesatar i thërmijave ajrore gjatë vitit 2009²⁴

²³ Instituti INKOS, 2009

²⁴ Instituti INKOS, 2009

Figura 13: Përqendrimi mesatar i thërmijave ajrore gjatë vitit 2010²⁵

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga NewCo Feronikeli- Pluhuri i depozituar (aerosedimenti) analizohet sipas standardit gjerman VDI drejtimi 2119 Blatt 2 (1972). Rezultatet shprehen në mg/m²/ditë. Standardi për aerosediment (sipas OBSH-së) është 300 mg/m²/ditë. Përmbajtja e metaleve të rënda përcaktohet me spektrometër me absorbim atomik (SAA). Për monitorimin e pluhurit të depozituar (aerosedimentit) për vitin 2009 si dhe për vitin 2010 janë vendosur 9 pika monitoruese (6 brenda fabrikës dhe 3 jashtë fabrikës). Rezultatet e monitorimit të aerosedimentit janë paraqitur në tabelën vijuese.


Tabela 14: Paraqitja e vlerave mesatare për aerosediment dhe metaleve të rënda për vitin 2009 dhe 2010²⁶

Nr.	As_mes mg/m ² /ditë		Fe_mes(mg/l)		Ni_mes(mg/l)		Co_mes(mg/l)		Cr_mes(mg/l)	
	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010
1	347*	403	0.025	0.024	0.014	0.015	0.018	0.015	0.02	0.021
2	265	299	0.023	0.023	0.014	0.016	0.018	0.016	0.025	0.024
3	262	292	0.027	0.022	0.016	0.016	0.022	0.018	0.023	0.023
4	234	233	0.022	0.023	0.02	0.016	0.022	0.017	0.021	0.023
5	308*	259	0.019	0.023	0.018	0.012	0.02	0.018	0.022	0.022
6	147	204	0.026	0.021	0.02	0.015	0.018	0.017	0.018	0.02
7	114	176	0.021	0.02	0.017	0.015	0.019	0.016	0.02	0.019
8	144	147	0.022	0.026	0.022	0.015	0.016	0.016	0.023	0.024
9	144	158	0.02	0.023	0.019	0.015	0.017	0.016	0.021	0.025

Nga tabela shihet se në vitin 2009 nga gjithsej 9 pika monitoruese, nga vlera mesatare vjetore, vetëm në dy pika që gjenden brenda fabrikës ka tejkalim të standardit të OBSH dhe atë të parametrin aerosediment (pluhur total i depozituar). Në një pikë monitoruese vlerë mesatare vjetore rezulton të jetë 347 mg/m²/ditë, derisa në pikën tjetër ku është bërë monitorimi kemi vlerë mesatare vjetore prej 308 mg/m²/ditë. Në bazë të standardit të OBSH vlera e lejuar është 300 mg/m²/ditë. Kurse në vitin 2010 ka tejkalim vetëm në një pikë nga vlera e lejuar.

25 Instituti INKOS, 2010

26 New Complex Feronikeli



Harta 1: Lokacionet ku bëhet monitorimi i cilësisë së ajrit

Konkluzione dhe Rekomandime:

- Në pamundësi që të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit në mungesë të rrjetit të monitorimit për tërë Kosovën, për cilësinë e ajrit mund të flasim vetëm për zonat të cilat janë monitoruar.
- Nga të dhënat e stacioneve automatike monitoruese sa i përket cilësisë së ajrit me ndotësin PM₁₀ për zonën e Prishtinës, janë regjistruar shumë raste të tejkalimeve të vlerave limite me këtë parametër.
- Ndërsa me parametrat SO₂, NO₂, CO, O₃ nuk ka raste të tejkalimeve të vlerave limite për këtë periudhë të monitorimit.
- Nga të dhënat e monitorimit me metodat klasike (SO₂, bloza dhe aerosedimenti-grimcat e pluhurit të depozituara) ka tejkalime të vlerave limite (OBSH-së) me grimca të depozituara në Mitrovicë dhe me blozë në Prishtinë.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes rekomandohet:

- Zgjerimi i rrjetit të integruar të monitorimit të cilësisë së ajrit për tërë Kosovën (rritja e numrit të stacioneve monitoruese, organizimi i sistemit monitorues, investime në zgjerimin e kapaciteteve laboratorike, akreditimi i laboratorit analitik, ngritja e laboratorit kalibruar, ngritja e njësisë së servisimit të pajisjeve laboratorike dhe stacioneve të monitorimit automatik, ngritja e kapaciteteve humane për monitorimin e ajrit dhe analiza laboratorike, ngritja e kuadrit për sistemet e modeleve (modelimet e shpërndarjes së ndotjes).
- Përgatitja dhe zbatimi i programeve të monitorimit nga operatorët siç parashihen në ligjin për mbrojtjen e ajrit.

2.2. Uji

Resurset ujore - Nga territori i Kosovës, në vitin me lagështi mesatare rrjedhin $3.6 \times 10^9 \text{ m}^3$ (miliard) ujë ($121.2 \text{ m}^3/\text{sec}$), ndërsa vëllimi i përgjithshëm i akumuluar në akumulimet ekzistuese është **569.690.000 m^3** , që paraqet vetëm 15,7% të sasisë së përgjithshme mesatare. Pjesa më e madhe e lumenjve i takon pellgut të Detit të Zi 50.7%, Detit Adriatik 43.5% dhe Detit Egje 5.8%. Shumica e lumenjve karakterizohen me rrjedhje të çrregullt sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit ose në fillim të pranverës.

Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11.645 km^2 , çka do të thotë se vetëm për 758 km^2 apo 6.5 % ka mospërputhje me sipërfaqen e përgjithshme të saj.

Hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci.

Drini i Bardhë ka gjatësi më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km. Të dhënat për gjatësinë brenda territorit të Kosovës për lumenjtë kryesorë janë prezantuar në tabelën 14.

Tabela 15 : Gjatësia në kilometra e lumenjve kryesorë të Kosovës²⁷

Emërtimi	Gjatësia në km brenda territorit të Kosovës	Sipërfaqja m^2
Drini i Bardhë	122	4.622
Sitnica	90	2.873
Lumëbardhi i Pejës	62	424.9
Morava e Binçës	60	1.552
Lepenci	53	679.0
Ereniku	51	510.3
Ibri	42	1.155
Lumëbardhi i Prizrenit	31	262.6

Rrjedhat lumore të Kosovës derdhën në tre ujëmbledhës detarë: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje. Lumenjtë kryesorë të cilët i përkasin ujëmbledhësit të Detit të Zi janë: Ibri, Sitnica me degët; (Llapi, Drenica), dhe Morava e Binçës. Detit Adriatik i përkasin: Drini i Bardhë me degët (Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumëbardhi i Prizrenit, lumi i Klinës, Ereniku, Mirusha, Toplluha dhe Plava). Ndërsa, lumi i Lepencit me degën kryesore (Nerodime) i përkasin Detit Egje.


Vija ujëndarëse (pellgjet ujëmbledhëse), kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme. Koeficienti rrjedhës sillet prej 3.93 l/sec/km^2 (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km^2 (Lumëbardhi i Deçanit). Për më shumë shiko tabelën 15.

Tabela 16. Pellgjet ujëmbledhës, sipërfaqja, sasia rrjedhëse e ujit dhe vend derdhja²⁸

Nr.	Pellgu	S [km^2]	Q [m^3/s]	q [$\text{l/s} \cdot \text{km}^2$]	Rrjedhja vjetore [mil.m^3]	Kahja e rrjedhës
1	Drini i Bardhë	4649	61.0	14.6	2.200	Detit Adriatik
2	Ibri	4009	32.6	8.13	771	Deti i Zi
3	Morava e Binçës	1564	6.1	4.35	330	Deti i Zi
4	Lepenci	0.685	8.7	12.7	307	Deti Egje

²⁷ Disa fakte për mjedisin, ESK, 2007

²⁸ Gjendja e mjedisit në Kosovë, AKMM 2008



Harta 2: Pellgjet dhe nënpellgjet lumore

Rrjeti hidrometrik përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje të vazhdueshme kualitative dhe të koordinuara mbi vëllimin e ujit duke përfshirë edhe parametrat fiziko-kimik të vazhdueshme. Në kuadër të këtij projekti janë vendosur 22 stacione hidrometrike. Në këto stacione matën Nivelin (h) dhe Prurjen (Q). Në tabelën 16 janë prezantuar të dhënat për vlerat maksimale, minimale dhe mesatare të prurjeve vjetore në disa stacione.

Tabela 17 : Vlerat maksimale, minimale dhe mesatare vjetore të prurjeve ($Q = m^3/s$) të stacioneve hidrometrike sipas pellgjeve lumore²⁹

NR.	PELLGU	STACIONI	LUMI	Q_{MIN}	Q_{MES}	Q_{MAX}
1	DRINI BARDHË	Berkovë	Istogut	0.48	3.75	186
2		Drelaj	Bistrica Pejës	0.32	4.20	83.50
3		Grykë	Bistrica Pejës	0.46	5.95	194
4		Klinë	Klina	0.00	1.49	49.20
5		Mirushë	Mirusha	0.02	1.21	23.30
6		Deçan	Bistrica e Deçanit	0.60	4.28	58.00
7		Rakovinë	Drini Bardhë	0.80	24.64	358
8		Gjakovë	Ereniku	0.06	12.33	542
9		Piranë	Toplluha	0.04	3.47	55.40
10		Gjonaj	Drini Bardhë	0.10	48.8	1118
11		Prizren	Bistrica Prizrenit	0.03	4.47	424
12	IBRI	Drenas	Drenica	0.02	1.52	32.80
13		Lluzhan	Llapi	0.90	5.01	63.80
14		Nedakovc	Sitnica	0.50	13.62	328
15		Millosevë	Llapi	0.00	4.48	82.70
16		Prelez	Ibri	0.80	13.39	452.80
17		Leposaviq	Ibri	0.50	30.85	667
18	MORAVA BINQËS	Konçul	Morava Binçës	0.03	9.21	1012
19		Domarovic	Kriva Reka	0.2	2.6	30.8
20		Viti	Morava Binçës	0.05	1.06	18.70
21	LEPENCI	Kaçanik	Nerodime	0.15	4.17	17.50
22		Hani Elezit	Lepenci	0.10	10.49	184

Akumulacionet sipërfaqësore- Për të plotësuar nevojat për ujë të pijshëm, ujitje, peshkim, turizëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike, në shumë vende janë ndërtuar diga për të grumbulluar ujin e përrrenjve dhe lumenjve, gjatë stinëve me prurje të mëdha dhe për ta përdorur atë gjatë stinëve kur reshjet janë shumë të vogla dhe kërkesa është shumë e madhe. Në tabelën 15 janë prezantuar ndikimet negative dhe pozitive në mjedis nga akumulacionet ujore.

Kosova ka disa akumulacione sipërfaqësore ose sikur njihen ndryshe liqene artificiale (Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci) si dhe një numër të liqeneve të vegjël për ujitje.

Tabela 18: Akumulacionet kryesore në Kosovë, sipërfaqja, rrjedhja ujore dhe vëllimi³⁰

Emri i akumulacionit	Ujërrjedhja (lumi)	Sipërfaqja e pellgut [km ²]	Rrjedhja mesatare [m ³ /sek.]	Vëllimi akumulacionit Milion [m ³]	
				Shfrytëzues	Gjithsej
Gazivoda	Ibër	1060	13.5	350	390
Pridvorci	Ibër	-	-	0.435	0.49
Batllava	Batllavë	226	1.06	25.1	30
Badovci	Gračankë	103	1.05	27.0	31.6
Livoçi	Livoç	53.6	-	-	-
Radoniqi	Lumëbardhi i Deçanit	130	0.16	102	113

29 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2008

30 MMPH-Departamenti i ujërave, 2008

Në territorin e Kosovës, sipas Master Planit të Ujërave (1983) janë paraparë të ndërtohen edhe njëzet akumulacione sipërfaqësore të ujit si dhe një numër i mikro-akumulacioneve. Në tabelën vijuese janë prezantuar disa karakteristika të akumulacioneve të planifikuara për ndërtim.

Tabela 19: Karakteristikat themelore të akumulacioneve të planifikuara për ndërtim

Nr	Akumulimi	Lumi/Rrjedha	Sipërfaqja e (km ²)	Rrjedhjet mesatare (m ³ /s)	Derdhjet vjetore mil m ³ /vit	Vëllimi milion m ³
1	Drelaj	Bistrica e Pejës	173	4.65	146.6	84.5
2	Kërstovc	Lumi i Binçës	118	3.20 (2.16)	100.96	40
3	Movë	Lumi i Klinës	239	1.2.	37.80	34
4	Morinë	Llabenica	26	2.25 (0.73)	70.78 (22.87)	38
5	Ripaj	Lumi Trava	59	2.38 (1.35)	74.88 (42.65)	36
6	Reçan	Bistrica e Prizrenit	155	4.55	143.32	68
7	Dragaçin	Lumi Dragaçin	36	0.25	7.92	6.76
8	Kremenata	Lumi Kremenatë	56	-	15.90	8.75
9	Binçë	Lumi i Madhë	72	0.63	19.49	1
10	Konqul	Morava e Binçës	1632	6.86	216.03	120
11	Firajë	Lumi Lepenc	229	5.34	168.30	16.5
12	Shtime	Lumi Topillë	102	0.66	20.91	113
13	Cecelija	Lumi i Zi	47	0.41	12.92	21
14	Makovc	Lumi Prishtevka	26	0.19	6.01	10
15	Majanc	Lumi i Kançandollit	88	0.68	21.35	30
16	Vaganicë	Lumi Lushta	46	0.23	7.24	8
17	Miraçë	Lumi Tërstena	31	0.20	6.30	6
18	Dobroshevc	Lumi Drenica	35	1.38	43.4	23.2
19	Pollata	Lumi Llap	111	1.23	38.63	37.5
20	Bistrica	Bistricë e Prizrenit	159	1.40	44.24	25

Ujërat termale dhe minerale- Territori i Kosovës është i pasur me burime të ujërave termale dhe minerale. Deri me tani ka pasur shumë pak hulumtime për identifikimin dhe studimin e vlerave të këtyre burimeve. Sipas të dhënave në Kosovë janë të regjistruara rreth 30 burime të ujërave termale dhe minerale. Hulumtime më të detajuara janë kryer vetëm për ujërat e Banjës së Pejës, të Klllokotit dhe të Banjskës, të cilat funksionojnë si banja termale shëruuese. Përveç aspektit shëruës ujërat termale të Kosovës mund të përdoren edhe për prodhimin e energjisë termike, mirëpo deri me tani ende nuk ka pasur ndonjë studim të detajuar për të analizuar potencialin prodhues të këtyre ujërave. Në përgjithësi temperatura e ujërave termominerale të Kosovës sillet prej 17-54 °C, ndërsa shkalla e mineralizimit prej 2-5 g/l. Burimet e ujërave termale dhe minerale në Kosovë kanë përmbajtje të sulfatëve, hidrokarbureve, kalciumit dhe magnezit.


Tabela 20 : Karakteristikat fiziko-kimike të disa burimet termominerale të Kosovës³¹

Nr	Lokaliteti	Q l/sec	t °C	pH	Mineralizimi g/l	Komponent specifike	Përmbajtja Gazore
1	Banja e Pejës	4,00	48.9	6.9	2.04	H ₂ SiO ₃ ,Ra	CO ₂
2	Banja e Klllokotit	10,00	32.0	6.6	3.601	CO ₂ Ra,H ₂	CO ₂
3	Banjska	2.50	50.0	6.7	1.356	H ₂ SiO ₃	CO ₂
4	Banja e Runikut	15.00	24.8	7.1	0.598		CO ₂ -N ₂
5	Burimi i Nxehtë i Runikut	5.00	23.0	7.2	0.61	Ra	CO ₂ -N ₂
6	Gojbula	-	12.0	6.3	2.193	CO ₂	CO ₂

31 Energjia gjeotermale në Kosovë dhe perspektiva e zhvillimit të saj, Avdi Konjuhi et al

7	Uji i Lluzhanit	0.01	14.0	6.3	1.144	Ra, H ₂ SiO ₃	CO ₂
8	Studencia	1.0	25.0	7.1	0.670	-	CO ₂ -N ₂
9	Deçan	2.00	12.5	6.3	1.433	CO ₂	CO ₂
10	Getnja e Sipërme	0.1	9.0	6.6	2.539	-	CO ₂
11	Poneshi	0.03	13.0	6.3	3.539	CO ₂ , Fe	CO ₂
12	Pokleku	1.00	13.0	6.3	3.52	Fe, Ra, CO ₂ H ₂ SiO ₃	CO ₂
13	Uglari	6.00	25.00	6.8	0.688	--	CO ₂ -N ₂
14	Zhitija	0.3	20.0	6.5	5.126	Fe, CO ₂	CO ₂
15	Dobërçani	--	26.8	6.4	--	--	CO ₂ , H ₂ S

Me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të ujërave termale dhe minerale në Kosovë, në të ardhmen duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë hartimit të strategjive për shfrytëzimin e këtyre ujërave, rregullimit të infrastrukturës dhe planeve urbanistike, hulumtimeve të detajuara të karakteristikave fiziko-kimike dhe cilësisë së këtyre ujërave si dhe hulumtimeve mbi vlerësimin e potencialit të këtyre ujërave për prodhimin e energjisë gjeo-termale.



Harta 3: Shpërndarja e disa burimeve termominerale

Monitorimi i cilësisë së ujërave

PELLGU DRINI I BARDHË

Ky pellg ka sipërfaqe më të madhe se sa pellgjet e lumenjve të tjerë të vendit tonë. Rrjeti i monitorimit të këtij pellgu ka 24 stacione monitorimi të cilësisë fiziko-kimike. 3 nga këto stacione janë bazë të cilat i takojnë lumit Drini i Bardhë duke filluar nga burimi i tij në bjeshkën e Radavcit mbi Pejë, pastaj stacioni tjetër monitorues i radhës është pas puqjes së lumenjve Burim dhe lumit Klina në Klinë dhe stacioni i tretë i këtij lumi është vendosur pas puqjes së lumenjve Lumëbardhi i Pejës dhe Deçanit, lumit Mirushë, Erenik, Rimmik dhe Toplluhë, ndërsa vendndodhja e këtij stacioni është tek ura mbi lumë në vendbanimin Gjonaj të Hasit. Cilësia e ujit përgjatë rrjedhës së tij ndryshon nga stacioni në stacion. Në burim ka cilësi tejet të mirë dhe pastaj në dy stacionet tjera ka ndotje, të cilat vijnë nga ujërat e pa trajtuara që derdhen në të dhe në lumenjtë e cekur më lartë, që janë nënPELLGJE të këtij lumi. Po ashtu, ndotja vjen edhe nga ujërat që bëjnë shpëlarjen e tokave bujqësore. Në të gjitha

burimet e lumenjve uji është i cilësisë shumë të mirë. Të dhënat e analizave fizik-kimike për dy vjetët e fundit tregojnë që këto ujëra i takojnë klasës së I. Ndryshimi i gjendjes fillon përreth vendbanimeve, me shkarkimin e ujërave të ndotura, shkarkimet e ujërave nga kolektorët e industrive që gjenden përgjatë rrjedhës së këtij pellgu lumor. Po ashtu shkaktar i kësaj ndotje është edhe hedhja e mbeturinave sidomos në vendet e pozicionimit të urave dhe gjetkë. Deri te pika e bashkimit me lumin Burim, uji kryesisht është i cilësisë së mirë. Ndryshime drastike fillojnë në rajonin Zllakuqan–Ruhot dhe Zllakuqan–Klinë. Te pika e puqjes së Drinit të Bardhë me lumin Klina gjendja e tij bëhet e mjerueshme, rezultatet tregojnë për kategori të IV të kualitetit. Pra, uji i pellgut Drini i Bardhë ndotet nga shkarkimet e nënpellgjeve të cilat paraprakisht u janë nënshtruar ndikimeve njerëzore. Kjo gjendje vazhdon gjerë në Vllashnje te pika e shkarkimit të Lumëbardhit të Prizrenit.

Komente të përgjithshme për lumenjtë (nënpellgjet) e pellgut Drini i Bardhë

Burimi (Istog)- Buron nga bjeshka mbi qytetin e Burimit me një pastërti të madhe, me cilësi shumë të mirë dhe në krahasim me lumenjtë e tjerë ky lumë deri në puqje të tij me Drinin e Bardhë nuk pëson ndryshime të mëdha në cilësi, prandaj dhe nga monitorimi i gjertanishëm njihet si lumi më i pastër në Kosovë.

Lumëbardhi i Pejës (Bistrica e Pejës)– Formohet nga disa burime përgjatë Grykës së Rugovës të cilat burime në stacionin e parë monitorues në Kuqishtë kanë cilësi fiziko-kimike të mirë, përderisa kjo cilësi në stacionin tjetër pas shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane dhe industriale pëson ndryshime. Stacioni i tretë monitorues është në afërsi të Klinës para puqjes me lumin Drini i Bardhë, ku cilësia e tij është më e dobët.


Karakteristikë e këtij lumi është se gjatë stinës së verës, gjatë sezonit të ujitjes së tokave bujqësore shteron për një periudhë përafërsisht dymujore.

Lumi Klina- Stacioni i parë monitorues ndodhet në Siqevë. Nuk i plotëson kriteret e të ashtuquajturit burim i parë ose amë sepse ndodhet larg këtij lokaliteti, prandaj deri në këtë vendndodhje aktiviteti njerëzor është mjaftë i shprehur. Për këtë arsye dhe cilësia e tij është mjaftë e dobët në të dy stacionet monitoruese, gjë që kuptohet edhe nga rezultatet e analizave laboratorike të paraqitura më poshtë në grafikun.

Lumi Mirusha– Formohet në kodrinat mbi fshatin Bllacë të KK Therandës nga shumë burime te vogla ujore. Në fshatin Banjë të Malishevës merr formën e plotë të lumit dhe prej aty i shtohet edhe ujërrjedha e burimit të fuqishëm sipërfaqësor që njihet me emrin “Uligja e Banjës”. Ky lumë monitorohet vetëm në një stacion dhe atë në Volljak disa metra para derdhjes me lumin Drini i Bardhë. Cilësia e tij karakterizohet me turbiditet të vogël, sasia e oksigjen të tretur sillet ndërmjet 12-13 mg/l, përçueshmëria elektrike në mes 500-600 $\mu S/cm$, pra i takon ujërave të lumenjve me cilësi mesatare.

Lumëbardhi i Deçanit (Bistrica e Deçanit)- Stacioni i parë i monitorimit sipas rrjetit të IHMK gjendet në km e 3 të qytetit të Deçanit, mbi kishën e Deçanit, ku cilësia e tij është shumë e mirë. Stacioni tjetër ndodhet 10 m para puqjes me lumin e Drinit të Bardhë në fshatin Kralan të KK Gjakovë. Cilësia e tij në këtë stacion nuk është edhe alarmuese, por ka ngritje të vlerave të parametrave në krahasim me stacionin e parë. Në këtë lumë shkaktohet turbullirë e madhe për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i tij prej kompanive private, vetëm disa dhjetëra metra mbi stacionin e monitorimit të këtij lumi.

Ereniku- Stacioni i parë i monitorimit të cilësisë së këtij lumi ndodhet në bjeshkët mbi fshatin Jasiq KK Junik. Aty ku nuk ka influencë nga aktivitete njerëzore, cilësia e ujit është shumë e mirë. Stacioni i dytë sipas rrjetit të monitorimit është afër derdhjes në lumin Drini i Bardhë në afërsi të Gjakovës te Ura e Terzisë. Cilësia e këtij lumi në këtë stacion është e dobët. Karakteristikë që është vërejtur gjatë analizave është prezenca e sasive të detergjenteve. Lumi gjithnjë ka shumë mbi sipërfaqe, që është rezultat i ndonjë veprimtarie për larjen e tekstileve (rrobave), autolarjeve apo edhe të ndonjë përdorimi tjetër të detergjenteve nga industritë të cilat veprojnë në atë region dhe ujërat e tyre i shkarkojnë pa trajtim adekuat paraprak edhe pse nuk është e lejuar.



Harta 4: Monitorimi fiziko-kimik i ujërave sipërfaqësore

Rimniku– Monitorimi i tij fillon në vendin e quajtur Zhdrellë jo larg nga burimi i tij. Njihet si burim me përçueshmëri më të lartë se të gjitha burimet e tjera si dhe për përmbajtje të sasisë së konsiderueshme të metaleve të rënda. Stacioni i radhës është disa metra para puqjes me lumin e Drinit të Bardhë në Xërxe i cili ka sasi të vogël të oksigjenit dhe sasi të madhe të jonit amonium, fosfateve etj.

Toplluha– Stacioni fillestarë për monitorimin e këtij lumi është në vendin e quajtur Buqallë mbi kompleksin turistik “SOLID” KK e Suharekës. Uji i këtij lumi ka cilësi shumë të mirë në të gjithë parametrat e matur. Ndërsa, në stacionin e dytë në fshatin Piranë disa dhjetëra metra para puqjes me lumin e Drinit të Bardhë, uji ka cilësi më të dobët. Njihet si lumë me turbullirë permanente të lartë për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i tij.

Lumëbardhi i Prizrenit (Bistrica e Prizrenit)– Fillon nga Prevala, ka rrjedhje rrëqe. Stacioni i parë monitorues ndodhet po në grykën e Prevallës dhe ka cilësi mjaft të mirë në të gjitha aspektet. Stacioni i dytë në rrjetë është në fshatin Vlashnje 3,5 km para puqjes me lumin e Drinit të Bardhë. Nëse e krahasojmë cilësinë e ujit të tij në stacionin e parë monitorues do të vërejmë një ndryshim të madh të ndikimit të të gjitha ujërave të ndotura të shkarkuara përgjatë rrjedhës së tij në të.

Interpretimi i rezultateve

Sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur)– në vazhdimësi qëndron në vlera të konsiderueshme gjatë rrjedhës së këtij lumi (pellgu), ku vlerat kanë variuar nga 6.55 mg/l deri në 13.12 mg/l në vitin 2007, në vitin 2008 vlerat sillleshin nga 5.8 mg/l deri në 14,64 O_2 mg/l. Viti 2009 tregon një ndryshim në vlerën maksimale për oksigjenin e tretur 12.69 mg/l nga vitet paraprake që sillleshin nga 13.12 mg/l për 2007 dhe 14,64 O_2 mg/l për 2008. Viti 2010, parametri oksigjeni i tretur vlerë më të lartë rezulton në Drini i Bardhë- Gjonaj me 11,19mg/l, derisa

minimumi i vlerës së këtij parametri në lumin Rimnik-Xërxë është 7,52 mg/l.




Figura 14: Oksigjeni i tretur në pellgun e Drinit të Bardhë

Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅)– Në stacionin matës në Vllashnje- Lumëbardhi i Prizrenit ka vlera më të larta 6.74 mg/l për 2007, ndërsa në vitin 2008 vlera maksimale arrin 7.22 mg/l në lumin Rimnik- Xërxë. E njëjta gjendje paraqitet edhe për vitin 2009.

Nëse krahasojmë vlerat mesatare vjetore me vlerat e matjeve serike vërehet se SHBO₅ gjendet edhe në vlera më të larta së këto.




Figura 15: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Drinit të Bardhë

Sa i përket cilësisë mund të themi se nuk ka ndotje të theksuar në asnjë nga stacionet monitoruese. Parametrin shpenzimi biokimik i oksigjenit për vitin 2010 paraqitet me vlera jo shumë të ndryshme nga vitet tjera. Derisa në vitet paraprake nuk figuron matje në vendmostrimin Rimnik-Zhdrell për vitin 2010 ky parametër shënon maksimumin e vlerës mesatare vjetore. Lumëbardhi i Prizrenit-Prevallë prezantohet me minimumin e vlerës mesatare vjetore 1,05 mg/l.

Përçueshmëria elektrike (PE)– Gjatë vitit 2007 vlerën më të ulët e shënon lumi Lumëbardhi i Prizrenit-Prevallë 165 $\mu\text{S}/\text{cm}$, 151 $\mu\text{S}/\text{cm}$ dhe 120 $\mu\text{S}/\text{cm}$, ndërsa vlerën më të lartë lumi Klina- Siqevë me vlerë 850 $\mu\text{S}/\text{cm}$.




Figura 16: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Drinit të Bardhë

Në 2008 vlera më e lartë shënohet në lumin Rimnik- Xërxë 681 $\mu\text{s}/\text{cm}$, po ashtu edhe në 2009 vlerë maksimale shënohet në të njëjtin lumë (Rimnik), por në vendmostrimin Zhdrellë 665 $\mu\text{s}/\text{cm}$. Sikurse edhe për vitet 2008, 2009 edhe për vitin 2010 lumi Rimnik-Xërxë prin me maximum vlerë mesatare vjetore për përçueshmëri elektrike 688,5 $\mu\text{s}/\text{cm}$, derisa lumi Lumëbardhi i Prizrenit-Prevall ka VMV 101,6 $\mu\text{s}/\text{cm}$.

Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)- Në përgjithësi në vitin 2007 përqendrimi i jonit hidrogjen tregon një mes të lehtë bazik me vlerë më të ulët 7.71 deri në vlerë më të lartë 8.5. Në vitin 2008 mesi anon nga një vlerë neutrale, ku vlera më e ulët është në lumin Burim me 7.57 dhe ajo më e larta shënohet në lumin Rimnik-Zhdrellë.




Figura 17: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Drinit të Bardhë

Edhe për vitin 2009 kemi vlera të përafërta me një minimum 7.49 lumi Klina –Siqevë dhe me maksimum vlerë 8.31 lumi Lumëbardhi i Pejës. Për vitin 2010 vlerat e pH tregojnë vlera të përafërt sikurse edhe vitet e mëparshme.

Nitritet (NO_2^-)- Në vitin 2007 vlerat maksimale vjetore (VMV) të këtij parametri janë matur në lumin Drini i Bardhë në Gjonaj dhe lumin Rimnik në Xërxë me vlerë $\sim 0.15 \text{ mg}/\text{l}$, ndërsa në vitin 2008 vlerat maksimale vjetore (VMV) paraqiten në lumin Erenik tek Ura e Terzive. Gjatë matjeve serike vlera maksimale e këtij parametri është analizuar që kishte vlerën 0.94 mg/l në mostrën e lumit Erenik të Ura e Terzisë në muajin gusht. Në këtë rast vlen të potencojmë se sasia e ujit në lumë ka qenë minimale duke krahasuar me periudhën tjetër vjetore. Vitet 2009 dhe 2008 tregojnë një rritje të theksuar të këtij parametri në krahasim me 2007, ku në lumin Rimnik vendmostrimi Xërxë, rezulton me një vlerë maksimale vjetore 0.633 mg/l , që njëherazi është vlera më e lartë mesatare e regjistruar në këtë pellg për këto tri vite.




Figura 18: Nitritet në pellgun e Drinit të Bardhë

Vlerat e lejuara maksimale të nitriteve janë mjaftë të ulëta të cilat nuk do të duhej të tejkalojnë vlerën 0.01mg/l siç kemi rastin tek ujërat e burimeve, por sipas diagramit vlerat e përfituara gjatë monitorimit në disa nga këto stacione tejkalojnë këtë vlerë duke i bërë këto ujëra të cilësisë së dobët. Viti 2010 për parametrin nitrit me maksimum vlerë mesatare vjetore (0,76 mg/l) rezulton lumi Rimnik vendmostrimi Xërxë, derisa po i njeiti lum por vendmostrimi Zhdrellë ka minimumin e vlerës mesatare vjetore 0,05 mg/l.

Amoniake (NH_4^+) – Në lumin Rimnik stacioni monitorues në Xërxë ka koncentrim më të shprehur të këtij parametri për 2007, 2008, 2009 dhe 2010 me vlerë 6.38 mg/l, 4.84 mg/l si dhe një ulje të lehtë 3.76 mg/l për 2009 dhe 2,66 mg/l për 2010. E gjithë kjo rezulton për arsye se kemi të bëjmë me një lumë që shtrihet mes përmes tokave bujqësore, por duke mos neglizhuar edhe të gjitha shkarkimet e ujërave urbane të qytetit të Rahovecit me disa fshatra që si zakonisht të pa trajtuara derdhen në rrjedhën e këtij lumi.




Figura 19: Amoniake në pellgun e Drinit të Bardhë

Duke u bazuar në vlerat e lejuara të cilat nuk duhet të jenë më të larta se 1.5 mg/l vërehet se përveç në vendburime ku cilësia e ujërave është e mirë, në stacionet e tjera të monitorimit kjo cilësi është e nivelit mesatar dhe e ulët.

Sulfatet (SO_4^{2-})– Në lumenjtë Klina, Rimnik dhe Toplluha sulfatet janë më prezentë se sa në të gjithë lumenjtë e tjerë që nga vendburimi i këtij pellgu ku jonet sulfate variojnë për vitin 2007 mes 5.5 mg/l në lumin Lumëbardh i Pejës –Gryka e Rugovës dhe 45.15 mg/l në lumin Klina–Siqevë. Për 2008 jonet sulfate variojnë në mes 1.8 mg/l në lumin Erenik–Jasiq dhe 31.4 mg/l në lumin Rimnik–Xërxë, ndërsa për vitin 2009 dhe 2010 lumi Rimnik–Xërxë, përsëri tregon vlerë maksimale vjetore 52.2 mg/l (2009) dhe 39,90 mg/l (2010).




Figura 20: Sulfatet në pellgun e Drinit të Bardhë

Sipas rezultateve të paraqitura në diagram vlera e sulfateve është brenda kufijve të lejuar për ujërat sipërfaqësore, sepse vlera limite e jonit sulfat tek uji i pijshëm është 200 mg/l.

Fosfatet (PO_4^{3-})- Në 2007 joni fosfat sillet ndërmjet vlerave 0.014 mg/l në lumin Lumëbardhi i Deçanit - mbi Kishë dhe 2.05 mg/l në lumin Rimnik-Xërxë, ndërsa në 2008 lumi Klina-Klinë, ka vlerë më të lartë sesa lumenjtë tjerë me vlerë 2.09 mg/l. Sa i përket vlerës më të ulët gjatë këtij viti, është matur në Erenik-Jasiq <0.001 mg/l. Për vitin 2010 vlera minimale vjetore poashtu është në Erenik-Jasiq 0.001 mg/l. Ndërsa për vitin 2009 dhe 2010 vlerë maksimale vjetore tregon lumi Rimnik- Xërxë 1.728 mg/l (2009) dhe 1,93 mg/l (2010).




Figura 21: Fosfatet në pellgun e Drinit të Bardhë

Fosfori total (poli dhe orto)- Vlera e fosforit total në pellgun e Drinit të Bardhë rezulton me luhatje të mëdha. Përmbajtja e fosforit total për 2007 sillet prej 0.014 mg/l në lumin e Mirushës në stacionin Volllakë dhe 0.94 mg/l në lumin Rimnik-Xërxë, ndërsa për 2008 në lumin Rimnik-Zhdrellë përmbajtja e fosforit është 0.001 mg/l dhe 0.56 mg/l në lumin Rimnik-Xërxë. Po ashtu në vitin 2010 sikurse edhe në vitet 2007, 2008 dhe 2009 lumi Rimnik -Xërxë prinë me vlerë mesatare vjetore më të ngritur 0.55 mg/l.




Figura 22: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Drinit të Bardhë

Nga vlerat e lejuara maksimale sipas Direktivës 152/99 vërehet se lumi i Rimnikut ka cilësi të dobët, ndërsa stacionet e tjera të monitorimit të këtyre lumenjve kanë cilësi të mirë.

Fortësia e përgjithshme (FP)- Fortësia e përgjithshme e ujit monitorohet vetëm në vendburime të lumenjve. Shumica prej tyre shfrytëzohen për ujë të pijes drejtpërdrejtë pa ndonjë trajtim fiziko-kimik dhe në bazë të vlerave të përfituara laboratorike përmbushin standardet e OBSH për ujin e pijes që duhet të jetë $< 30 \text{ d}^0\text{H}$. Burimet të cilat nuk shfrytëzohen për ujë të pijes janë lumi Klina dhe Toplluha, gjë që shihet edhe në këtë diagram, ku vlerat të këto dy stacione monitorimi janë më të larta se tek vendburimet e lumenjve të tjerë.




Figura 23: Fortësia e përgjithshme në pellgun e Drinit të Bardhë

Në vitin 2007 lumi Erenik-Jasiq tregon vlerën më të ulët $5.06 \text{ d}^0\text{H}$, ndërsa lumi Klina vendburimi Siqevë tregon maksimumin me vlerë $22.05 \text{ d}^0\text{H}$. Lumi Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë, për vitin 2008 rezulton me fortësi mesatare të ujit me vlerë $4.2 \text{ d}^0\text{H}$, ndërsa vlerën më të ngritur të fortësisë mesatare e ka lumi Klina-Siqevë me vlerë $16.24 \text{ d}^0\text{H}$. Gjendje e njëjtë paraqitet edhe për vitin 2009 dhe 2010 ku vlerë më të ngritur të fortësisë mesatare ka lumi Klina – Siqevë me $20.51 \text{ d}^0\text{H}$ (2009) dhe $16,38 \text{ d}^0\text{H}$ (2010).

PELLGU I IBRIT

Pellgu i Ibrit ka gjithsej 17 stacione monitorimi. Tri nga to janë stacione që i takojnë lumit Ibër. Stacioni i parë është në Kushtovë, ku cilësia e tij është e kënaqshme. Stacioni i radhës është në dalje të qytetit pas të gjitha shkarkimeve të ujërave urbane e të tjera, të cilat ndikojnë që cilësia e ujit të jetë më e dobët në këtë stacion. Stacioni i tretë ndodhet në Kelmend pas puqjes së tij me lumin Sitnica, i cili paraprakisht me vete përmban gjithë sasinë e ujërave të nënpellgjeve të këtij pellgu lumor. Gjatë kësaj periudhe monitoruese nuk është vërejtur ndonjë rast për tu alarmuar, pasi që në të gjitha pikat monitoruese vlerat janë brenda kufijve të lejueshmërisë sipas kategorisë së II.

Komente të përgjithshme për lumenjtë e pellgut Ibër

Lumi Sitnicë- Duke filluar prej Ferizajt deri në Mitrovicë është lumi më i ndotur në Kosovë. Sa i përket parametrave fizik, materiet e suspenduara janë prezentë dhe i tejkalojnë vlerat maksimale të lejuara. Kjo vjen nga ajo se në këtë lum derdhet njëra pjesë e lumit të Nerodimës dhe lumenjtë: Shtime, Graçanka, Prishtina, Drenica, Llapi, Trepça si dhe ujërrjedha të tjera më të vogla, ku të gjitha këto puqen në lumin Sitnicë dhe përmbajnë në vete ujërat e shkarkimeve të amvisërisë dhe ujërat e shkarkimeve industriale. Edhe parametrat kimik duke u bazuar në matjet e bëra siç janë SHKO (COD) dhe SHBO₅ (BOD₅) si indikatorë që tregojnë për ndotje permanente të këtij lumi.

Graçanka- Cilësia e ujit të këtij lumi është në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kizhnicës dhe Artanës. Ka vlera të larta të metaleve të rënda si: zink, nikel dhe plumb. Po ashtu, prinë edhe me vlera të larta të përçueshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat. Vlen të ceket se gjatë stinës së ngrohtë të verës ky lumë shteron.

Prishtina- Monitorimi i këtij lumi bëhet në Bresje të Fushë Kosovës, para derdhjes së tij në lumin Sitnica. Ky nuk mund të quhet lumë sepse nuk plotëson asnjë kriter, por ky është kolektor i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane e ujërave tjera të kryeqytetit të Kosovës. Gjithashtu ka tejkalim të sasisë së nitrive, materie të suspenduara, shpenzim kimik dhe biokimik të oksigjenit, mungesë të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

Llapi- Monitorimi i këtij lumi bëhet që nga burimi i tij mbi fshatin Reçicë dhe vazhdon pastaj në Podujevë në dalje të qytetit dhe stacioni i tretë dhe i fundit në Milloshevë para puqjes së tij me lumin Sitnicë. Ky lum nuk ka tejkalim të VML.

Drenica- Monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga Komorani dhe para bashkimit me Sitnicën në Vragoli. Gjatë stinës së pranverës në stacionin e parë monitorues ka një cilësi më të mirë, përderisa në stacionin e dytë në Vragoli gjendja e tij pëson ndryshime të theksuara, p.sh. përçueshmëria elektrike rritet për disa qindra njësi, si rezultat i shkarkimeve të ujërave të mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut.

Shtimja- Ka dy stacione monitorimi, njërin në pjesën ku nuk ka ndikim të jashtëm nga aktivitetet njerëzore, ku cilësia e tij është shumë e mirë dhe stacioni i dytë është pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat përreth dhe të vetë qytetit të Shtimes, prej nga cilësia e ujit të këtij lumi kalon në kategori mjaft të dobët.

Interpretimi i rezultateve

Në vijim përmes rezultateve me VMV të paraqitura në grafikone do të interpretohet gjendja e ujërave në pellgun e Ibrit me vlera mesatare vjetore të secilit parametër në secilin lumë të këtij pellgu.

Sasia e oksigjenit të tretur (O₂ tretur)- Vërehet se variojnë nga stacioni në stacion, por mund të themi se në të gjitha rrjedhat e këtij pellgu ka sasi të mjaftueshme të oksigjenit të tretur, përveç në lumin Prishtina në Bresje sasia e O₂ është e ulët.

Nëse i krahasojmë vlerat e vitit 2007 me ato të 2008 shihet se nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Vlera më e lartë e O₂ është matur në lumin Drenica-Krojmir me vlerë 13.8 mg/l, ndërsa vlerën minimale në 2007 e shënon lumi Prishtina-Bresje. Duhet pasur parasysh se këto janë vlera mesatare vjetore. Ka pas raste gjatë dinamikës mujore të monitorimit që në këtë stacion monitorimi të mos ketë fare O₂ të tretur. Pasqyra e njëjtë vlen edhe për vitet 2008 dhe 2009. Për vitin 2010 gjendja mbetet e njëjtë, tretshmëri më të madhe të oksigjenit ka lumi Ibër – Kushtovë 12.48 mg/l, derisa vlerën mesatare vjetore më të ulët e ka lumi Prishtina- Bresje 3,43 mg/l oksigjen i tretur.




Figura 24: Oksigenit të tretur në pellgun e Ibrit

Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅)- Nga të gjitha stacionet matëse, vlera më të larta për 2007 dhe 2008 ka lumi Prishtina në Bresje, tek i cili vazhdimisht paraqiten vlera më të larta se në të gjitha stacionet tjera të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Kosovës. Në krahasimet e bëra në mes vlerave të vitit 2007,2008 dhe 2009 vërehen ndryshime të vogla, çka nënkupton se edhe cilësia e ujit e këtij pellgu në vazhdimësi nga viti në vit, pra nga sezoni në sezon, ka pak ndryshime. Vlera maksimale e SHBO₅ është në stacionin Bresje të lumit Prishtina me vlerë mesatare vjetore 19.8 mg/l për 2007 dhe 18.43 mg/l për 2008, 2009 kjo vlerë ishte 15.1 mg/l, ndërsa për 2010 kjo vlerë arrin në 19,67 mg/l të SHBO₅. Kurse vlera më të ulëta janë matur në burimet e lumenjve të këtij pellgu.




Figura 25: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Ibrit

Përçueshmëria elektrike— në vitin 2007 vlerën më të ulët e shënon lumi Llap-Reqicë 257 $\mu\text{S}/\text{cm}$, ndërsa vlerën më të lartë lumi Graçanka-Vragoli me vlerë 1512 $\mu\text{S}/\text{cm}$.




Figura 26: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Ibrit

Në 2008 vlerat sillen nga më e ulëta në lumin Shtime-Petrovë 304 $\mu\text{S}/\text{cm}$ deri tek ajo më e larta në lumin Graçanka-Vragoli me vlerë 1426 $\mu\text{S}/\text{cm}$.

Në vitin 2009 vlera më e ulët është regjistruar në lumin Sitnica-Bablak, ndërsa vlera më e lartë mesatare në vendmostrimin Graçanka-Vragoli 1621 $\mu\text{S}/\text{cm}$. Sikurse edhe në vitet tjera, në vitin 2010 lumi Graçanka-Vragoli ka vlerën më të lartë mesatare vjetore 1521.8 $\mu\text{S}/\text{cm}$ derisa minimumi i vlerës mesatare vjetore është matur në lumin Ibër-Kushtovë 305 $\mu\text{S}/\text{cm}$.

Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH) - Vlerat e pH sillen zakonisht ndërmjet vlerave 7.74 deri në 8.49 për vitin 2007, ndërsa për 2008 këto vlera gjenden ndërmjet 7.45- 8.18, kurse për vitin 2009 vlerat variojnë nga 7.34 në 8.23. Për 2010 pH sillet nga 7.18 deri në 8.19. Thënë përgjithësisht këto ujëra i takojnë një mesë të dobët bazik.




Figura 27: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Ibrit

Nitritet (NO_2^-) - Vlerat e këtij treguesi kanë pësuar rritje gjatë vitit 2008 në krahasim me ato të vitit 2007, kjo tregon se sasia e rrjedhës ka qenë më e vogël gjatë vitit 2008 që edhe ka rezultuar në ngritjen e vlerave të këtij parametri në mbi 0,1 mg/l në disa nga këto stacione të monitorimit. Në Mitrovicë, nitritet në lumin Sitnica arrin vlerën 0.685 mg/l, po ashtu edhe në Vragoli ka vlerë të lartë të NO_2^- ,575 mg/l, që na jep të kuptojmë për cilësinë e dobët të këtij lumi. Edhe për 2009 me vlerë të ngritur prinë lumi Sitnica- Mitrovicë 0.548 mg/l, ndërsa vlera më e ulët si mesatare vjetore është matur në lumin Llap- Reqicë 0.016 mg/l. Viti 2010 vlerë mesatare vjetore ka më të ngritur lumi Sitnica- Mitrovicë 0.61 mg/l, ndërsa vlera më e ulët si mesatare vjetore është matur në lumin Llap- Reqicë 0.015 mg/l.




Figura 28: Nitritet në pellgun e Ibrit

Amoniaku (NH_4^+) - Si edhe më lartë tek treguesi paraprak edhe këtu kemi stacionin Bresje të lumit Prishtina i cili ka vlera më të larta se sa stacionet e tjera të monitorimit të lumenjve të këtij pellgu. Këto vlera sillen për 2007 nga 0,1 mg/l në lumin Shtimja në Petrovë, deri në vlerë më të madhe 13,5 mg/l në lumin Prishtina-Bresje. Edhe për 2009 nuk kemi ndonjë ndryshim. Me vlerë më të lartë prinë Prishtina-Bresje 8.582 mg/l dhe me vlerë minimale lumi Ibër-Kushtovë 0.455 mg/l. Edhe për 2010 me vlerë mesatare vjetore më të lartë shënohet lumi Prishtina-Bresje 10.44 mg/l dhe me vlerë minimale lumi Drenic-Krojmir 0.36 mg/l.




Figura 29: Amoniaku në pellgun e Ibrit

Sulfatet (SO_4^{2-})- Në grafikun ku janë lumenjtë Llap, Sitnicë, Ibër, Drenica dhe Shtimja, parametri sulfat për vitin 2007 gjendet ndërmjet vlerave 5.28–23.82 mg/l, për vitin 2008 paraqitet me vlerë 2.7–27.5 mg/l, ndërsa për vitin 2009 vlerat sillen ndërmjet 2.5 dhe 40 mg/l, janë vlera të cilat nuk tregojnë lëvizshmëri të madhe nga viti në vit. Edhe për vitin 2010 gjendja mbetet e njëjtë ku vlerat sillen nga 4.96 dhe 29.27 mg/l.




Figura 30: Sulfatet në pellgun e Ibrit (me vlera më të ulëta)

Ky parametër është ndarë në dy diagrame për vetë faktin se në disa stacione vlera e tij është për dhjetëra herë më e madhe se tek stacionet e paraqitura në diagramin e parë. Tani në këtë grafik janë paraqitur vendmostrimet me vlera më të larta për SO_4^{2-} , ku në të katër vitet dominon lumi Graçanka.




Figura 31: Sulfatet në pellgun e Ibrit (me vlera më të larta)

Fosfatet (PO_4^{3-})- Në vitin 2007 ky parametër ka vlerë më të ulët në lumin Ibër-Kushtovë 0.053 mg/l, ndërsa vlerë më të lartë ka lumi Prishtina-Bresje 2.44 mg/l. Në vitin 2008 joni fosfat ka vlerën më të ulët në lumin Shtimje-Petrovë 0.014 mg/l, ndërsa lumi Sitnica-Vragoli si dhe lumi Drenica-Vragoli arrijnë vlerën më të lartë të jonit fosfat ~ 4.8 mg/l.

Lumi Shtime-Petrovë për vitin 2009 rezulton me vlerë minimale 0.027 mg/l, derisa në lumin Prishtina-Bresje është matur vlera maksimale vjetore 2.629 mg/l.




Figura 32: Fosfatet në pellgun e Ibrit

Sikurse edhe në vitet 2008, 2009 edhe në vitin 2010 lumi Prishtina-Bresje rezulton me matje maksimale vjetore më të lartë 2,65 mg/l PO_4^{3-} , derisa minimumin e vlerës mesatare vjetore e tregon lumi Ibr-Kushtovë 0,03 mg/l PO_4^{3-} .

Fosfori total (poli dhe orto) - Përmbajtja e fosforit total për 2007 sillet prej 0.013 mg/l në lumin Ibr-Kushtovë dhe 1.23 mg/l në lumin Prishtina-Bresje. Për vitin 2008, lumenjtë në këto vendmostrime Llap-Reqicë, Shtimje-Petrovë tregojnë vlerat maksimale të paraqitjes së jonit fosfat <0.001 në krahasim me vlerën më të lartë të këtij parametri 0.67 mg/l në lumin Prishtinë-Bresje. Për vitin 2009 lumi Prishtina-Bresje ka vlerën 0.474 mg/l që është vlera më e lartë si mesatare vjetore, ndërsa në lumin Llap-Milloshëvë janë matur vlerat më të ulëta si mesatare vjetore 0.156 mg/l.




Figura 33: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Ibrit

Gjendja mbetet e njejtë, edhe në vitin 2010 lumi Prishtina-Bresje rezulton me vlerë mesatare vjetore më të lartë 1,398 mg/l të këtij parametri fosfori total, derisa vlerë minimale mesatare vjetore ka lumi Llap-Reqicë.

Fortësia e përgjithshme (FP)- Po ashtu edhe në këtë pellg, fortësia e përgjithshme e ujit monitorohet vetëm në vendburime të lumenjve. Në bazë të vlerave të përfituara laboratorike, përbushin standardet e OBSH për ujë e pijes < 30 d°H.




Figura 34: Fortësia e përgjithshme në pellgun e Ibrit

PELLGU I LEPENCIT DHE MORAVËS SË BINÇËS

Komente të përgjithshme për lumenjtë e pellgjeve Lepenc dhe Morava e Binçës.

Lumi Lepenc– Ky lumë ka dy burime, njëri në bjeshkën e Prevallës e tjetri në bjeshkën e Brezovicës. Që të dy kanë cilësi shumë të mirë të ujërave. Kjo gjendje vazhdon të qëndrojë deri në shkarkimin e ujërave të kompanisë “Silkapor”, ku herë pas here ujin e pastër të lumit Lepenc, këto ujëra e turbullojnë tej mase. Kjo dukuri vazhdon për disa km dhe është prezent edhe në stacionin e dytë të monitorimit të këtij lumi i cili ndodhet para puqjes me lumin Nerodime në Kaçanik.

Pas bashkimit me këtë lumë, matja bëhet në stacionin e tretë në Han të Elezit, që është stacion ndërkufitar me Republikën e Maqedonisë, ku cilësia e tij është brenda kufijve të lejueshëm.

Lumi Nerodime– Ky lumë formohet nga bashkimi i disa rrjedhave të vogla ujore që burojnë në bjeshkët e Jezercit, komuna e Ferizajt, me një cilësi të lartë të ujit. Në stacionin e dytë pas shkarkimeve të ujërave urbane dhe të ujërave të tjera të regjionit të Ferizajt cilësia e ujit të këtij lumi bie, duke vazhduar kështu edhe në stacionin e radhës në Kaçanik para puqjes së tij me lumin Lepenc.

Morava e Binçës– Monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga Morava e Binçës, pastaj në Kllokot dhe Uglare dhe në kufirin me Serbinë në Domorovc. Ky lumë bashkohet me Lumin e Lakuar të Dardanës. Në këtë lumë po ashtu shkarkohen të gjithë ujërat urbane dhe industriale të Vitisë, Gjilanit dhe Dardanës.

Lumi i Lakuar– Ky lumë ngërthen në vete dy rrjedha. Në pikën e parë të monitorimit uji rezultojnë me cilësi të lartë, përderisa në stacionin e dytë në Domorovc cilësia e ujit bie. Parametrat që rezultojnë më ndotje më të lartë janë: turbullira, amoniaku si dhe nitritet.

Interpretimi i rezultateve

Interpretimin e gjendjes së nënpellgjeve të lumit Lepenc dhe Moravë e Binçës do ta paraqesim në vijim me anë të grafikoneve me vlera mesatare vjetore të secilit parametër në secilin lumë të këtyre pellgjeve.

Sasia e oksigjenit të tretur (O_2 tretur)– Nga grafiku vihet re tendenca në ulje e vlerave të oksigjenit të tretur në stacionet pas shkarkimit të kolektorëve të ujërave të ndotura urbane. Në rrjedhjen e sipërme ujërat janë të pastër dhe të pasur me oksigjen. Varfërimi i lumenjve me oksigjen është pasojë e konsumit të tij pas shkarkimit të lëndëve organike, burim kryesor i të cilave janë shkarkimet urbane.




Figura 35: Oksigjenit të tretur në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Uji i lumit Nerodime-Gërlicë dhe lumi Morava e Binçës- Uglare, në të tri vitet rezultojnë me sasi më të vogël të parametrit oksigjen i tretur dhe kjo si pasojë e shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale të pa trajtuara paraprakisht. Por, sasia minimale që nuk do të duhej të jetë nën 3 mg/l nuk është tejkaluar në këtë pellg.

Lumi Nerodime-Gërlicë edhe për 2010 tregon pasqyrë të njëjtë sikurse edhe tri vitet tjera, vlerë minimale 6.237 mg/l, derisa vlerë maksimale tregon lumi Lumi i Lakuar- Ajnovc 11.22 mg/l.

Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅)- Në vitin 2007 SHBO₅ tregon vlerën më të ulët në lumin Morava e Binçës-Binçë 1.35 mg/l dhe vlerën më të lartë në lumin Nerodime –Gërlinë 15.67 mg/l. Në vitin 2008 vlerat minimale janë shënuar në lumin Morava e Binçës- Binçë 1.04 mg/l dhe vlerat maksimale mesatare vjetore në lumin Nerodime-Gërlinë 11.97 mg/l.




Figura 36: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Ndërsa, në vitin 2009 në lumin Lepenc-Kaçanik, është matur vlera minimale vjetore 2.9 mg/l, kurse lumi Nerodime-Kaçanik tregon vlerë maksimale vjetore 6.8 mg/l. Në vitin 2010 në lumenjtë Lepenci-Brezovicë dhe Nerodimja-Jezerc ka minimumin e vlerës mesatare vjetore 0,00 mg/l, derisa maksimumi i vlerës mesatare vjetore është në lumin Nerodimja- Gërlinë 8.22mg/l.

Përçueshmëria elektrike (PE)– Në vitin 2007 vlerën më të ulët e shënon lumi Lepenc- Brezovicë 120 μ s/cm, ndërsa vlerën më të lartë Lumi i Lakuar- Domorovc me vlerë 685 μ s/cm. Në 2008 vlerat sillen nga më e ulëta në lumin Nerodime-Jezerc 138 μ s/cm deri tek ajo më e larta në lumin Morava e Binçës-Uglare me vlerë 624 μ s/cm.




Figura 37: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Në vitin 2009 vlera më e ulët figuron në lumin Lepenc-Brezovicë , ndërsa vlera maksimale mesatare vjetore është matur në Lumin e Lakuar-Domorovc 628 mg/l.

Për vitin 2010 vlerat sillen nga më e ulëta në lumin Lepenc- Brezovicë 86 μ s/cm derisa vlerën më të lartë të përçueshmërisë matet në lumin Morava e Binçës- Uglare 503 μ s/cm.

Përgjendrimi i jonit hidrogjen (pH)- Vlerat e pH sillen zakonisht ndërmjet vlerave 7.82 deri në 8.63 për vitin 2007. Në 2008 këto vlera gjenden ndërmjet 7.61-8.14, përderisa në vitin 2009 vlerat e pH sillen nga 7.6-8.27. Përgjithësisht ujërat në këto pellgje i takojnë një mesi të dobët bazik.Edhe për vitin 2010 pH ka thuhetse mes të njejtë të pH sikurse edhe vitet paraprake nga minimumi i vlerës mesatre vjetore 7.63-8.24.




Figura 38: Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Nitritet (NO_2^-):- Për 2007, ky parametër tregon minimumin e tij në lumin Morava e Binçës-Binçë 0.001 mg/l, ndërsa maksimumin e vlerave mesatare vjetore paraqitet në lumin Nerodime-Kaçanik 0.774 mg/l. Vendmostrimi i njëjtë për vitin 2008 kap vlerën 1.085 mg/l, ndërsa për 2009 paraqitet një vlerë ekstreme 7.35 mg/l, i njëjti rast si në Lumin e Lakuar- Domoroc që arrin vlerë të lartë 5.63 mg/l.




Figura 39: Nitritet në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Për vitin 2010 joni nitrit NO_2^- në lumin Nerodime-Kaçanik ka maksimumin e vlerës mesatare vjetore 0.853 mg/l derisa minimumi i vlerës mesatare vjetore në lumin Nerodime-Jezerc paraqitet si matje me vlerë 0.010 mg/l.

Amoniaku (NH_4^+)- Si element i ndotjes së freskët rezultojnë në sasi të mëdha sidomos pas kolektorëve shkarkues urban e rural. Amoniaku në kushte alkaline $\text{pH} > 10$ në mjedisin pritisë sipërfaqësor ka efekte dëmtoese në faunën ujore. Prania e tij në ujëra ka efekte olfaktike me shfaqjen e erërave të pakëndshme.




Figura 40: Amoniaku në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Viti 2007 paraqet vlera më të ulëta të amoniakut në lumin Morava e Binçës-Binçë me 0.47 mg/l, ndërsa vlera më e lartë paraqitet në lumin Nerodime-Gërlaçë 9.32 mg/l. Viti 2008 minimumin e vlerës mesatare vjetore (VMV)

e ka në lumin Nerodime-Jezerc < 0.001 mg/l dhe maksimumin e arrin në lumin Nerodime-Gërlicë 24.32 mg/l. Në vitin 2009 vlerë minimale vjetore ka lumi Lepenc-Brezovicë 0.245 mg/l, kurse lumi Nerodime-Gërlicë kap vlerën maksimale 3.556 mg/l. Viti 2010 tregon këtë pasqyrë; vlerë minimale vjetore ka lumi Lepenc-Brezovicë 0.14 mg/l, kurse lumi Nerodime-Gërlicë kap vlerën maksimale 11.63 mg/l.

Sulfatet (SO_4^{2-})- Në 2007 lumi Morava e Binçës-Binçë tregon vlerën më të ulët 4.25 mg/l, kurse vlerën më të lartë Lumi i Lakuar-Ajnovc 229.5 mg/l. Në vitin 2008 vlera më të ulëta të këtij parametri janë shënuar në lumin Lepenc-Brezovicë 1.93 mg/l, ndërsa vlera më e lartë në Lumin e Lakuar-Domorovc me vlerë 147.2 mg/l.




Figura 41: Sulfatet në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Për vitin 2009 lumi Nerodime – Jezerc e ka minimumin e mesatares vjetore 3.47 mg/l dhe maksimumin e arrin Lumi i Lakuar me vlerë 137.9 mg/l.

Në 2010 lumi Morava e Binçës-Binçë tregon vlerën më të ulët 6 mg/l, kurse vlerën më të lartë Lumi i Lakuar-Ajnovc 77 mg/l

Fosfatet (PO_4^{3-})- Për 2007 vlera minimale të fosfateve janë gjetur në Lumin e Lakuar 0.005 mg/l, ndërsa maksimale në lumin Nerodime-Gërlicë 1.278 mg/l, Për vitin 2008 vlera më të ulëta janë shënuar në lumin Lepenc-Brezovicë 0.015 mg/l dhe me të larta në lumin Nerodime-Gërlicë 2.288 mg/l.

Në vitin 2009 lumi Nerodime- Jezerc ka minimumin e vlerave vjetore 0.008 mg/l, po ashtu i njëjti lumë në vendmostrimin Gërlicë shënon maksimumin e vlerave vjetore 1.79 mg/l.

Në vitin 2010 lumi Lepenc-Brezovicë ka minimumin e vlerave vjetore 0.020 mg/l, ndërsa lumi Nerodimja-Gërlicë shënon maksimumin e vlerave vjetore 1.011 mg/l

Nga rezultatet vijmë në përfundim se parametri fosfat gjatë këtyre tri viteve të monitorimit vlerën maksimale e ka në stacionin e monitorimit Nerodime-Gërlicë.




Figura 42: Fosfatet në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Jonet fosfate në vlera më të ngritura paraqiten kryesisht në ato stacione ku monitorimi është bërë pas shkarkimeve urbane dhe industriale.

Fosfori total (poli dhe orto) - Edhe ky parametër në vendburime ka vlera të ulëta. Në 2007 vlerë më të ulët ka Lumi i Lakuar-Domorovc 0.02 mg/l si dhe vlerë më të lartë lumi Nerodime -Kaçanik 0.64 mg/l. Në vitin 2008 vlerat më të ulëta i kanë lumenjtë Lepenc-Brezovicë dhe Nerodimja-Jezerc (< 0.001 mg/l), pra vendburimet e këtyre lumenjve.

Në vitin 2009 vlerë mesatare më të ulët shënon lumi Lepenc-Kaçanik 0.08 mg/l, ndërsa vlera më e lartë e mesatares vjetore regjistrohet në lumin Nerodimja- Kaçanik 0.607 mg/l.




Figura 43: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Në vitin 2010 lumi Nerodime- Jezerc ka minimumin e vlerave vjetore 0.009 mg/l, po ashtu i njëjti lumë në vendmostrimin Gerlicë shënon maksimumin e vlerave vjetore 0.408 mg/l.

Fortësia e përgjithshme (FP)- Sikurse në pellgjet e tjera edhe në këtë pellg fortësia e përgjithshme e ujit monitorohet vetëm në mostrat e burimeve të lumenjve.




Figura 44: Fortësia e përgjithshme në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Ndotja e ujërave nga metalet e rënda

Metalet e rënda në ujërat sipërfaqësore nga IHMK-ja kanë filluar të monitorohen nga vitit 2008. Disa nga to janë elemente toksike p.sh. Pb^{2+} , Cd^{2+} , Cu^{2+} , Cr^{6+} , Ni^{2+} etj. Por në mesin e tyre përfshihen edhe elementet esenciale si: Fe^{2+} , Zn^{2+} , Mn^{2+} , Cr^{3+} . Metalet e rënda si: kadmiumi dhe plumbi janë gjetur në ujëra si pasojë e zbrazjes së hedhurinave nga mbetjet e proceseve industriale.

Tabela 21: Vlerat maksimale të lejuara për disa metale të rënda sipas direktivës BE 152/1999³²

Nr	Metalet e rënda	Simboli	Njësia	VML
1	Kromi	$Cr^{3+}/6+$	mg/L	0.2
2	Kadmiumi	Cd^{2+}	mg/L	0.02
3	Nikeli	Ni^{2+}	mg/L	2.0
4	Zinku	Zn^{2+}	mg/L	0.5
5	Mangani	Mn^{2+}	mg/L	2.0
6	Bakri	Cu^{2+}	mg/L	0.1
7	Hekuri	Fe^{2+}	mg/L	2.0

³² "DEKRETI LEGJISLATIV 11 MAJ 1999, NR. 152", Dispozita për mbrojtjen e ujërave nga ndotja, Direktiva 91/271/EEC për trajtimin e ujërave të shkarkuara urbane.

8	Plumbi	Pb^{2+}	mg/L	0.2
---	--------	-----------	------	-----

Pellgu i Drinit të Bardhë- Në bazë të direktivës së BE-së 152/1999 metali krom paraqet një kalueshmëri të VML në lumenjtë Rimnik dhe Erenik si dhe në dy pika monitoruese në Lumëbardhin e Prizrenit.




Figura 45: Metalet e rënda në pellgun e Drinit të Bardhë

Pellgu i Ibrit– Në këtë pellg janë evidente prezencat e metaleve të rënda si: kromi (Cr^{3+}) në të dy stacionet e monitorimit të cilësisë së lumit Shtime, në lumin Sitnica në stacionin e Plemetit. Prej shumë bartësve që janë prezentë, një influencë në këto ujëra e ka edhe metali kadmium (Cd^{2+}). Në grafik shihet se në lumin Graçanka në stacionin e tij të monitorimit në Vragoli ka një kërcim të theksuar në krahasim me stacionet e tjera të monitorimit, ndërsa metali (Zn^{2+}) që vjen nga ujërat e pompura prej minierës së Kizhnicës, në bazë të Direktivës 152/1999, gjendet në kufirin e vlerës së lejuar.




Figura 46: Metalet e rënda në pellgun e Ibrit

Pellgu i Lepencit dhe Morava e Binçës– Në këto dy pellgje metali krom ($Cr^{3+/6+}$) ka një tejkalim nga vlerat e lejuara në bazë të Direktivës 152/1999, përderisa sasia e metaleve të tjera të përcaktuar ndodhen në sasi më të vogla se sa VML.




Figura 47: Metalet e rënda në pellgun e Lepencit dhe Morava e Binçës

Konkluzione

- Gjendja e përgjithshme e ujërave në Kosovë në të gjitha aspektet dhe dimensionet e saj është e pakënaqshme;
- Kosova ende nuk ka: plan strategjik për ujërat, plan për administrimin e ujërave, plan për administrimin e pellgjeve dhe plan për administrimin e përmytjeve;
- Baza e të dhënave për ujërat është ende e pakompletuar dhe paraqet pengesë për planifikim cilësor në sektorin e ujërave;
- Ka shfrytëzim pa kriter të resurseve ujore dhe shfrytëzim të pakontrolluar të inerteve nga shtretërit e lumenjve e cila ndërlidhet me shkatërrimin e shtretërve të lumenjve;
- Ka mungesë të investimeve për ndërtimin e sistemeve të kanalizimeve dhe impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Ka mungesë të hulumtimeve shkencore në fushën e ujërave në mungesë të instituteve hulumtuese;
- Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve përgjegjëse për lëmin e ujërave dhe bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve qeveritare, jo qeveritare dhe publikut;
- Nuk ka një sistem të integruar të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

2.3. Toka (dheu)

Shfrytëzimi i tokave- Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfidë është që të parandalohet degradimi i tokave përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave. Në tabelën 22 janë prezantuar të dhëna për klasat e përdorimit të tokave në hektarë (ha), ndërsa në tabelën 23 janë prezantuar kategoritë e tokave sipas komunave.

Tabela 22. Sipërfaqja totale e tokave sipas klasave të përdorimit³³

Përdorimi i sipërfaqes	Sipërfaqja (ha)
Pyje	464800
Tokë pyjore	28200
Tokë bujqësore	342400
Kullosa dhe livadhe	153200
Tokë e djerrë	23400
Zona urbane, ndërtesa	40000
Sipërfaqe ujore	4600
E pa klasifikuar	41600
Gjithsej	1098200

Sipas tabelës nga sipërfaqja totale prej 464 800 ha, 278 880 ha ose rreth 60% është klasifikuar si tokë pyjore publike. Pjesa e mbetur 40% (185 920 ha) është pronë private. Këto shifra ndryshojnë si nga shënimet statistikore të vjetra, po ashtu edhe nga shënimet kadastrale.

Tabela 23: Kategoritë e tokave sipas komunave³⁴

Emri i Komunës	Kategoritë e tokave/ ha			
	Toka djerrina që shfrytëzohen si kullosa	Toka djerrina që nuk shfrytëzohen	Toka të ndotura	Gjithsej
Deçan	960			960
Gjakovë	800	420		1220
Glllogoc	1600			1600
Gjilan		2332.4		2332.4
Dragash		60		60
Istog	4000	410	48	4458
Kaçanik	300	116		416
Klinë	800			800
Fushë Kosovë	360	228	157	745
Kamenicë	3583			3583
Mitrovicë	2532.9			2532.9
Leposaviq				
Lipjan	350			350
Novo Bërdë				
Obiliq	1400	1350	147	2897

³³ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2009

³⁴ Anketa Administrative Gjysmë Vjetore/ Zyra e Statistikave Bujqësore-MBPZHR

Rahovec	3513	1520		5033
Pejë	1020	4493		5513
Podujevë	1805	1478		3283
Prishtinë				
Prizren	200	150	5	355
Skenderaj	1600			1600
Shtime	149		1	150
Shtërpçë		215		215
Suharekë	3550	900	17	4467
Ferizaj				
Viti	500	12		512
Vushtrri	450	271.7		721.7
Zubim Potok				
Zveçan			20	20
Malishevë	2217.05			2217.05
Gjithsej	31689.95	13956.1	375	46021.05

Faktorët kryesorë që ndikojnë në humbjen e tokave në Kosovë janë:

- Vendbanimet (ndërtime të paplanifikuara);
- Industria (mbeturinat e ngurta, mihjet sipërfaqësore);
- Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave
- Mbeturinat e shtëpiake dhe deponitë;
- Erozioni;
- Eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit.

Njëra prej formave më të shpeshta të humbjes së tokave bujqësore është ndërtimi i destimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Sipas të dhënave të MBPZHR, që janë siguruar nga Drejtoritë Komunale për Bujqësi, gjatë periudhës 1999-2008, rreth 2,580.50 ha tokë bujqësore i është ndërruar destinimi pa lejen e Kuvendeve Komunale. Ndërsa rreth 198.24 ha të sipërfaqes së tokës bujqësore i është ndërruar destinimi me leje nga Kuvendet Komunale.




Figura 48: Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore pa leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008³⁵

35 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. 2009




Figura 49: Sipërfaqja e tokës bujqësore të cilës i është ndërruar destinimi në tokë jo bujqësore me leje të Kuvendeve Komunale 1999-2008

Sipas vlerësimeve të MBPZHR, llogaritet se rreth 400 ha tokë bujqësore brenda vitit i ndërrohet destinimi i shfrytëzimit në tokë ndërtimore.

Ndotja e tokave me metale të rënda - Kjo kategori e ndotjes është prodhuar nga proceset industriale. Metale të rënda dhe shumë toksike të cilat kontribuojnë në ndotje janë: mercuri metalik dhe komponimet organomerkurike si dimetilmercuri i $Hg(CH_3)_2$, arseni, plumbi, kadmiumi, beriliumi etj. Efektet e tyre në organizëm janë tejet negative duke shkaktuar dëmtime të sistemit nervor, sistemit kardiovaskular, sistemit urinar, po ashtu shkaktojnë pneumoni dhe plagë të rënda në lëkurë.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Aktualisht as operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit nuk e bëjnë monitorimin e rregullt të cilësisë së tokës (dheut), prandaj edhe AMMK ka mungesë të dhënave për kualitetin e dheut në këto zona.

Në vitin 2008 **NewCo "Feronikeli Complex"** ka bërë disa analiza (matje) të dheut në brendi të rrethojës së fabrikës dhe në disa lokacione tjera përreth, për të verifikuar përqendrimin e disa metaleve të rënda. Të dhënat nga këto matje janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 24: Lokacionet dhe rezultatet për ndotjen e dheut me metale të rënda në zonën e NewCo "Feronikeli Complex"³⁶

Lokacionet e vendmarrjes se mostrave	Metalet e rënda/njësia			
	Hekuri-Fe %	Nikeli-Ni mg/kg	Kobalti-Co mg/kg	Kromi-Cr mg/kg
Në perëndim të shkrites	4.05	628.0	20.0	204
Në jug-perëndim të shkrites	3.50	557.0	3.0	102
Në afërsi të stacionit të zjarrfikësve të Drenasit	2.96	136.5	gjurmë	40
Tërstenik afër mullirit	2.96	72.5	gjurmë	13
Çikatovë	2.88	308.5	gjurmë	54
Nën deponi të skories	2.50	334.0	gjurmë	66
Suka	3.81	648.0	gjurmë	158
Rezervuarët e ujit të fabrikës	2.59	140.0	gjurmë	n.d.

Në bazë të udhëzimit administrativ për nivelet maksimale të lejuara të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve në tokë, VML nga analizat e prezantuara në tabelë për metalet e rënda si Nikeli (Ni) dhe Kromi (Cr), janë tejkalluar pasi që VML në tokë për këto metale është 50 mg/kg.

36 NewComplex Feronikeli, 2009

Disa të dhëna për zonat e identifikuar si hot-spote mjedisore për shkak të ndotjes me metale të rënda janë prezantuar në pjesën e raportit ku flitet për identifikimin e hot- spoteve mjedisore. Për më shumë shiko tabelën 54.

Erozioni - Erozioni në territorin e Kosovës rrezikon natyrën dhe pasuritë shoqërore dhe private të krijuara dhe të planifikuara nga njerëzit. Erozioni manifestohet me degradimin e tokës bujqësore, pyjore, rrjetit rrugor dhe hekurudhor si dhe me degradimin e objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve. Gjendja e ekzistuese e erozionit është prezantuar në tabelën 25.

Tabela 25: Kategoritë e Erozionit në Kosovë, sipërfaqja në km² dh pjesëmarrja në % sipas kategorive³⁷

Kategoria e Erozionit	Sipërfaqja km ²	%
Kategoria I, II dhe III	5.973 km ²	55.6 %
Kategori IV (erozion i dobët)	3.680 km ²	34.2 %
Kategoria V (erozion shumë i dobët)	1.097 km ²	10.2 %
Gjithsej	10.750 km²	100 %

Pra erozioni i kategorive I, II, III dhe IV përfshinë sipërfaqen prej 9.653 km² ose 89.8 % nga sipërfaqja e përgjithshme. Produktiviteti më i theksuar i aluvioneve është në rrjedhën e sipërme të lumit Ibër (gjendja duhet përmirësuar me masa dhe veprime anti-erozive). Po ashtu edhe sipërfaqet e pellgut të Lepencit janë të rrezikuara nga erozioni. Pastaj vijnë pellgjet e Drinit të Bardhë dhe Moravës së Binçës. Produktiviteti më i vogël i erozionit është në pellgun e lumit Sitnicë. Vlerësimi i gjendjes së erozionit në territorin e Kosovës është prezantuar edhe në hartën vijuese.

Përmbytjet e tokave-Mbrojtja nga përmbytjet dhe rregullimi i regjimit ujqorë kërkojnë qasje serioze dhe afatgjate. Ndër faktorët kryesorë që shpiten deri te paraqitja e vërshimeve dhe përmbytjeve janë:

- Shtretërit e parregulluar të lumenjve;
- Dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorrit;
- Ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe urave në vende që janë të rrezikuara nga vërshimet;
- Hedhja e mbeturinave në lumenj;
- Prerja e pyjeve në afërsi të zonave vërshuese;
- Mirëmbajtja e dobët e objekteve mbrojtëse;
- Mungesa e mjeteve financiare për ndërtimin e objekteve mbrojtëse të reja.


Në bazë të vlerësimeve të kryera (Master Plani i vitit 1983) për përmbytjet me rastisje një herë në 100-vite, si dhe në bazë të zhvillimit i cili ka qenë në kohën e përllogaritur, mund të konstatohen edhe dëmet nga vërshimet.

Sipas kësaj llogaritjeje dëmet nga vërshimet në pellgun e Drinit të Bardhë do të ishin 50%, në pellgun e Ibër 24%, në pellgun e Lepencit 20% dhe 6% në pellgun e Moravës së Binçës. Me qëllim të parandalimit të paraqitjes së përmbytjeve janë paraparë projekte për rregullimin e shtretërve të lumenjve.

Sipas vërtetimeve të deritanishme gjatësia e lumenjve të Kosovës të cilët janë të rrezikuar nga vërshimet sillet rreth 491 km. Deri më tani janë rregulluar vetëm 140 km, ose 28% e gjatësisë së përgjithshme të paraparë për rregullim³⁸.

³⁷ Departamenti i Ujërave, 2009

³⁸ ³³ Departamenti i Ujërave, 2009



Harta 5 : Zonat erozive

Ujitja e tokave - Rreth 42.226 ha të tokave bujqësore të Kosovës, ujitën. Sipërfaqet e tokave përgjatë lumenjve të mëdhenj janë më të përshtatshme për ujitje. Rreth 50.000 ha të tokave bujqësore janë shumë të përshtatshme për ujitje dhe rreth 100.000 ha të tjerë do të mund të ishin të favorshme me disa masa përmirësuese. Pjesa më e madhe e tokës së ujitur është në regionin e Pejës me rreth 13.915 ha të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së kultivuar bujqësore, ndërsa pjesa më e vogël në regionin e Gjilanit me 1.781 ha. Sipërfaqet e tokave të ujitura sipas regjioneve në Kosovë janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 26: Sipërfaqet e tokave të ujitura sipas regjioneve³⁹

Regjioni	Sipërfaqja e ujitur (ha)	Sipërfaqja e përgjithshme e tokave të kultivuara bujqësore (ha)	Gjithsejtë sipërfaqe (ha)
Kosova	42 226	195 575	237 801
Prishtinë	3 741	51 624	55 365
Mitrovicë	2 861	37 047	39 908
Pejë	13 915	17 848	31 763
Gjakovë	3 784	17 313	30 624
Prizren	3 784	22 190	25 947
Ferizaj	2 833	18 680	21 513
Gjilan	1 781	30 873	32 654

39 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, ESK 2010

Edhe sa i parkete komunave Peja ka sipërfaqen më të madhe të tokave të ujitura. Të dhënat për sipërfaqet e ujitura sipas komunave janë prezantuar në tabelën 27.

Tabela 27: Sipërfaqet e tokave bujqësore të ujitura sipas komunave⁴⁰

Komunat	Sipërfaqja e ujitur (ha)	Sipërfaqja e përgjithshme e tokave të kultivuara bujqësore (ha)	Gjithsejtë sipërfaqe (ha)
Kosova	42.226	195.575	237.801
Deçani	5.144	4.423	9.567
Gjakova	3.626	7.333	10.959
Glllogoci	108	4.202	4.310
Gjilani	285	8.953	9.238
Dragashi	496	4.174	4.670
Istogu	3.831	6.849	10.680
Kaçaniku	293	3.019	3.312
Klina	2.418	5.623	8.041
Fushë Kosova	202	5.817	6.019
Kamenica	509	8.779	9.228
Mitrovica	790	4.661	5.451
Leposaviqi	33	369	402
Lipjani	1.170	16.570	17.740
Novobërda	36	1.574	1.610
Kastrioti	416	3.211	3.627
Rahoveci	4.541	5.556	10.097
Peja	7.666	5.376	13.042
Podujeva	1.163	11.743	12.906
Prishtina	647	8.508	9.155
Prizreni	1.739	5.722	7.461
Skenderaj	497	20.433	20.930
Shtimja	576	3.847	4.423
Shtërpca	1.274	471	1.745
Suhareka	1.167	5.592	6.759
Ferizaj	688	11.343	12.031
Vitja	987	13.141	14.128
Vushtrria	1.210	9.880	11.090
Z.Potoku	202	1.261	1.463
Zveçani	129	444	573
Malisheva	383	6.701	7.084

Aktualisht në Kosovë sistemi i ujitjes administrohet nga ndërmarrja publike qendrore “Hidrosistemi Ibër Lepenc” dhe nga dy Kompanitë Rajonale të Ujitjes “Drini i Bardhë” dhe Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini⁴¹. Karakteristikat kryesore të skemave të ujitjes nga Kompanitë e Ujitjes janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

⁴⁰

⁴¹ Ligji për Ndermarrjet Publike

Tabela 28: Karakteristikat e skemave kryesore të ujitjes zyrtare⁴²

Skema	Lloji i ujitjes	Sipërfaqja e pajisur (ha)	Sipërfaqja e ujitur në (ha)	Sipërfaqja e ujitur nga skemat e tanishme dhe burimet e ujit gjatë pikut sezonal (ha)
Ibër Lepenc	Ujitje me spërkatës	20.000	515	14.500 ¹
Radoniqi	Ujitje me spërkatës	8.600	4.700	5.000
Dukagjini	Ujitje sipërfaqësore dhe me spërkatës	5.000	800	2.500
Drini Bardhë Pejë	Ujitje sipërfaqësore	6.500	1.300	2.500
Istog	Ujitje sipërfaqësore	8.500	1.350	2.000
Lumi i Bardhë	Ujitje sipërfaqësore	8.500	1650	3.000
Totali		57.100	10.315	29.500

Në tabelën 29 janë prezantuar sipërfaqet e ujitura nga Kompanitë Publike të Ujitjes për periudhën 2008-2009, ndërsa në figurën vijuese është prezantuar kronologjia e sipërfaqeve të ujitura për periudhën 2000-2008.

Tabela 29: Sipërfaqet e ujitura nga ndërmarrjet publike të ujitjes 2008-2009⁴³

Ndërmarrjet e ujitjes	Sipërfaqet e ujitura/ha 2008	Sipërfaqet e ujitura /ha 2009
Iber-Lepenci	1424	1132
Radoniqi dhe Dukagjini	5248	5234
Drini i Bardhë	1650	1050
Gjithsej	8322	7416

Ndërsa bazuar në një hulumtim të bërë nga Departamenti i Ujitjes në MBPZHR është vërtetuar se në vitin 2005, sipërfaqja nën ujitjen jozyrtare (jashtë Kompanive të Ujitjes) ishte gati sa sipërfaqja e ujitur nga Kompanitë e Ujitjes.

Tabela 30: Llojet e ndryshme të ujitjes jo zyrtare në vitin 2005⁴⁴

Llojet e ujitjes	Sipërfaqja (ha)
Skemat moderne/të përmirësuara të ujitjes nën KU	7,063
Skemat tradicionale të ujitjes nën KU	1,581
Totali i ujitjes jo zyrtare	8,644
Ujitje jo zyrtare e sipërfaqeve me ujin e lumit me gravitet	5,208
Ujitje jo zyrtare me spërkatës me pompa	641
Ujitje jo zyrtare e sipërfaqeve me ujin e lumit me pompa	542
Ujitje me burime	1,700
Ujitje me ujin tokësor me pus	984
Totali i ujitjes jo zyrtare	8,225

42 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

43 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

44 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2009




Figura 50: Sipërfaqet e ujitura (ha) nga NPH Ibër Lepenc për periudhën 2000-2008





Figura 51: Uji që shfrytëzohet për ujitje nga kompania e ujitjes Radoniqi

Në figurën 51 është paraqitur shpenzimi i ujit për ujitje nga Kompania e Ujitjes në Radoniq për periudhën 2006-2008, ku vërehet një rritje e shfrytëzimit të ujit në këtë sektor.



Harta 6 : Tokat me pozicion të volitshëm për ujitje

2.4. Biodiversiteti

Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Aktualisht numri i Zonave të Mbrojtura të Natyrës është 97 dhe përfshinë sipërfaqen prej 47.842,34 ha (4.39 % të territorit të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës (“Bifurkacioni i lumit Nerodime”, “Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, etj.), 1 Park Kombëtar (“Mali Sharr”), 83 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë”, “Shpella e Gadimes”, “Gryka e Rugovës”, “Ura e Fshajtë”, shumë biomonumente”, etj.), 2 Parqe Regjionale të Natyrës (“Gërmia” dhe “Mirusha”) dhe 1 Park Pylli (“Pishat e Deçanit”).


Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë Parku Kombëtar “Mali Sharr” me 84 % të sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura.

Gjatë periudhës së pasluftës janë marrë nën mbrojtje ligjore 54 zona të reja të natyrës dhe janë propozuar mbi 159 të tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura shumica janë monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, spelologjik etj.

Në kuadër të zonave të propozuara është proceduar edhe Parku i dytë Kombëtar, “Bjeshkët e Nemuna” dhe shumë monumente të natyrës.

Tabela 31: Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Kategoria	Emërtimi	Nr	Sipërfaqja /ha
I	Rezervate të natyrës	11	846.92
	R.N. Bimore	6	
	R.N. Shtazore	2	
	R.N. Speciale	3	
II	Park Kombëtar	1	39.000
III	Monument Natyre	83	6.296,93
	M.N. Spelologjike	4	
	M.N. Hidrologjike	15	
	M.N. Gjeomorfologjike	6	
	M.N. Botanike	55	
	M.N. Memoriale	1	
	Muzeu i kristaleve në Stantërg	1	
V	Peizazh i mbrojtur	2	1. 683,49
	Park Pylli	1	15
	Totali	97	47.842,34



Harta 7 : Zonat e mbrojtura

Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura

Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllim të:

- Kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore;
- Mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve;
- Ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve;
- Përkujdesjes së shërbimeve mjedisore;
- Mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Turizmit dhe rekreacionit;
- Arsimimit dhe sigurimit të qasjes së publikut në informata;
- Përdorimit të qëndrueshëm të resurseve nga ekosistemet natyrore;
- Ruajtjes së veçorive kulturore dhe tradicionale.
- Ruajtjes së hapësirës reprezentative me vlera natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare

Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës definohet me akte nënligjore në pajtim me ligjet të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, për çdo zonë të mbrojtura të natyrës përcaktohet shkalla e I, II dhe III e mbrojtjes.

Akti për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës përcakton qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikën të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i menaxhimit nga organi që e vënë nën mbrojtje dhe i cili aprovohet nga ministria si dhe plani hapësinor për zonën përkatëse.

Vetëm 3 zona të mbrojtura deri më sot kanë organe menaxhuese. Menaxhimi i Parkut Kombëtar "Mali Sharr" bëhet nga Drejtoria e Parkut me seli në Prizren që vepron në kuadër të MMPH. Drejtoria për momentin menaxhon me territorin e Parkut Kombëtar me sipërfaqe prej 22 230 ha që gjendet në komunat e Prizrenit (19 500 ha) dhe Suharekës (2730 ha).

Rezervatet që gjenden brenda territorit të Parkut Kombëtar: "Maja e Arnenit", "Pisha e Madhe", "Oshlaku" dhe "Rusenica" menaxhohen nga Drejtoria e PK "Mali Sharr", ndërsa rezervatet e tjera ("Maja e Ropsit", "Gubavci", "Gazimestani", "Kozhnjeri", "Malet e Prelepit", "Bifurkacioni i lumit Nerodime", "Kamilja") nuk kanë organe menaxhuese.

Parku regional "Gërmia" menaxhohet nga ndërmarrja publike "Hortikultura" ndërsa parku regional

“Mirusha” nuk ka organ menaxhues. “Shpella e Gadimës” menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje të qeverisë, ndërsa monumentet tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse.

Gjendja e Zonave të Mbrojtura

Zonat e mbrojtura të natyrës dhe biodiversiteti kanë pësuar ndryshime kryesisht si pasojë e ndikimeve negative të faktorit antropogjen si: ndërtimet ilegale dhe ndërhyrjet, prerjet e pakontrolluara të pyjeve, por edhe faktorët tjerë jo antropogjen si: sëmundjet, zjarret etj. e që janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes, legjislacionin në fuqi dhe normat ndërkombëtare. Ndikimet e tilla dhe mungesa e përkujdesjes institucionale janë duke bërë që këto zona t’i humbin përgjithmonë karakteristikat e tyre natyrore për të cilat janë vënë nën mbrojtje.

Zonat në të cilat ka pasur ndikime gjatë këtyre dy viteve janë: “Shpella e Gadimes”, “Gryka e Rugovës”, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc, Rrjedha e Lumit Mirusha, etj.

Gjatë viteve 2008 – 2009 janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin.

- Janë marrë nën mbrojtje 54 zona të reja të natyrës, me ç’rast numri i tyre është rritur ndjeshëm në gjithsej 97;
- Për shkak të humbjes së vlerave natyrore, 12 monumente të natyrës janë larguar nga regjistri qendror i zonave të mbrojtura;
- Në përgatitje e sipër janë edhe tri projektligje shumë të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës: projektligji për mbrojtjen e natyrës, për PK “Mali Sharr” dhe projektligji për PK “Bjeshkët e Nemuna”;
- Gjatë vitit 2009 ka filluar përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2010 – 2020;
- Është bërë zonimi i PK “Mali Sharr” dhe janë propozuar për mbrojtje edhe 14 rezervate të tjera natyrore;
- Është përgatitë drafti i Planit Hapësinor të PK “Mali Sharr” i cili është duke u shqyrtuar nga komunat përkatëse që bëjnë pjesë në kuadër të tij dhe planifikohet fillimi i shqyrtimit publik;
- Kanë vazhduar hulumtimet në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës dhe në shpellën e Radavcit nga speleologët slovak në bashkëpunim me shoqatën e speleologeve “Aragoniti” nga Peja dhe ekspertët e AMMK-së;
- Nga shfrytëzimi i natyrës pa një kriter të qëndrueshëm, në masë të konsiderueshme janë dëmtuar ekosistemet dhe diversiteti biologjik i zonave të mbrojtura;
- Pasojat më të mëdha të këtij zhvillimi i ka pësuar parku kombëtar “Mali Sharr” në të cilën përveç problemeve të mosmenaxhimit të unisuar të tërë sipërfaqes së parkut, janë evidentuar edhe shumë probleme të tjera siç janë: vazhdimi i ndërtimit të shtëpive në zonën e Prevallës, prerjet ilegale të pyjeve, dëmtimi i pyjeve dhe peizazhit si pasojë e shfrytëzimit të gurit, dëmtimet nga fatkeqësitë natyrore nga era dhe bora, dëmtimet nga insektet dëmtues, nga hedhja e mbeturinave, etj.

Nga këto ndikime nuk janë kursyer edhe zonat e tjera të mbrojtura. Ndikimet negative më të shprehura kanë qenë:

- Në rrjedhjen e mesme të lumit Mirusha është ndërtuar një pendë me gjatësi rreth 20 m dhe gjerësi 10 m. Ndërtimi i pendës ka ndikuar në degradimin e shtratit dhe të rrjedhjes normalet të ujit në lumin Mirusha. Ky akumulacion paraqet shqetësim edhe për banorët vendës, sepse paraqet rrezik nga përmbytjet gjatë stinës së pranverës dhe dimrit, kurse gjatë stinës së verës ndikon në shterjen e ujit në shtratin e lumit Mirusha. Për pasojë në lumin Mirusha janë konstatuar ngordhje të peshqve dhe gjallesave të tjera. Po ashtu, kjo pendë ndikon edhe në ujëvarat e lumi Mirusha duke ndërprerë qarkullimin normal të ujit;
- Në vendburimin e Drinit të Bardhë ka pasur ndërhyrje nga faktori njeri, siç është ndërtimi i një rezervuari të ujit për hidrocentralin e Radavcit që gjendet nën burimin e Drinit të Bardhë. Kjo ndërhyrje është bërë me beton dhe hekur e që ka si pasojë dëmtimin e origjinalitetit natyror të këtij monumenti;
- Në afërsi rreth 100 metra nga burimi i Drinit të Bardhë, ka dëmtime të konsiderueshme të vegjetacionit, prerje të drurëve të shkozës së butë, (*Caprinus betulus*), trugjeve të qarrit (*Quereous pubescens*). Kjo prerje masive e trugjeve ndikon drejtpërsëdrejti në prishjen e peizazhit dhe në paraqitjen e erozionit;
- Në Parkun e Mirushës gjatë këtyre 2 viteve kanë vazhduar ndërtimet e objekteve të reja hoteliere, ku janë ndërtuar 3 restorante. Këto ndërhyrje si dhe dëmtimi i vegjetacionit janë probleme të evidentuara të cilat dëmtojnë vlerat natyrore të zonës;
- Edhe përkundër mirëmbajtjes së mirë të zonës rekreative të Parkut të Gërmisë nga organizata menaxhuese, janë evidentuar probleme rreth ruajtjes së vlerave në zonat e tjera. Janë të dukshme dëmtimet e ekosistemeve të ndryshme përmes eksploatimit të pyjeve. Po ashtu dëmtime të konsiderueshme të masës drunore kanë shkaktuar në vitin 2008 edhe insektet, ndërhyrjet përmes ndërtimit të fontanës si dhe vendosja e antenave në majat më të larta dhe në brendësi të zonës rekreative. Prezenca e drurëve të thatë dhe zonat e minuara, mbeturinat në pjesët e thella të parkut, mungesa e planit menaxhues dhe planit hapësinor, shenjëzimit dhe zonimit të parkut etj .

Për shkak të humbjes së vlerave natyrore, 12 monumente të natyrës janë larguar nga regjistri qendror i zonave të mbrojtura.

Tabela 32: Monumentet e natyrës që janë larguar nga registri i zonave të mbrojtura

Nr.	Emërtimi	Komuna	Viti	Kategoria
1	Arneni në Nerodime (Pinus Heldreichi)	Ferizaj	1959	Monument natyror
2	Bliri në Strellc të Epërm (Tilia argentea)	Deçan	1961	Monument natyror
3	Vidhi fushor në Lukinaj (Ulmus Campestris)	Prizren	1981	Monument natyror
4	Trungu i qarrit në Potërç të ulët (Quercus sp.)	Klinë	1985	Monument natyror
5	Trungu i vidhit në Çabiq (Ulmus minor Miller)	Klinë	1985	Monument natyror
6	Trungu i qarrit në Bërkovë (Quercus sp)	Klinë	1985	Monument natyror
7	Trungu i qarrit në Dumnicë të P. (Quercus sp)	Podujevë	1988	Monument natyror
8	Trungu i plepit në Orlan (Populus tremula)	Podujevë	1988	Monument natyror
9	Çabrati	Gjakovë	1984	Monument natyror
10	Rahavane	Therandë	1980	Kompleksi i trungjeve
11	Ramjani	Viti	1982	Monument memorial
12	Burimi i ujit në Revuq	Podujevë	1988	Monument natyror

Gjendja e florës dhe vegetacionit

Zonat më të rëndësishme për florën e Kosovës konsiderohen “Malet e Sharrit”, “Bjeshkët e Nemuna”, “Pashtriku”, “Koritniku” etj

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme floristike janë evidentuar mbi 1800 lloje bimore të florës vaskulare, megjithëse supozohet se numri i tyre është më i madh (rreth 2.500). Në kuadër të llojeve të hulumtuara rreth 200 prej tyre janë endemike, endemorelikte dhe subendemike. Sidomos është i rëndësishëm grupi i endemikëve lokal, numri i të cilëve është ende i pa definuar plotësisht, disa prej të cilave kanë përhapje mjaft të kufizuar.

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shokuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim bëhet në mënyrë është jo racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me humbjen e shume fitocenozave me vlera të larta natyrore. Dëmet të mëdha po i shkaktohen sidomos florës së bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale, nga grumbulluesit e tyre.

Gjendja e faunës

Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe të llojeve, edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Hapësirat më të begatshme faunistike në Kosovë janë të gjitha masivet malore të Kosovës, por vlen të veçohen: “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Llogaritet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave.

Me gjithë rrjetin e pasur të lumenjve Kosova ende nuk ka një inventar të plotë për llojet e peshqve, për shkak të mungesës së hulumtimeve ihtiofaunistike. Deri më sot janë hulumtuar disa nga lumenjtë e Kosovës dhe janë evidentuar gjithsej 30 lloje të peshqve. Prej tyre 18 lloje në lumin Drini i Bardhë, 12 lloje në lumin Llap dhe 17 lloje në lumin Drenica.

Gjendja e resurseve natyrore në Parkun Kombëtarë “Mali Sharr”

Gjendja e pyjeve të Parkut Kombëtar është jo e kënaqshme si pasojë e ndikimit negativ të faktorëve biotik dhe abiotik. Këta faktorë kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme pyjore. Në disa pyje, në veçanti të rrobullit, ndikimi i këtyre faktorëve rrezikon ekzistencën biologjike të tyre.

Dëmi i përgjithshëm në pyjet e ahut në vitin 2008 nga prerjet ilegale në PK ka qenë 1608.04 m³.

Prerjet ilegale në territorin e komunës së Prizrenit në krahasim më atë të Suharekës, janë dukshëm më të vogla dhe kryesisht shfaqen në rajonet e Manastrecit, Ljubinjës dhe Prevallës.

Dëmtime sporadike në pyjet e ahut gjatë vitit 2008 janë verifikuar edhe nga fatkeqësia natyrore (era dhe

bora), mirëpo intensiteti i tyre nuk ka ndikim të posaçëm negativ në zhvillimin e pyjeve.

Duhet theksuar së në kuadër të pyjeve të dëmtuara gjenden edhe rezervatet strikte natyrore të rrobullit: Maja e Arnenit, Oshlaku dhe Pisha e Madhe të cilat gjithashtu kanë pësuar dëme të konsiderueshme pyjore.

Gjendja e bimëve të rralla barishtore të cilat i japin vlerë të veçantë florës së parkut kombëtar, është e mirë dhe e qëndrueshme. Nga llojet bimore stenoendemike që kanë vlerë të veçantë janë verifikuar në gjendje të mirë: barpezmi i mbretit Aleksandër (*Achillea alexandris regis*) në Oshlak, bormylera e Dieckit (*Brunmullera dieckii*) në Pashallare, krokusi i Sharrit (*Crocus scardicus*), karafili i Sharrit (*Dianthus scardicus*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*), etj.

Disa lloje të rralla të bimëve mjekuese janë objekt i shfrytëzimit ilegal nga njerëzit të papërgjegjshëm. Bima më e rrezikuar është sanëza, (*Gentiana lutea*) e cila mbledhet nga banorët lokal që e përdorin për tregti (përfitime personale), pasi që ajo ka vlera të veçanta mjekuese.

Gjatë vitit 2008 tentimet për mbledhje ilegale të kësaj bime kanë qenë të kufizuara, për shkak të shtimit të kontrolleve të terreneve nga drejtoria e PK, në lokacionet ku ajo është e pranishme.

Gjendja e faunës në PK mund të vlerësohet e mirë. Si rezultat i menaxhimit nga Drejtoria e Parkut Kombëtar, këto resurse natyrore e kanë marrë mbrojtjen më të mirë institucionale. Kjo ka ndikuar në zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të kafshëve të egra, në veçanti të ariut të murrmë, kaprojeve dhe dhive të egra. Nga gjurmimet e bëra në terren janë verifikuar shumica e kafshëve të egra që janë regjistruar nga hulumtimet e mëhershme, ndërsa shënimet për disa lloje më të rëndësishme që janë të pranishme në territorin e PK janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 33: Gjendja e kafshëve të egra në PN Sharr për vitin 2008⁴⁵

Lloji i kafshës së egër	Gjendja e fondit në fillim të vitit	Reprodukimi vjetor	Humbjet natyrore	Gjendja e fondit në fund të vitit
Ariu i murrmë	22	7	1	28
Kaprolli	40	10	3	47
Rrëqebulli	4	-	-	5
Dhia e egër	170	38	10	198
Derri i egër	50	25	15	60
Lepuri	130	60	40	150
Ujku	9	6	4	11
Shqiponja e përhimë	4	-	-	4
Thëllëza e gurëve	150	50	30	170

Gjendja shëndetësore e kafshëve të egra është e mirë. Ndërkaq rrezik të vazhdueshëm për kafshët e egra paraqet gjuetia ilegale nga njerëzit e pandërgjegjshëm. Llojet më të rrezikuara nga gjuetia ilegale janë dhia e egër dhe kaprojtë.

Gjendja e faunës në Rezervatet e veçanta të gjuetisë

Në tabelën 34, janë prezantuar disa të dhëna për numrin e shtazëve në Rezervatet e veçanta të gjuetisë.

Tabela 34: Numri i shtazëve në Rezervatet e Veçanta të Gjuetisë në Blinajë dhe në Duboçak sipas inventarizimit të 2007 dhe të dhënave nga stafi për vitin 2008-2009⁴⁶

	Blinaja		Duboçaku
	Inventarizimi 2007	Gjendja momentale	Gjendja momentale
Derri i egër (<i>Sus scrofa</i>)	364	504	220
Dreri i kuq (<i>Cervus elaphus</i>)	131	148	
Dreri i murrmë (<i>Dama dama</i>)	88	97	
Kaprolli (<i>Capreolous capreolus</i>)	48	65	20
Ariu i murrmë (<i>Ursus arctos</i>)			8

45 Drejtoria e Parkut Kombëtar "Mali Sharr", 2008

46 Agjencioni Pyjor i Kosovës.

Aktivitetet në kuadër të projektit për Gripin e shpendëve- Gjatë vitit 2008-2009 në kuadër të projektit për Gripin e shpendëve në bashkëpunim me zyrtarët e Agjencionit të Veterinës dhe të Ushqimit si dhe atyre nga FAO është realizuar monitorimi i disa lokacioneve (habitateve) me shpezë të egra migruues dhe vendore si: ligatina në Henc, liqeni i Batllavës, Badovcit dhe Radoniqit, si dhe disa nga lumenjtë kryesore si: Drini i Bardhë, Sitnica etj. Gjatë kësaj kohe është bërë evidentimi i rasteve të dyshimta me shpezë të sëmura, duke pasqyruar rolin e shpezëve të egra në përhapjen e gripit të shpezëve.

Hulumtimi i shpellave “Gryka e Madhe” dhe “Shpella e Radavcit”- Gjatë viteve 2008, 2009 në shpellën e “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës dhe në “Shpellën e Radavcit”, kanë vazhduar hulumtimet speleologët nga Republika e Sllovakisë, në bashkëpunim me Shoqatën e speleologëve “Aragonit” nga Peja dhe me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Hulumtimet kryesisht kanë qenë të përqendruara në matjet dhe zbulimin e korridoreve të reja. Gjatë këtyre ekspeditave, hartës digjitale të mëhershme iu kanë shtuar edhe rreth 2000 metra korridore dhe galeri të reja shpelllore. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve dhe e galerive të hulumtuara në shpellën “Gryka e Madhe” është rreth 13 km.

Hulumtimi i korridoreve dhe i galerive në shpellën “Gryka e Madhe” dhe në “Shpellën e Radavcit” do të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme.

Problemet:

- Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- Transpozimi jo i kënaqshëm i direktivave të shpendëve dhe habitateve në Ligjin e Natyrës;
- Mungesa e strategjisë dhe planit të veprimit për natyrën dhe biodiversitetin;
- Mungesa e institucioneve të mjaftueshme për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Mungesa e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Shfrytëzim i pa pakontrolluar i resurseve natyrore edhe në zonat e mbrojtura;
- Mungesa e hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet;
- Buxheti i pamjaftueshëm për natyrën;

Rekomandimet

- Aprovimi i 3 ligjeve të reja: për mbrojtjen e natyrës, për Parkun Kombëtar “Mali Sharr” dhe për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
- Hulumtimi, inventarizimi i llojeve dhe habitateve;
- Hartimi i Listës së Kuqe të florës dhe faunës për Kosovën;
- Shpallja e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar;
- Përkrahja e projekteve ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës;
- Përgatitja e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës
- Themelimi i zyrës koordinuese për identifikimin, ratifikimin dhe implementimin e konventave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

2.4. Mbeturinat dhe kimikatet

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe mënjanimin e mbeturinave. Mesatarisht në Kosovë me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave komunale shërbehen 42 % (viti 2007), përkatësisht 39 % (viti 2008) e 42% (viti 2009) e popullatës. Regjioni i Prishtinës mbulon përqindjen më të lartë të popullatës me këtë shërbim me 64 % (për vitin 2007) përkatësisht 52 % (për vitin 2008) dhe 53% (per vitin 2009), ndërsa regjioni i Mitrovicës më të ulët me vetëm 29 % (2007-2008) përkatësisht 30% (për vitin 2009) . Në zonat urbane (qytete), shërbimi i grumbullimit të mbeturinave u ofrohet përreth 90 % të popullatës, ndërsa zonat rurale mbulohen me këtë shërbim vetëm me rreth 10 %. Të dhënat e detajuara për shërbimet e ofruara për grumbullimin e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve janë prezantuar në tabelën 35.

Tabela 35 : Popullata që shërbehet me mbledhjen e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve për periudhën 2007-2009 shprehur në %⁴⁷

Nr.	Kompania	Regjioni	Viti		
			2007	2008	2009
1	Ambienti	Pejë	44%	29%	36%
2	Çabрати	Gjakovë	51%	53%	52%
3	Ekoregjioni	Prizren	32%	39%	38%
4	Higjiena	Gjilan	44%	26%	33%
5	Pastërtia	Ferizaj	33%	35%	44%
6	Pastrimi	Prishtinë	64%	52%	53%
7	Uniteti	Mitrovicë	29%	29%	30%

Kurse figura vijuese, tregon pjesëmarrjen e llojeve të ndryshme të mbeturinave në strukturën e përgjithshme të mbeturinave në Kosovë. Nga figura shihet se mbeturinat komunale marrin pjesë me 18 %, në kuadër të strukturës së përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara në Kosovë.




Figura 52: Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë (%)⁴⁸

Të dhënat e prezantuara në figurat 53 dhe 54, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit “derë me derë”, ndërkohë që sipas shërbimit për banesa kolektive ky grumbullim është më i vogël. Ky dallim në mes të sasisë së mbeturinave të grumbulluara sipas shërbimit “derë me derë” dhe atij për banesa kolektive është me i shprehur në regjionet tjera të Kosovës, krahasuar me regjionin e Prishtinës.

⁴⁷ Zyra Rregullatore për ujë dhe mbeturina, ZRRUM 2009.

⁴⁸ Raporti Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AMMK




Figura 53 dhe 54: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit për Regjionin e Prishtinës dhe Regjionet tjera në Kosovë⁴⁹

Ndërsa, nëse krahasohet mesatarja e grumbullimit të mbeturinave sipas shërbimit “derë me derë” dhe për banesa kolektive, në nivel të Kosovës për vitet 2007 dhe 2008, mund të konkludohet se gjatë vitit 2008 ka pas rritje të efektshmerisë për grumbullimin e mbeturinave nga banesat kolektive. (Figura 55 dhe 56).




Figura 55 dhe 56: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit për tërë territorin e Kosovës për vitin 2008 dhe 2007⁵⁰

Nga një hulumtim i realizuar nga ZRRUM rezulton se 61.2% e respondentëve kanë deklaruar se janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, ndërkohë 14.3% rezultojnë të jenë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me këto shërbime (Figura 57). Shkalla e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike tregon se ky shërbim është në shkallë më të lartë se shërbimet e telefonisë dhe shërbimi i ngrohjes qendrore, kurse është më i ulët se shërbimi i ujësjellësit dhe kanalizimit (Figura 58).




Figura 57. Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave⁵¹

49 Anketa e mbeturinave komunale, Enti i Statistikave të Kosovës 2009

50 Anketa e mbeturinave komunale, Enti i Statistikave të Kosovës 2008 dhe 2009

51 Hulumtimi për qëndrimet e konsumatorëve rreth shërbimeve publike për ujë dhe mbeturina në Kosovë- ZRRUM, 2008




Figura 58: Shkalla e shërbimit për grumbullim të mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike⁵²

Të dhënat e prezantuara në tabelën 36, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2008, është deponuar në deponinë e Prishtinës (80.185.06 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Podujevës (3,862.64 ton). Të dhënat e prezantuara në tabelën 37, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2009, është deponuar në deponinë e Prishtinës (84,660.59 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Sharrit (4807.00 ton). Kjo vlen edhe për vitin 2010 ku, sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara është në deponinë e Prishtinës (83,742.23 ton), ndërsa sasia më e vogël është deponuar në deponinë e Sharrit (5081.7 ton).

Nëse i krahasojmë të dhënat për mbeturinat e deponuar në deponitë sanitare për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010 vërehet se në të gjitha deponitë regionale dhe komunale ka pasur sasi më të mëdha të deponimit të mbeturinave. Sasia e gjenerimit të mbeturinave ka qenë me e madhe gjatë vitit 2010, kjo ka rezultuar edhe me rritje të sasisë së mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara.

Nga këto të dhëna mund të konstatohet se edhe kompanitë publike për grumbullimin e mbeturinave kanë qenë më efikase në kryerjen e shërbimeve të tyre.

Tabela 36. Sasia e mbeturinave në deponit sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2008 të shprehura në ton⁵³

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	5,904.90	5,826.06	6,250.23	6,665.96	6,377.97	7,032.28	7,712.59	7,247.91	6,114.45	7,423.37	6,351.12	7,278.22	80,185.06
2	Gjilan*	3,761.95	3,458.24	3,921.32	4,292.87	4,193.99	4,193.99	5,019.77	5,409.19	5,260.02	5,334.07	4,060.22	3,818.44	52,120.75
3	Prizren*	2,745.79	2,668.20	2,797.85	3,390.01	3,370.20	3,180.02	3,950.10	4,153.40	4,097.90	3,762.70	3,113.40	3,344.56	40,574.13
4	Podujevë*	340.89	50.79	213.37	375.06	227.33	299.00	318.23	398.64	372.74	422.58	406.79	437.22	3,862.64
6	Pejë**	1,664	1,415	1,464	1,544	1,590	1,685	2,237	2,225	2,225	2,227	1,601	1,800	21,677
8	Mitrovicë**	2,461	2,587	2,171	2,447	2,719	2,477	2,823	3,118	2,836	2,740	2,677	2,672	31,727
9	Ferizaj*	1,531.20	1,447.00	1,368.75	1,605.40	1,656.81	1,638.00	1,852.62	1,938.12	1,958.13	1,969.26	1,478.60	1,507.23	19,951.12
	Totali	18,409.73	17,452.29	18,186.52	20,320.30	20,135.30	20,505.29	23,913.31	24,490.26	22,864.24	23,878.98	19,688.13	20,857.67	218,402.43

Tabela 37. Sasia e mbeturinave në deponit sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2009 të shprehura në ton⁵⁴

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,967.45	6,060.84	7,794.76	8,539.91	8,299.89	8,588.45	4,383.72	6,335.95	7,264.75	7,831.62	5,206.45	7,386.80	84,660.59
2	Gjilan*	3,642.26	3,236.29	3,604.45	4,537.04	4,582.66	4,336.01	2,392.61	4,488.12	2,552.47	2,513.01	4,129.69	2,551.62	42,566.23
3	Prizren*	2,705.50	2,543.73	3,088.40	3,836.50	3,520.25	3,377.93	1,968.20	4,267.22	4,553.70	1,691.30	3,672.67	3,402.00	38,627.40
4	Podujevë*	360.33	358.84	463.06	610.02	509.86	503.32	353.05	448.96	496.45	589.86	589.17	618.93	5,398.53
6	Pejë**	1677	1480	1820	1899	1823	1930	2250	2370	2160	2040	1855	1873	23177
7	Sharr	314	296	331	415	426	366	534	573	450	419	359	324	4807.00
8	Mitrovicë**	2,302.64	1,927.15	2,888.88	3,308.14	3,045.8	3,031.27	3,378.98	2,903.9	3,014.58	3,099.68	2,741.01	2,553.79	34,195.82
9	Ferizaj*	1,069.39	1,250.90	1,002.60	1,732.20	1,411.50	609.30	710.30	285.29	1,845.17	1,895.93	991.75	969.75	13,774.08
	Totali	19,038.57	17,153.75	20,993.15	24,877.81	23,618.96	22,238.96	15,970.86	21,672.44	22,337.12	20,080.40	19,544.7	19,679.8	247,206.65

52 Hulumtimi për qëndrimet e konsumatorëve rreth shërbimeve publike për ujë dhe mbeturina në Kosovë- ZRRUM, 2008

53 KDMK dhe ZRRUM, 2008

54 KDMK dhe ZRRUM, 2009

Tabela 38. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2010 të shprehura në ton⁵⁵

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,423.75	6,326.54	6,852.50	6,395.38	6,706.95	6,330.10	7,063.85	7,331.98	7,508.48	7,826.96	8,077.71	6,898.03	83,742.23
2	Gjilan*	2,093.95	2,231.51	3,070.35	3,695.06	3,176.08	2,577.95	3,658.85	3,088.35	2,716.37	2,573.78	2,260.79	1,951.08	33,094.12
3	Prizren*	2,855.10	2,772.46	3,507.78	3,912.80	3,966.40	4,067.30	4,645.91	5,380.65	5,098.00	5,538.78	5,958.34	4,685.90	52,389.42
4	Podujevë*	513.60	407.97	18.80	1,355.10	26.95	2,507.72	38.11	40.49	44.05	567.01	594.01	510.80	6,624.61
6	Pejë**	1,662	1,395	1,400	2,226	2,177	2,168	2,168	2,756	2,440	2,178	2,202	1,884	24,656
7	Sharr	282.5	292	301.2	415	408	409	457	628	628	420	421	420	5081.7
8	Mitrovicë**	2,275	2,307	2,992	2,707	2,708	2,763	3,502	3,555	3,950	3,569	3,231	2,909	36,469
9	Ferizaj*	988.75	357.90	643.10	667.40	569.10	1,294.59	1,061.55	1,672.30	1,608.00	1,608.60	1,496.50	1,521.40	13,489.19
	Totali	17,094.65	16,090.38	18,785.73	21,373.74	19,738.48	22,117.66	22,595.27	24,452.77	23,992.90	24,282.13	24,241.35	20,780.21	255,546.27

* KDMK

** ZRRUM




Figura 59: Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare sipas viteve

Sasia e mbeturinave të gjeneruara për person në Kosovë për vitin 2008 është 393,8 kg ndërsa për vitin 2009 është 454,4 kg, që tregon një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave për kokë/banori. Krahasuar me regjionet tjera sasi më e madhe vjetore e mbeturinave për person gjenerohet në regjionin e Prishtinës. Mesatarja ditore e mbeturinave të gjeneruara për person në Kosovë për vitin 2008 është 1.1 kg kurse për vitin 2009 është 1.2 kg, që po ashtu tregon një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave për kokë banori.

Tabela 39: Sasia mbeturinave për person (kg/vit dhe kg/ditë) për 2008 dhe 2009⁵⁶

Vendi i grumbullimit	Popullsia	Popullsia që ka qasje në shërbimet e grumbullimit	2008			2009		
			Sasia e grumbulluar	Mbetrina person/vit	Mbetrina person/ditë	Sasia e grumbulluar	Mbetrina person/vit	Mbetrina person/ditë
Njësia	Nr. i banorëve	Nr. i banorëve	1000 ton	kg/banorë	kg/banorë	1000 ton	kg/banorë	kg/banorë
Regjioni i Prishtinës	469.472	288849	198	685.5	0.2	218	754.7	2.1
Regjionet tjera	1.264.400	606396	153	252.3	0.7	187	308.4	0.8
Kosova	1.733.872	891315	351	393.8	1.1	405	454.4	1.2

55 KDMK dhe ZRRUM, 2009

56 Të dhënat janë kalkuluar duke marrë për bazë regjistrimin preliminar të popullsisë për vitin 2011. Numri i banorëve të shërbyer është llogaritur duke shumëzuar numrin e konsumatorëve me madhësin mesatare të ekonomive familjare në Kosovë (5.88). Sasia e mbeturinave për kokë banori është llogaritur duke pjesëtuar sasisë së mbeturinave të grumbulluara me numrin e popullsisë në zonën e shërbimit.

Mbeturinat industriale- Shumë substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës, disave nga këto substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar, duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë.

Deri me tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla janë bërë aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe FSK-së.

Si rezultat i prodhimitarisë industriale, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera, hasen edhe shumë materije të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e deponimit/magazinimit dhe sasinë e tyre.

Tabela 40: Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit dhe komunave⁵⁷

LLOJI I MBETURINAVE	SASIA/ NJËSIA	LOKACIONI	KOMUNA
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	49045 m ³	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	186 ton	Kosova A	Obiliq
Burime radioaktive	34 njësi	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	25505 m ³	Shkërritorja Trepça	Mitrovicë
Hipoklorur kalciumi	6.5 ton	Shipol	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6300 ton dhe 165 fuqi	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	600 litra	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	2000 litra	Industria kimike	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substanca kimike të ngurta	10 ton	Tuneli i parë	Mitrovicë
Burime radioaktive	3 fuqi	Tuneli i parë	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	8500 kg	Parku Industrial	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngëta	42900 litra	Parku Industrial	Mitrovicë
Vajrat PCB	4 trafo	Fabrika e plumbit	Zveçan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	136 ton	Fabrika e plumbit	Zveçan
Tretësira të ndryshme	2 ton	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	7.0 m ³	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbet. e filmave fotografik	3000 kg	IMK-Fabrika	Ferizaj
Koka të rëntgenit	3 copë	IMK-Fabrika	Ferizaj
Mbeturina me substanca kimike të lëngtë	20 ton	Fabrika e Këmbyesve	Ferizaj
Mbet. e filmave fotografik	2.5 ton	Fabrika e veglave	Ferizaj
Ngjyra tekstili, substanca kimike	9100 kg	Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	4370 kg	Sharr-Tex	Sharr
Vajra të përdorura	1200 litra	“Adi”	Lipjan
Mbeturinë radioaktive	184 unaza americiumi	Pallati i Rinisë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	85 ton	Flotacioni-Trepçë	Leposavic
Mbeturina kimike të ngurta	22.2 ton	Fabrika e lëkur-këpucëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	17340 litra	Fabrika e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	200 kg	Fabrika e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6180 kg	Fabrika e Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	3265 litra	Fabrika e Sharr-Tex	Sharr
Substanca kimike të ngurta	231.8 kg	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Fuqi plastike me acide	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Kuti të plastikës të panjohura	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Substanca shishe pa etiketë	15 copë	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	5 ton	Fabrika e tekstilit	Gjakovë

57 Raport i gjendjes së mjedisit 2008

Mbeturinat e ndërtimit - Pas përfundimit të luftës, Kosova është përballur edhe me rritjen e sasisë së mbeturinave me prejardhje nga rrënimi i objekteve të banimit dhe objekteve tjera. Hedhja dhe grumbullimi i tyre në vende që nuk kanë qenë të destinuara për këtë qëllim ka keqësuar edhe më shumë gjendjen në sektorin e mbeturinave. Sidomos është shqetësuese dukuria e zënies së sipërfaqeve të tokave të punueshme dhe hedhja e mbeturinave pranë brigjeve të lumenjve.

Përveç dëmtimit të peizazhit, mbeturinat e ndërtimit kanë ndikim të dëmshëm në mjedis e veçanërisht në ekosisteme, sidomos në rastet kur ato hedhen të përziera me mbeturinat të tjera urbane. Deri me tani nuk ka të dhëna të sakta për sasinë e këtyre mbeturinave dhe sipërfaqeve të zëna me to, por nga vizitat monitoruese në terren, është vërejtur se këto mbeturina janë evidente në shumë lokacione të Kosovës.



Mbeturinat e ndërtimit në Suharekë

Automjetet mbeturinë - Janë të gjitha llojet e automjeteve motorike që dalin nga përdorimi. Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet nga disa kompani private. Këto kompani, automjetet mbeturinë, i trajtojnë në dy mënyra: duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje, të cilat kryesisht shiten në vende të rajonit si dhe duke i demontuar për ripërdorimin e pjesëve të tyre.

Me qëllim të parandalimit dhe reduktimit të ndotjes së mjedisit nga automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre, MMPH ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 02/2009 për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinave të tyre. Ky udhëzim përveç parandalimit dhe reduktimit të ndotjes së mjedisit nga automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre ka për qëllim që të ndikojë edhe në:

- Rritjen e nivelit të ripërdorimit, riciklimit dhe formave të tjera të përpunimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre në funksion të mbrojtës së mjedisit;
- Krijimin e sistemit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre dhe
- Caktimin e kushteve të përshtatshme për magazinimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre.

Një masë tjetër ligjore në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga automjetet mbeturinë është vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 19 qershor 2009. Ky vendim i obligon të gjitha pikat e grumbullimit të hekurishteve të largohen nga rrugët magjistrale së paku 1 kilometër, të gjitha veprimtaritë që merren me shitjen e auto pjesëve nga automobilat e përdorur që bëjnë mbledhjen, grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga konstrukti dhe demolimi, të kujdesen për vendosjen e këtyre materialeve në objekte të mbyllura, si dhe të kujdesen për pamjen estetike të tyre.



Vendgrumbullim i automjeteve mbeturina

Pesticidet dhe plehrat kimike- Produktet kimike për mbrojtjen e bimëve (pesticidet dhe plehrat kimike), kanë përdorim të gjerë si në fermat e vogla, ashtu edhe në ato të specializuara. Ekonomitë shtëpiake dhe fermat e specializuara përdorin lloje të ndryshme të plehrave minerale. Kështu plehrat kimike NPK përdoren nga 60.6 % e fermerëve të vegjël dhe 74.1 % e fermerëve të mëdhenj. Të dhëna më të detajuara janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 41: Përdorimi i plehrave minerale dhe plehut organik nga ekonomitë shtëpiake në përqindje (%)⁵⁸

Lloji i plehrave	Fermat e vogla	Fermat e mëdha te specializuara
%	%	%
NPK	60,6	74,1
NAG	11,3	31,5
UREA	27,6	9,3
Të tjerë	1,5	7,4

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit 2009, në Kosovë janë importuar 705.542,96 kg produkte kimike për mbrojtjen e bimëve-PMB, dhe 38.369.370,37 kg plehra kimike.

Të dhënat për produkte tjera kimike dhe plehrat kimike të importuara për vitet 2007 dhe 2008 janë prezantuar në tabelën 42.

58 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, ESK

Tabela 42: Sasia e substancave kimike dhe plehrave kimike të importuara gjatë vitit 2007-2008⁵⁹

Lloji i kimikatit	Njësia	2007	2008
• Vajrat e naftës dhe vajrat të fituara prej mineraleve bituminoze	Litër	1.397.440	1.588.620
• Lëndë djegëse me një numër Oktan (RON)	Litër	4.040.761	961.092
• Petroleum, dyllë parafine, dyllë mikrocrystalin naftë, dyllë i plogët, ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe dhe substance të tjera kimike (me ngjyrë apo pa ngjyrë) të fituara nga sinteza apo proceset tjera kimike	Litër	120.003	96.312
• Produkte kimike për mbrojtjen e kafshëve dhe bimëve (të përziera, të bashkuara apo të trajtuara kimikisht)	Litër	196.848	59.645
• Komponente kimike të prodhuara nga përzierja apo trajtimi i produkteve kimike të kafshëve apo bimëve			
• Substanca tjera kimike të ngjashme me katër grupet e para	Litër	753.580	204.580
• Nitrat Amoniumi	Kg	258.170	854.896
• Përzierje e Nitrat Amoniumit me Kalcium, Karbonat ose me substance të tjera inorganike	Kg	26.892.380	5.600.522
• Plehurat tjera kimike ose minerale që përmbajnë Azot, Fosfor ose Kalium.	Kg	32.406.342	24.121.055

Konkluzionet

- Sistemi për administrimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje në shumë çështje;
- Mbeturinat komunale mbledhen dhe grumbullohen në shkallë vendi nga vendbanimet e Kosovës në masën deri në 50 %;
- Gjendja në deponitë e Kosovës nuk është e mirë dhe ka numër të madhe të deponive të egra;
- Ka mungesë të sistemit të monitorimit të gjendjes së mbeturinave dhe mungesë të mekanizmave efikas për ndarjen dhe seleksionimin e mbeturinave;
- Mungesë e projekteve për riciklimin e mbeturinave dhe nevojë për investime në sektorin e mbeturinave;
- Inkasim i ulët për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve;

Rekomandimet

- Fuqizimi i institucioneve menaxhuese të mbeturinave dhe forcimi i institucioneve lokale lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
- Implementimi dhe kompletimi i bazës ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Promovimi i riciklimit të mbeturinave;
- Vetëdijesimi i popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kompanive shërbyese;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në deponi ilegale dhe në fushë hedhurina;
- Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Hartogramimi i të dhënave për administrimin e mbeturinave.

3.

Mjedisi dhe shëndeti publik

3.1. Ndikimi i mjedisit në shëndetin publik

Në jetën e njeriut ndikojnë shumë faktorë të jetës së përditshme si: mënyra e jetesës, ushqimi, kushtet e punës dhe ndotja e mjedisit. Njeriu i ekspozohet ndotjes së ajrit, ujit dhe dheut, mes tjerash edhe përmes ushqimit, mbeturinave, kimikateve dhe prodhimeve të ndryshëm që ai përdorë në punë ose në shtëpi. Ndikimi fizik i mjedisit në shëndet mund të sjell sëmundje të ndryshme si: sëmundje të zemrës, frymëmarrjes, kancer të lëkurës etj. Ndikimet e ndryshme kimike mund të sjellin çrregullime hormonale, çrregullime në rritje dhe zhvillim, kancer, alergji etj. Rëndësia e mjedisit të shëndoshë është e pazëvendësueshme për shëndetin e njeriut. Edhe pse ka të dhëna për ndikimet e mundshme të mjedisit në shëndet, megjithatë ka pak të dhëna përmes të cilave mund të argumentohet ndikimi i posaçëm i tij në shëndet. Problem i veçantë në këtë drejtim është mbledhja e të dhënave të tilla të cilat do të argumentonin këtë.

Kosova ka një gjendje jo të mirë të shëndetit të popullatës. Rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare kanë shënuar rënie të ndjeshme që nga periudha e pasluftës e deri me sot. Sëmundjet si Hepatiti A, meningjiti, diabeti dhe sëmundjet ngjitëse të zorrëve janë ende në shkallë të lartë.

Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve të regjistruar në kujdesin parësorë shëndetësorë për vitin 2007, në kuadër të grupit të sëmundjeve që ndërlidhen me mjedisin dhe faktorët mjedisor, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar me sëmundje të sistemit të frymëmarrjes me 663353 raste në vit ose 31.5 % e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Numër i madh i të sëmurëve është regjistruar edhe tek sëmundjet e sistemit të tretjet (293702 raste) dhe sistemit të qarkullimit të gjakut (173688 raste) ose 14 % përkatësisht 8.3 % e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Ndërsa është regjistruar numër relativisht i vogël i rasteve të morbiditetit dhe mortalitetit nga faktorët e jashtëm. Për më shumë tabela vijuese.

Tabela 43: Rastet e sëmundjeve që ndërlidhen me gjendjen e mjedisit dhe faktorëve të tij në kuadër të numrit të përgjithshëm të rasteve të sëmundjeve të regjistruara⁶⁰

Nr.	Lloji i sëmundjes	Nr. i rasteve	% në kuadër të numrit total të të sëmurëve
	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	663353	31.5
	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	173688	8.3
	Sëmundjet e lëkurës dhe sistemit nën lëkuror	74273	3.5
	Tumoret	6586	0.3
	Sëmundjet e sistemit urogjenital	119140	3.5
	Sëmundjet infektive dhe parazitare	65988	3.1
	Sëmundjet e sistemit të tretjes	293702	14
	Lëndimet, helmimet dhe pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm	50892	2.4
	Shkaktarët e jashtëm të morbiditetit dhe mortalitetit	9408	0.5

60 Statistikat e Shëndetësisë 2007, ESK 2008

Tabela 44: Ecuria e sëmundjeve ngjitëse dhe incidenca e tyre në Kosovë 2008 dhe 2009⁶¹

Sëmundjet	2008		2009	
ITPR - Pneumonia	13136	624	14537	690.6
Diarea acute	52515	2494.7	47111	2238.05
Variçela	5140	244.2	5354	254.3
Sindromi i diresë me gjak	64	3.04	130	6.2
Sindromi meningjeal	397	18.8	378	17.9
Paraliza acute flakcide	1	0.05		
Sindromi i etheve hemoragjike	7	0.33	14	0.7
*Sindrome me ethe ekzantematike	5	0.24	27	1.3
Parotiti epidemik	797	37.8	909	43.2
Verdhëza acute A	1271	60.3	1193	56.7
Verdhëza B, HBs	95	4.5	159	7.6
Pertussis	37	1.7	20	0.9
Tularemia	46	2.2	88	4.2
Bruceloza	73	3.5	64	3.04
TBC	948	45.04	901	42.8
*Intoxicatio alimentaris	460	21.8	466	22.1
*Typhus abdominalis	29	1.4	6	0.3
Dyshimi në Influcë	26684	1267.6	41959	1993.3
Influenca A (H1N1)			308	14.6
Sëmundjet tjera ngjitëse	1817	86.3	2375	112.8
Total	103522	4917.9	115999	5510.64

61 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, 2010

3.2. Kualiteti i ujit të pijes dhe shëndeti publik

Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nuk janë të mbrojtur nga ndotja dhe nuk respektohen zonat e përcaktuara sanitare. Kualiteti i ujit të pa trajtuar për furnizim të popullatës dallon prej rajoni në rajon. Përmbajtja e ujërave sipërfaqësore varet edhe nga përbërja minerale e tokës nëpër të cilën rrjedh si dhe nga struktura e akuiferëve. Ky është një problem serioz duke pasur parasysh se nuk respektohen standardet për zona sanitare. Është prioritet absolut të themelohen mekanizmat për monitorim me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta mbi kualitetin dhe kuantitetin e ujërave në Kosovë.

Përgjegjës për monitorimin e cilësinë e ujit të pijshëm të ujësjellësve publik në Kosovë është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i cili përcjell, kryen analizat dhe bënë raportet për përshtatshmërinë e cilësisë së ujit në bazë të rregullave.

Shumica e mbetjeve bakteriologjike ndodhin në ujësjellësit e qyteteve të vogla/rurale (zakonisht në puse të shpuara apo burime), edhe pse ka të raportuar edhe mos-përshtatshmëri të kualitetit të ujit të pijshëm (kryesisht mbetje bakteriologjike) edhe në sistemet e ujësjellësve publik.


Vetëm rreth 60-70 %, e popullatës janë të kyçur në sistemin e ujësjellësit. Rreth 65 % e popullatës rurale pinë ujë nga pusët, ku shumica e tyre janë jo higjienike. Rreth 50 % e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit. Rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare kanë shënuar rënie të ndjeshme që nga periudha e pasluftës e deri me sot.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP), rregullisht ndërmerr aktivitete me qëllim të vendosjes së një kontrolli të shtuar mbi cilësinë e ujërave të pijshëm. Në bazë të dhënave nga monitorimi i burimeve të ujit të pijshëm nga ky institucion, konstatohet se ndotja e ujërave të pijshëm është më e madhe nga kontaminimi bakteriologjik se sa nga kontaminimin kimik. 74%-90% e ujërave të bunarëve sipas IKSHP-së janë me kontaminim fekale.

Tabela 45 : Raporti i sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave për vitin 2009¹


KOMUNA	ITPR-Pneumonia	Diarreja akute	Varicela	Dyshimi në Influcencë	Gjithsej
DEÇAN	31	2	1021	673	16
SHARR	130	1	163	472	92
FERIZAJI	1730	18	3926	2671	521
FUSHË KOSOVË	281	14	772	1242	128
GJAKOVË	37	8	260	1165	142
GJILANI	791	6	2188	2535	330
DRENAS	175	23	1304	1339	250
BURIM	75	1	452	766	13
KAÇANIK	123	4	596	656	64
HANI I ELEZIT	5		913	35	57
DARDANË	359	1	1988	742	101
KLINË	390	3	2263	1627	166
LIPJAN	371	15	1195	1287	150
MALISHEVË	290	10	1999	1097	167
MITROVICË	1544	10	1824	6091	284
ARTANË	11		3	64	5
KASTRIOT	272	8	514	738	134
PEJË	752	6	1217	2498	202
JUNIK	9		383	265	33
PODUJEVË	881	9	1661	1891	146
PRISHTINË	2149	116	4557	8742	867
PRIZREN	1704	17	5009	3903	790
RAHOVEC	1656	6	1390	1405	152
SHTIME	161	4	479	170	28
SKENDERAJ	38	10	860	1269	118
THERANDË	303	2	3221	553	55
VITI	57	4	1211	1226	140
VUSHTRRI	212	10	590	1989	203
TOTALI	14537	308	41959	47111	5354

Përqindja e rasteve të disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, 2007
(të dhënat e agreguara)



A)

Përqindja e rasteve të disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, janar - qershor, 2009
(të dhënat e agreguara)




B)

Figura 60: Përqindja e rasteve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, A) viti 2007 dhe B) janar-qershor 2009


Tabela 46: Përqindja e mostrave të kontaminuara dhe sasia e klorit rezidual⁶²

Kontrolli bakteriologjik			Kontrolli kimik			Gjithsej mostra te analizuar	Klori rezidual mg/l
Mostra të analizuar	Mostra të kontaminuara	%	Mostra të analizuar	Mostra të kontaminuara	%	13.049	0-1-0.2
9.577	522	5.50	3.454	165	4.7		

Të dhënat në tabelën 46, flasin se prej 9.577 mostrave të analizuar nga IKSHP, 522 prej tyre ose (5.50 %) janë me kontaminim bakteriologjik, ndërsa prej 3.454 mostrave të analizuar 165 prej tyre ose (4.7 %) janë me kontaminim kimik.



A)



B)

Figura 61 : Papërshatshmëria bakterore dhe vlerat e Clorit rezidual i ujit për pije nga sistemet qendrore të furnizimit në Kosovë: A) 2007 dhe B) janar-qershor 2009

Ndërkohë që vlerat e klorit rezidual sillen prej 0.1-0.2 mg/l, që është brenda vlerave të lejuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (VML 0.2 mg/l).

Konkluzione

IKSHP në raportin për periudhën janar-dhjetor 2009 për cilësinë e ujit të pijes konstaton se:

- Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 janë raportuar gjithsej 41039 raste të sëmundjeve ngjitëse;
- Ky numër i sëmundjeve është më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2008 (69460);
- Me diarre ujore janë shënuar 14493 raste (mbi 688.5 në 100.000 banorë). Ky numër mjaft i madh mund të lidhet me kushtet e dobëta ekonomike dhe higjienike, cilësinë e ujit të pijshëm, mungesën e kanalizimit, menaxhimin e dobët të mbeturinave etj;
- Në grupin e sëmundjeve të agreguara si diarre akute raportohen 35% të totalit;
- Numri ende i madh i rasteve të Hepatitit A është indikator i cili flet për nivelin e ulët të higjienës si dhe shfrytëzimin e ujit të pijes nga pusët e kontaminuar;
- Cilësia e ujit të pijshëm ende nuk është stabilizuar;
- Dezinfektimi i ujit të pijshëm nuk është i qëndrueshëm;
- Zonat mbrojtëse të resurseve ujore mungojnë në shumë raste.

4.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore

4.1. Shfrytëzimi i Resurseve Ujore

Shfrytëzimi i ujërave për pije dhe amvisëri- Shërbimet e ujësjellësit në Kosovë ofrohen nga shtatë Kompani Regjionale të Ujit (KRU) të licencuara. KRU-të e licencuara i ofrojnë shërbimet e veta në 25 komuna të Kosovës. Komunitet me shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan) si dhe pjesa veriore e Mitrovicës nuk janë nën autoritetin menaxhues të KRU-ve. Përpos në qytete kryesore këto kompani ofrojnë shërbimet e veta edhe në disa prej fshatrave të cilat gjenden në kuadër të zonave të tyre të shërbimit.




Figura 62: Shtrirja e shërbimeve të ujit (%) në kompanitë rajonale të ujësjellësve⁶³ për vitet a) 2007 dhe b) 2008

Tabela 47: Përformanca e kompanive rajonale të ujësjellësve për 2008²³

Kompania Regjionale e Ujit	Numri i komunave të shërbyera	Numri i konsumatorëve të shërbyer	Numri i popullatës së shërbyer	Shtrirja e shërbimeve të ujësjellësit %	Shtrirja e shërbimit të kanalizimit %
Prishtina	7	82,443	445,432	77	66
Hidroregjioni Jugor	4	28,464	189,069	49	44
Hidrodrini	4	28,996	157,120	65	34
Mitrovica	3	20,780	116,440	55	47
Radoniqi	3	26,667	158,394	95	62
Hidromorava	3	15,901	86,413	33	36
Bifurkacioni	2	14,947	79,816	42	29
Gjithsej	25	219,198	1,232,683	60	48


Në bazë të numrit të konsumatorëve shtëpiak të cilët faturohen nga KRU-të, ZRRUM ka vlerësuar se numri i popullatës që iu ofrohen shërbimet e ujësjellësit është 1,232,683 banorë (ose 60% e popullatës së përgjithshme), ndërsa për shërbimet e kanalizimit 987,130 banorë (ose 48% e popullatës së përgjithshme)⁶⁴.

Po ashtu, ekziston një numër i konsiderueshëm (rreth 200) i sistemeve rurale të ujësjellësve që nuk operohen nga KRU-të, por nga komunitetet e fshatrave dhe si të tilla nuk janë të përfshira në këtë vlerësim. Kësaj duhet t'i shtohen edhe sistemet e ujësjellësve në komunat me shumicë serbe të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të. Duke

⁶³ ZRRUM, 2008

⁶⁴ Raporti i performances se KUR, ZRRUM 2008

marrë për bazë faktorët e sipërpërmendur, vlerësohet se mbulimi me shërbimet e ujësjellësit në Kosovë sillet në kufijtë: 70%-75%, ndërsa me shërbimet e kanalizimit: 50%-55%.



Harta 8: Mbulueshmëria me shërbimet e furnizimit me ujë nga sistemet publike të ujësjellësit

Prodhimi total i ujit i distribuuar nga kompanitë regjionale në vitin 2008 ka qenë 127.3 milion m³. Më tepër se gjysma e këtij uji (55%), merret nga burimet sipërfaqësore (akumulacionet), ndërsa pjesa tjetër (45 %) nga burimet nëntokësore. Tabela në vijim pasqyron burimet e furnizimit me ujë dhe sasinë ditore në m³.

Tabela 48: Burimet e furnizimit me ujë, sasia ditore dhe vjetore (m³)⁶⁵


Nr.	Vend marrja e ujit	Sasia e ujit e shfrytëzuar në [m ³ / ditë]	Sasia e ujit e shfrytëzuar në [m ³ / vit]	Përqindje [%]
1	Burime natyrore	153.264	55.941.360	32.10
2	Rezervuar	7.749	2.828.385	1.62
3	Lum	11.191	4.084.715	2.34
4	Liqe (Akumulim sipërfaqësor)	279.260	101.929.900	58.44
5	Pus	26.340	9.614.100	5.51
Gjithsej		477.804	174.398.460	100

Nga tabela vërehet se sasia më e madhe e ujit të pijshëm shfrytëzohet nga akumulimet sipërfaqësore.

Prej sasisë së përgjithshme të ujit të prodhuar nga Kompanitë regjionale, 55.7 milion m³/vit u janë faturuar konsumatorëve, ndërsa sasia tjetër prej 71.6 milion m³ (ose 56%) është ujë i cili nuk është faturuar (duke përfshirë edhe humbjet teknike dhe administrative). Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të ujësjellësit që operohet dhe mirëmbahet nga KRU-të është 3,357 km, ndërsa rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura është 938 km. Si pasojë e humbjeve të larta nga sistemi i ujësjellësit si dhe kapaciteteve të pamjaftueshme të prodhimit, shumica e Kompanive Regjionale të Ujësjellësit nuk kanë mundësi të ofrojnë furnizim të ujit pandërprerë për konsumatorët. Kështu, konsumatorët e regionit të Mitrovicës, Prishtinës, Gjilanit dhe Ferizajt, ballafaqohen me ndërprerje të rregullta të furnizimit me ujë të cilat ndërprerje janë më të theksuara gjatë muajve të verës kur konsumi i ujit rritet dukshëm.


Humbjet komerciale janë gjithashtu të larta si rezultat i lidhjeve ilegale, të cilat shpesh për shkak të gabimeve të hidraulikëve i keqësojnë problemet e kualitetit të ujit.

Problemet tjera janë edhe: kapaciteti i pamjaftueshëm i burimeve nga merret uji; shpenzimi jo racional dhe humbjet e mëdha në rrjet, stacionet e filtrimit të vjetruara dhe me kapacitet të kufizuar, mungesa e urbanizimit adekuat në vendbanime, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit edhe në raste kur kapaciteti është i kufizuar, mungesa e masave shtytëse për kursimin e ujit, mungesa e resurseve njerëzore profesionale për menaxhim të ujërave etj.



Burimi i Drinit të Bardhë, një nga burimet që shfrytëzohet për pije

65 Shoqate e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve-SHUKOS, 2009



Harta 9: Vend marrja e ujit nga kompanitë regjionale

Shfrytëzimi i ujërave për nevojat e industrisë- Industria konsiderohet si sektori më i madh i shpenzimit të ujit. Shpenzuesit më të mëdhenj të ujit janë ndërmarrjet e mëdha industriale (KEK-u, New Co Feronikeli, Sharrceci etj.). Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve industriale furnizohet me ujë nga liqenet akumuluese sipërfaqësore. Të dhënat flasin se për nevojat e ndërmarrjeve të mëdha industriale (për procese teknologjike prodhuese, ftohje dhe nevoja sanitare, etj.), shpenzohet me shumë se 30 % e sasisë së përgjithshme të ujit.

Tabela 49: Shpenzimi i ujit për vitet 2007/2008 nga ndërmarrjet e mëdha industriale

Shfrytëzuesit	Vitet	Shpenzimi i ujit			
KEK		TCA		TCB	
		Harxhimi mujor (m³)	Harxhimi specifik (m³/MWh)	Harxhimi mujor (m³)	Harxhimi specifik (m³/MWh)
	2007	6955000	5.23	871300	2.987
	2008	8274000	mes = 6.12	9330057	mes = 2.60
Sharrcem	1 vjetore (m³)	Kondicionimi i gazrave të furrës (m³)	Ftohje të pajisjeve (m³)	Për nevoja sanitare (m³)	Raste speciale (m³)
	113,661	29,565	43,800	18,396	21,900
NewCO Feronikeli		Të dhëna në bazë të faturave të pagesave në hidrosistemin Ibër- Lepenc (m³)			
	2007	1232466			
	2008	3604560			

Shumica e ndërmarrjeve të vogla industriale i shfrytëzojnë ujërat nga ujësjellësi publik, ndërsa shumë pak prej tyre përdorin sistem vetjak të furnizimit me ujë. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për shpenzimin e ujit në sektorin e industrisë në disa komuna të Kosovës.

Tabela 50: Sasi e ujit të shpenzuar nga ndërmarrjet industriale në disa komuna të Kosovës dhe burimet e tyre të furnizimit⁶⁶

Komunat	Sasitë e shpenzuara të ujit m³/ vit	
	Burimet vetjake nëntokësore dhe nga ujësjellësi	Nga ujësjellësi
Deçan	-	1000
Gjakovë	-	158000
Burim	190000	-
Klinë	22000	-
Rahovec	-	54000
Pejë	10000	122000
Prizren	4000	163000
Therandë	-	809000
Gjithsej:	226000	1307000

Kosova si vend në zhvillim, në të ardhmen pritet që shfrytëzimi i resurseve ujore të rritet, gjë që do të mund të përkeqësojë edhe më shumë gjendjen e furnizimit të popullatës me ujë të pijes, sidomos në basene akumuluese që kanë qasje të përbashkët industria dhe popullata.

Shfrytëzimi i ujërave për hidroenergjetikë- Përfitimi më i madh nga shfrytëzimi i energjisë ujore realizohet nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të vogla. Në fillim, ndërtimi i këtyre hidrocentraleve ka pasur si qëllim furnizimin me energji elektrike të zonave të thella malore, por më vonë gjithë hidrocentralet janë lidhur me sistemin energjetik. Këto hidrocentrale janë kryesisht të tipit me derivacion dhe shfrytëzojnë burimet dhe rrjedhjet ujore pranë këtyre zonave dhe jetëgjatësia e tyre është 25 vjet.

Zhvillimi i një programi për aktivizimin e këtyre hidrocentraleve është pjesë e politikës energjetike të Strategjisë së Energjisë të Kosovës dhe parashikohet mundësia e rivënies në punë në mënyrë eficiente e këtyre hidrocentraleve.

66 Departamenti i ujërave, 2008

Aktualisht në Kosovë funksionon hidrocentrali i Ujmanit që ka kapacitet prodhues të energjisë prej 2 x 17 MW, dhe pesë hidrocentrale të vogla në rrjetin e shpërndarjes me kapacitet 11.82 MW. Hidrocentrale tjera të vogla janë: Dikanci, Burimi dhe Prizreni. Në Kosovë është në prodhim edhe hidrocentrali i Kozhnjerit në Deçan, i cili është dhënë me koncesion dhe prodhon një sasi të vogël të energjisë.

Tabela 51: Prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese⁶⁷

Hidrocentralet	Fuqia Mw	Energjia Gwh
HC ekzistuese ne rrjetin e Distribucionit	11.82	38
HC Ujmanit	35.0	101
Totali	36.82	139

Kosovën e karakterizojnë lumenj dhe përranj me një potencial hidroenergetik të cilët mund të merren në konsideratë për t'u shfrytëzuar për prodhimin e energjisë elektrike. Pjesa perëndimore e Kosovës disponon potencialin hidroenergetik të Drinit të Bardhë, i cili nga ana e tij përbën më shumë se gjysmën e potencialit hidroenergetik të Kosovës. Potenciali i shfrytëzueshëm hidroenergetik i Kosovës përbën rreth 0.7 TWh/vit. Hidrocentrali më i rëndësishëm që mund të ndërtohet në Kosovë është ai i Zhurit, në rrjedhën e Drinit të Bardhë, me potencial 0.377 TWh/vit. Rrjedhjet e Drinit të Bardhë, Ibri, Moravës, Lepencit, Llapit i karakterizon një potencial i rëndësishëm për prodhimin e energjisë elektrike. Në tabelën 52 është dhënë potenciali hidroenergetik i lumenjve të Kosovës, ndërsa në tabelën 53 janë të dhënat për hidrocentralet e reja të planifikuara për ndërtim.

Tabela 52: Potenciali hidroenergetik i lumenjve të Kosovës⁶⁸

	Lumi	Potenciali hidroenergetik teknikisht i shfrytëzueshëm	Potenciali hidroteknik, ekonomikisht i shfrytëzueshëm
Nr.		GWh/vit	GWh/vit
1	Drini i Bardhë	554.00	554.00
2	Ibri	103.27	102.17
3	Morava e Binçës	8.75	8.75
4	Lepenci	23.80	16.53
Totali		689.64	681.27




Figura 63: Potenciali i Hidrocentraleve sipas kategorive [kW]

⁶⁷ Ministria e Energjisë dhe Minierave, 2009

⁶⁸ Raporti i studimit të parafisibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vegjël në Kosovë, MEM & AAESD, 2006

Tabela 53: Hidrocentralet e planifikuara⁶⁹


Emri	Fuqia [k]	Energjia [Milionë kWh]	Prurja m ³ /sek	Rënia [m]	Lumi
1: HEC-i Kuqishta	3900	17	6	80	Lumëbardhi i Pejës
2: HEC-i Drelaj	6200	27	6.5	120	
3: HEC-i Shtupeq	7600	35	8	120	
4: HEC-i Bellajë	5200	25	5	130	Lumëbardhi i Deçanit
5: HEC-i Deçan	8300	39	6.5	160	
6: HEC-i Lloçan	3100	14	1.5	250	Lumëbardhi i Lloçanit
7: HEC-i Mal	4000	18	2.4	200	Erenik
8: HEC-i Erenik	2000	9	2.4	100	
9: HEC-i Jasiq	1900	9.7	2.6	90	
10: HEC-i Dragash	2200	10	5	55	Plavë
11: HEC-i Orçush	5600	25.6	7	100	
12: HEC-i Reçan	1500	6.7	2.6	70	Lumëbardhi i Prizrenit
13: HEC-i Brezovicë	2100	10	4.5	60	Lepenc
14: HEC-i Lepenci	3500	16	7.6	60	
15: HEC-i Banjska	300	1.4	0.5	85	Banjskë
16: HEC-i Batare	1100	5.8	2.3	60	Bistrica (Batare)
17: HEC-i Majanc	600	2.9	1.5	50	Kaçandoll
18: HEC-i Mirusha	4600	22	45	15	Drini i Bardhë dhe L. Deçanit
Totali HEC-eve të rinj	63700	294.1			

69 Raporti i studimit të parafsisibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vegjël në Kosovë, MEM & AAESD, 2006

HARTA E SHPËRNDARJES SË HIDROCENTRALEVE TË PLANIFIKUARA



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS
Burimi i të dhënave:
MEM/ AKMM
Projeksioni: UTM WGS-84 Zona 34
Prill 2011



Harta 10: Hidrocentralet e planifikuara

4.3. Shfrytëzimi i inertëve nga shtretërit e lumenjve

Pellgjet e lumenjve të Kosovës degradohen kryesisht nga aktivitetet e pa kontrolluara të operatorëve që bëjnë nxjerrjen e inerteve nëpër lumenjtë dhe rreth shtretërve të tyre. Lumenjtë më të prekur nga kjo dukuri janë në pellgun e lumit Drini i Bardhë. Lumi Drini i Bardhë është më së shumti i dëmtuar, pastaj lumi Ereniku dhe një pjesë e Lumëbardhit të Pejës. Zona më e degraduar dhe që vazhdon të degradohet është lumi Drini i Bardhë, në sektorin që fillon nga Kramoviku deri në fshatin Gjonaj. Ndërsa në lumin Ereniku pjesa më e dëmtuar është sektori që fillon prej fshatit Korenicë e deri te Ura e Tabakut (në hyrje të qytetit Gjakovës)⁷⁰.

Në të gjithë sektorët e lartpërmendur shfrytëzimi i inerteve është bërë pa kriter, qoftë në aspektin e ruajtjes së regjimit ujqor, qoftë nga aspekti i shfrytëzimit të lëndëve minerare. Ndryshimi i regjimit ujqor po ashtu ka shkaktuar andërrimin e lumenjve dhe si pasojë sipërfaqe të tëra të tokave pjellore janë bartur nga plotat.

4.4. Shfrytëzimi i resurseve pyjore

Sipas të dhënave të Agjencionit të Pyjeve, gjatë vitit 2009 në sektorin publik janë prerë gjithsej 51.617.25 m³ dru. Pjesa më e madhe e kësaj sasie është shfrytëzuar për djegie (Tabela 54). Prerjet në sektorin privat janë 109,130. 20 m³, ndërkohë që nuk ka të dhëna të detajuara për prerjet ilegale.

Tabela 54: Sasia e masës drunore të prerë për vitin 2009⁷¹

Lloji masës drunore	Spektori publik	Spektori privat
Trupa ahu	2,095.00 m ³	-
Dru teknik	1,920.78m ³	-
Dru zjarri	40,274.88 m ³	-
Mbeturina drunore	7,326.56 m ³	-
Gjithsej	51,617.25 m ³	109,130. 20 m ³

Ndërsa sipas të dhënave nga Enti i Statistikave të Kosovës, sasija e drurit që shfrytëzohet për djegie në Kosovë është 451.735 m³ ndërsa sasija e drurit teknik-industrial është 6.248 m³ . Sa i përket regjioneve sasija më e madhe e drurit shfrytëzohet në Regjionin e Mitrovicës ndërsa ajo më e vogla në regjionin e Gjakovës (tabela 55).

Tabela 55: Shfrytëzimi i drurit (m³) sipas regjioneve⁷²:

Rajonet	Dru për djegie (m ³)	Dru teknik-industrial (m ³)	Gjithsejtë dru i shfrytëzuar (m ³)
Kosova	451.735	6.248	457.983
Prishtina	86.618	-	86.618
Mitrovica	120.323	230	120.553
Peja	42.797	1.792	44.589
Gjakova	34.428	1.266	35.694
Prizreni	54.762	208	54.970
Ferizaj	51.394	2.703	54.097
Gjilani	61 413	49	61.462

70 Departamenti i Ujërave, 2008

71 Agjencia e Pyjeve të Kosovës

72 Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore, ESK 2010

5. Zbatimi i Strategjisë, Planit të Veprimit dhe planeve tjera për mjedisin

5.1. Zbatimi i Strategjisë së Kosovës për Mjedis dhe Planit të Veprimit

Strategjia e Kosovës për Mjedis është miratuar nga Qeveria e Kosovës në korrik 2004. Ky dokument ka identifikuar problemet kyçe mjedisore dhe ka përcaktuar orientimet strategjike, bazuar në Raportin e Gjendjes Mjedisore të vitit 2003.

Me qëllim të zbatimit të Strategjisë së Mjedisit të Kosovës dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, në vitin 2005 MMPH ka hartuar Planin e Kosovës për Veprimi në Mjedis për periudhën 2006-2010. Projekti është financuar nga Qeveria Suedeze përmes Agejncisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), ndërsa Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) ka qenë implementuese për zhvillimin e PKVM në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

PKVM, ka rolin e një instrumenti për përmirësimin e gjendjes së mjedisit përmes projekteve dhe masave konkrete. Gjatë procesit të prioritizimit të aktiviteteve, vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjidhjes së problemeve kryesore mjedisore si dhe sigurimit të zhvillim të qëndrueshëm. Ndarja e prioriteteve dhe projekteve është bërë sipas sektorëve përkatës mjedisor.

Projektet e Planit të Veprimit për Mjedis, kryesisht janë realizuar ose janë financuar nga Buxheti i Kosovës, ndërsa disa nga projektet janë mbështetur edhe nga donatorët e ndryshëm. Janë realizuar kryesisht projektet e planifikuara nga fusha legjislative, edukimit dhe ndërgjegjësimit.

Nga 52 projekte të planifikuara nga Plani i Veprimit për Mjedis janë realizuar 10 projekte kapitale, ndërsa janë në procedurë të realizimit edhe 11 projekte tjera. Në kuadër të projekteve të realizuara për nga rëndësia duhet veçuar:

- Ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme;
- Krijimi i rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit;
- Ndërtimi i impianteve për sterilizimin e mbeturinave spitalore;
- Rehabilitimi i deponive komunale;
- Pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat me azbest;
- Rehabilitimi i deponive të vjetra komunale
- Identifikimin dhe eliminimin e të gjitha "hot spoteve" në Kosovë.

Gjatë vitit 2009, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes një konsulence nga SIDA, ka shqyrtuar nevojën për rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Është formuar edhe Grupi Punues për rishikimin Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit.

Ky grup punues gjatë vitit 2010, ka filluar rishikimin e Strategjisë së Mjedisit dhe plotësimin e saj si dhe rishikimin dhe plotësimin e Planit të Veprimit për Mjedis.

5.2. Strategjitë dhe Planet Sektoriale të Veprimit

Në legjislacionin mjedisorë të Kosovës përveç hartimit të Strategjisë së Kosovës për Mjedisin dhe Planit të Kosovës për Veprim në mjedis është paraparë edhe hartimi i strategjive sektoriale dhe planeve aksionare për sektorët kryesorë të mjedisit si: ujin, ajrin, biodiversitetin, mbeturinat dhe për çështje tjera mjedisore si: ndryshimet klimatike, mbrojtjen e tokës, mbrojtjen e pyjeve, administrimin me kemikate, mbrojtjen nga zhurma, mbrojtjen nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues etj.

Gjatë periudhës kohore 2008-2010, ka filluar hartimi i disa prej këtyre strategjive sektoriale. Strategjitë që janë përgatitur dhe që pritet që gjatë vitit 2011, të miratohen në Kuvendin e Kosovës janë:

- Strategjia dhe Plani Aksional për Mbeturina,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2010-2020.

Ndërsa ende nuk ka filluar puna në përgatitjen e: Plani Strategjik i Kosovës për Ujëra, Strategjisë për Ndryshime Klimatike dhe disa strategjive tjera që parashihen sipas legjislacionit mjedisor dhe që janë të nevojshme për administrimin më efikas të mjedisit.

5.3. Hartimi i Planeve Mjedisore në nivelin lokal

Në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në Ligjin për Planifikim Hapësinor, komunat janë të obliguara që të hartojnë plane lokale të veprimit në mjedis, plane zhvillimore komunale, plane zhvillimore urbane planet rregulluese urbane si dhe programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit. Deri më tani janë hartuar Plane Lokale të Veprimit në Mjedis në 27 Komuna. Në disa prej komunave këto plane janë miratuar, ndërsa në disa të tjera ato janë në proces të miratimit. Disa nga PLVM-të janë hartuar me përkrahjen financiare nga SIDA me implementimin e zyrës regjionale të mjedisit REC, ndërsa disa të tjera janë hartuar në kuadër të një projekti të Komisionit Evropian, implementuar nga EPTISA. Në shumicën e komunave të Kosovës janë përgatitur dhe janë miratuar (ose janë në proces të miratimit) edhe Planet Zhvillimore Komunale dhe Planet Zhvillimore Urbane. Një pasqyrë e detajuar për PLVM-të, PZHK-të dhe PZHU-të të parapara me legjislacionin mjedisor janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 56: Planet Lokale të Veprimit në Mjedis, Planet Zhvillimore Komunale dhe Planet Zhvillimore Urbane sipas Komunave⁷³

Nr.	Komuna	PLVM	PZHK	PZHU
	Deçani	Në proces	+	+
	Dragash	Në proces	Në proces	Ne proces
	Ferizaj	+	+	+
	Fushë Kosovë	Në proces	Në proces	+
	Gjakovë	Në proces	+	+
	Gjilan	+	+	+
	Gllogoc	Në proces	+	+
	Istog	Në proces	+	+
	Kaçanik	Në proces	Në proces	Në proces
	Kamenicë	Në proces	Në proces	Në proces
	Klinë	+	-	-
	Leposaviq	-	-	-
	Lipjan	Në proces	+	+
	Malishevë	Në proces	Në proces	Në proces
	Mitrovicë	+	+	+
	Novo Bërdë	Në proces	-	-
	Obiliq	Në proces	+	+
	Pejë	+	+	+
	Podujevë	Në proces	Në proces	Ne proces
	Prishtinë	Në proces	-	-
	Prizren	Në proces	Në proces	Në proces
	Rahovec	Në proces	-	-
	Shtërpçë	Në proces	+	+
	Shtime	Në proces	+	+
	Skenderaj	Në proces	Në proces	Ne proces
	Suharekë	Në proces	+	+
	Viti	Në proces	Në proces	Ne proces
	Vushtrri	Në proces	+	+
	Zubin Potok	-	-	-
	Zvečan	-	-	-

Planet Zhvillimore Komunale dhe Planet Zhvillimore të aprovuara me pëlqim nga MMPH janë ato të Komunave: Pejë, Gjakovë, Gjilan, Deçan, Istog, Mitrovicë, Vushtrri, Ferizaj, Drenas dhe Shtime, ndërsa të aprovuara pa pëlqim nga MMPH janë ato në Komunat: Lipjan, Suharekë dhe Shtërpçë.

6.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

6.1. Hartimi i legjislacionit dhe përafrimi me Direktivat e BE-së

Politika e përgjithshme kombëtare e Kosovës përfshinë edhe procesin e integritimeve evropiane. Ndër sfidat kryesore në këtë proces është edhe mjedisi, plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane. Në periudhën 2008 – 2009, Komisioni Evropian ka monitoruar progresin e harmonizimit të legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të BE-së dhe zbatimin e saj.

Tabela 57: Rezultatet e monitorimit të progresit të harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të BE-së⁷⁴

Fusha	Direktiva e BE	Niveli i harmonizimit (%)	
		2008	2009
Legjislatura horizontale	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	90	62
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	80	100
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	38	26
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	48	60
Kualiteti i Ajrit	Direktiva kornizë për kualitetin e ajrit (96/62/EC)	75	75
	Direktiva për vlerat kufitare të SO ₂ , NO ₂ , NO _x , grimcave pezull (particulate matter) dhe plumbit në ajër (99/30/EC)	47	47
	Direktiva për Benzenin dhe Monoksidin e Karbonit (2000/69/EC)	50	50
	Direktiva për Ozonin (2002/3/EC)	55	57
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër (2004/107/EC)	20	20
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva për mbeturinat (2006/12/EC)	95	95
	Direktiva për mbeturinat e rrezikshme (91/689/EC)	85	100
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	88	88
	Direktiva për deponitë (99/31/EC)	77	90
	Direktiva për incinerimin e mbeturinave (2000/76/EC)	69	69
Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	3	16
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC)	27	25
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	48	68
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	7	7
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	64	83
	Direktiva për habitatet (92/43/EC)	78	73
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për kontrollin e integruar të ndotjes (96/61/EC)	80	97
	Direktiva për impiantet me djegie të mëdha (2001/80/EC)	61	64
Kimikatet	Direktiva për substancat e rrezikshme (67/548/EEC)	53	xx
	Direktiva për kontrollin e OMGJ-ve (2001/18/EC)	78	79

74 European Commission, DG ENV, Progress Monitoring Report, Year 3 -2009. August 2009
